

1 E martë, 3 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan.

6 Mirëmëngjesi.

7 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Dua të trajtojme një çështje
8 administrative përpara se të fillojmë me dëshmitarin ju lutem.

9 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
10 këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ja të
12 paraqesim lëndën, ju lutem, fillimisht.

13 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faji im, jo i
15 juaji.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-
17 BC-2020-06, Zyra e Prokurorit kundër Hashim Thaçit, Kadri
18 Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
20 Tani mund të flisni.

21 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ka diçka me dokumentin që ka
22 numrin 2633 që ka kërkesën e ZPS-së për të pranuar
23 aktekspertizë.

24 Më 20 nëntor, bashkërisht ekipet e Mbrojtjes dorëzuan një
25 kërkesë ku kërkuan leje për t'u kundërpërgjigjur, dhe

1 protokollimi ynë mori numrin F02737. Ende nuk ka marrë vendim
2 Trupi Gjykues nëse do të na lejoni të kundërpërgjigjemi.

3 Po e ngre tani sepse përgjithësisht Mbrojtja e ka punën
4 pak me nxitim, duam ta trajtojmë çështjen e aktekspertizës
5 përpara pushimit të Krishtlindjeve edhe vendimi që është marrë
6 në -- vendimi që do të merrni ju për dokumentin 2633, ka
7 rëndësi të jashtëzakonshme për përgatitjen e Mbrojtjes, sepse
8 mesa kuptojmë ne, ekspertët e parë dëshmitarë do të fillojnë
9 në janar.

10 Kështu që do ju luteshim mund të na thoni paraprakisht
11 kur do të merrni ju vendim nëse do të na lejoni ne të
12 kundërpërgjigjemi dhe nëse ky vendim do të merret para
13 pushimit të Krishtlindjeve.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ju japim
15 përgjigje brenda ditës së sotme.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
18 procesverbal, të akuzuarit janë të gjithë të pranishëm në
19 sallën e gjyqit.

20 Do fillojmë tani me dëshminë e dëshmitarit të Prokurorisë
21 W4401.

22 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Besoj se do të
24 përfundoj brenda 30 minutash.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

1 për përditësimin.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 [Përkthim] Vërej për procesverbal që Avokati Kujdestar i

5 Dëshmitarit W04401 është i pranishëm në sallën e gjyqit.

6 Mirëmëngjesi, Dëshmitar, z. Bashota.

7 Dhe mirëmëngjesi, z. Qerkini.

8 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Bashota,

10 ju rikujtoj edhe një herë të përgjigjeni qartë, me fjali të

11 shkurtër. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, mos hezitoni të

12 kërkoni që pyetja të përsëritet ose thjesht thoni që nuk e

13 kuptoni në mënyrë që ta sqarojmë. Mos harroni të na thoni ku i

14 bazoni ju faktet rrethanat dhe dijenitë, njohuritë për të

15 cilat do t'ju bëjnë pyetje.

16 Flisni pranë mikrofonit dhe bëni një pauzë prej pesë

17 sekondash përpara se të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë për

18 përkthyesit.

19 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na informoni dhe

20 do të bëjmë organizimin përkatës.

21 Jeni ende nën detyrim për të thënë të vërtetën sikurse

22 vetë e thatë përmes betimit solemn. Ju rikujtoj gjithashtu që

23 garancitë që Trupi Gjykes ju dha të enjten janë ende të

24 zbatueshme dhe mosdhënia e dëshmisë mund të sanksionohet me

25 një gjobë.

1 DËSHMITARI: SOKOL BASHOTA [Vijon]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të

3 vazhdojmë me kundërpjetjet nga Mbrojtja e z. Thaçi.

4 Z. Misetic, fjala është për ju.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

6 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

7 [Vazhdim]

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Mirëmëngjesi, z. Bashota.

10 PË. Mirëmëngjesi.

11 PY. Do të doja të fillonim sot në mëngjes me Marrëveshjen e

12 Rambujesë. Prokurori iu tregoi një dokument që kishte

13 nënshkrime të ndryshme. Gjatë seancës përgatitore në Shënimin

14 Përgatitor 2, paragrafi 16, thuhet se i keni thënë ju

15 Prokurorisë:

16 "Ky është dokumenti i nënshkruar i UÇK-së që konfirmon

17 Marrëveshjen e Rambujesë, e cila u pranua pavarësisht

18 vështirësive që patëm për pranimin e saj me kushtet e kësaj

19 marrëveshjeje."

20 A mund të na thoni çfarë vështirësish pati pranimi i

21 kësaj marrëveshjeje sa u takon kushteve që kishte ajo?

22 PË. Po gjatë kohës së negociatave për shkuarjen në Rambuje,

23 ka pas zëra të atillë të cilët nuk kanë besuar shumë në këtë

24 konferencë dhe kjo i është transmetuar edhe disa komandantëve

25 të zonave dhe kryesisht për këtë ka shfaqë këtë hezitim z.

1 Adem Demaçi, i cili ka diskutu edhe me komandantët e zonave,
2 që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk duhet me pranë një
3 vendim të tillë për shkuarjen në Rambuje për arsye se nuk do
4 del diçka e favorshme për Kosovën.

5 PY. Çfarë qëndrimi atëherë mbajti z. Demaçi?

6 PË. Z. Demaçi ka mbajti qëndrim për mos me shku në Rambuje.

7 PY. A kishte ndonjë gjë konkrete në kushtet e Marrëveshjes së
8 Rambujesë që ishte shumë e diskutueshme dhe e papëlqyeshme?

9 PË. Po e thashë edhe më herët, se në dokumentet bazë të cilat
10 kanë qenë të Hillit ma herët, ka pas elemente kontestuese dhe
11 me siguri që iu ka referu atyre dokumenteve të cilat realisht
12 nuk kanë me mujt me realizu aspiratën e popullit shqiptar për
13 pavarësi.

14 Shkurt, me aq sa di unë, veç ka thënë që nuk ka diçka të
15 mirë nga kjo konferencë.

16 PY. Ju po thoni që asgjë e mirë nuk do të dilte nga kjo
17 konferencë. Po ky ishte mendimi juaj personal?

18 PË. Jo.

19 PY. Pra, ju mendoni nuk do arrinit dot pavarësinë?

20 PË. Jo unë. Thashë, Demaçi ka thënë kështu.

21 PY. Në rregull. Do të shohim një dokument lidhur me këtë
22 çështje.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të vendosni në ekran
24 materialin që mban numrin 1D117 dhe në shqip dhe në anglisht.

25 PY. Ndërkohë që presim dokumentin të shfaqet në ekran, a ju

1 kujtohet ju që disa nga komandantët e zonave ishin kundër
2 Rambujesë?
3 PË. Po. Po, jo, nuk e di saktë se sa kanë qenë kundër. Po di
4 që më duket Remi ka qenë kundër. Shukria më duket ka qenë,
5 Shukri Buja ka qenë kundër. Të tjerët nuk s'më kujtohet. Por e
6 di që kanë qenë kundër kësaj shkuarjes në Rambuje. Por më vonë
7 më duket se, jo, s'kanë pranë. Janë ka kundër. [E
8 pakuptueshme] kundër.

9 PY. Ky është një dokument, në fakt është një njoftim për
10 shtyp që e ka lëshuar LPK-ja më 6 mars të 1990 ku LPK-ja po
11 ashtu e ka kundërshtuar nënshkrimin e Marrëveshjes së
12 Rambujesë. A e ke ditur ti aso kohe që dhe LPK-ja ka qenë
13 kundër Marrëveshjes së Rambujesë?

14 PË. Jo, për këtë nuk e kam dit.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga
16 ekрани. Dhe mund të vendosim në ekran dokumentin P227.

17 PY. Ky është dokumenti me shkrim dore që u tregoi Prokurori.
18 Ishte ai dokumenti që kishte nënshkrimet në fund të faqes.
19 Fillimisht, a mund të na thoni pse është me shkrim dore ky
20 dokument dhe nuk është i shtypur?

21 PË. Nuk e kam idenë pse, veç e di që jemi nënshkruar të
22 gjithë të pranishëm çka kemi qenë.

23 PY. Teksti thotë:

24 "Sokoli: E dimë për përmbajtjen e dokumentit, por duke
25 marrë parasysh faktorin e brendshëm dhe të jashtëm, duhet të

1 mendojmë me kujdes sesi të vijojmë më tej. Mendoj se duhet të
2 ndalojmë një çast që të rifitojmë forcat. Sidoqoftë si mundësi
3 duhet ta shfrytëzojmë.”

4 Kur thonë “Sokol” këtu bëhet fjalë për ju?

5 PË. Ka mundësi. S’ka -- ka mundësi.

6 PY. A ju kujtohet çfarë keni dashur të thoni ju me këto
7 fjalë? Për shembull, kur thoni, “përmasa e faktorit të
8 brendshëm dhe të jashtëm, duhet të mendojmë me kujdes se si të
9 veprojmë, se si mund të veprojmë”. Çfarë ke dashur të thuash
10 me këtë të kujtohet?

11 PË. Nuk di sa muj me kujtu saktë se çka kam dasht me thënë
12 për në atë kohë, por një e di se qëllimi ka qenë, qëllimin e
13 kam pas se duhet ta shfrytëzojmë këtë si mundësi të mirë që na
14 erdh si nga bashkësia ndërkombëtare dhe se nuk kemi çka humbim
15 nëse veç shkojmë në Rambuje, pa e ditur saktë pastaj
16 mbarëvajtjen sesi ka shku punimet atje në Rambuje, pa i
17 paragjyku ato.

18 Por thjesht e kam pas qëllimin që duhet të shfrytëzohet
19 si mundësi e mirë për me shku në Rambuje dhe me i paraqit
20 qëndrimet tona si shoqëri. Kjo ka qenë qëllimi im.

21 PY. Në rregull. Sa i takon kohës kur është përgatitur ky
22 dokument, ky dokument është nënshkruar përpara apo pas
23 Konferencën së Rambujesë?

24 PË. Unë mesa kujtoj, ky dokument është nënshkru për me shku në
25 Rambuje.

1 PY. Pra, ky nuk është një autorizim për të lejuar nënshkrimin
2 e Marrëveshjes së Rambujesë?

3 PË. Jo, sa di unë, jo. Mesa di unë, mesa di unë -- nuk jam i
4 kjartë në të.

5 PY. Shohim paragrafin tjetër. Thotë:

6 "Si përfundim, duke marrë parasysh të gjitha vlerësimet
7 për dokumentin përfundimtar, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së do
8 të shqiptojë mendimin përfundimtar për dokumentin pasi të
9 konsultohet me komandantët e zonave. Shtabi i Përgjithshëm
10 është në favor ta pranojë marrëveshjen."

11 Ju ndihmon kjo me kujtesën, pra, që do të thotë se ky
12 dokument është përgatitur pasi ishte përgatitur
13 projekt marrëveshja për nënshkrim?

14 PË. Po. Po, kështu është.

15 PY. Teksti thotë që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së do të japë
16 ose do të shqiptojë mendimin përfundimtar lidhur me dokumentin
17 pasi të konsultohet me komandantët e zonave.

18 Pse ishte e nevojshme të bëhej konsultim me komandantët e
19 zonave?

20 PË. Po ishte e nevojshme dhe për arsye se ata ma herët kanë
21 qenë të -- një pjesë e tyre kanë hezitu në shkuarjen në
22 Rambuje dhe për shkak se ata kishin një forcë tek strukturat e
23 tyre komanduese dhe tek ushtarët dhe realisht është dashtë me
24 e marrë një pëlqim të tyre për arsye se ka pas zëra se në
25 qoftë se nënshkruhet një marrëveshje në Rambuje që nuk i

1 plotëson kërkesat e shqiptarëve, komandantët e zonave kanë
2 thënë se ne nuk do ta pranojmë. Prandaj është dashtë me u
3 pyet. Madje-madje kujtoj se është marrë një pushim mes
4 Rambujesë dhe Parisit për me e marrë pikërisht, për me e marrë
5 edhe qëndrimin dhe opinionin e komandantëve të zonave për këtë
6 çështje.

7 PY. A mund të themi atëherë se komandantët e zonave, se nëse
8 komandantët e zonave nuk do të pajtoheshin me këtë
9 projekt marrëveshje atëherë kjo projekt marrëveshje nuk do të
10 nënshkruhej?

11 PË. Nuk e di se si kishte me shku puna, po mendoj se do të
12 ishte shumë serioze. Mospëlqimi i komandantëve të zonave do të
13 shkaktonte mjaft probleme.

14 PY. Viojmë më tej në tekst, thotë që:

15 "Shtabi i Përgjithshëm është në favor që të pranohet.
16 Shtabi i Përgjithshëm -- kjo bazohet në opinionet pozitive që
17 ka ushtria, forumet e ndryshme të shtetit shqiptar, opinionet
18 që kanë personalitetet shqiptare autoritare në fushën politike
19 dhe sociale, si dhe ndikimi nga mekanizmat e ndryshëm
20 ndërkombëtar."

21 Pra, nënshkrimi i marrëveshjes së Rambujesë ishte një
22 ngjarje historike për popullin e Kosovës, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. A pajtoheni me mua që në atë kohë mund të ishte po aq
25 kontestuese sepse nuk kishte një dispozitë të posaçme për

1 pavarësi të plotë?

2 PË. Po, ka ekzistuar ky rrezik.

3 PY. A kam të drejtë unë kur them se arsyeja pse e nënshkruat
4 të gjithë ju dokumentin është sepse donit të dilnit me një
5 qëndrim të bashkuar qoftë për popullin e Kosovës, por edhe për
6 faktorin ndërkombëtar, për t'u treguar të gjithëve që kishit
7 rënë dakord bashkërisht për marrëveshjen?

8 PË. Po, e drejtë.

9 PY. Dhe askush prej jush nuk donte që të ishte personi i
10 vetëm që të nënshkruante një marrëveshje e cila nuk përmbante
11 diçka specifike për pavarësinë e Kosovës, pajtoheni?

12 PË. Po, e di se ne kemi diskutuar gjatë rreth kësaj. Askush
13 nuk ka mujt me marrë përgjegjësinë individuale për me bë një
14 gjë të tillë pa marrë edhe miratimin e të gjithëve, e të
15 gjithëve.

16 PY. Flasim për një temë tjetër. Dua të flasim për çështjen e
17 z. Cen Desku dhe z. Jakup Kastrati dhe të dy gazetarëve.

18 Ju thatë që nuk keni qenë i përfshirë në arrestimin e
19 tyre, as të Cen Deskut dhe Jakup Kastratit dhe as të dy
20 gazetarëve serbë, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Ju po ashtu thatë -- më falni, do ta bëj pyetjen ndryshe.
23 Pra, është -- mesa keni ju dijeni anëtarët e tjerë të Shtabit
24 të Përgjithshëm a kanë pasur njohuri për arrestimin e tyre?

25 PË. Nuk e di.

1 PY. I thatë ZPS-së që mesa keni ju dijeni, nuk kishte asnjë
2 arsye për ta ndaluar, për ta arrestuar dhe për ta ndaluar Cen
3 Deskun, saktë?

4 PË. Thashë edhe më herët, se Cen Desku ka qenë një prej
5 figurave të rëndësishme në komunën e Klinës, një njeri që
6 është marrë tërë jetën e vet në shërbim të atdheut dhe ka qenë
7 disa herë i maltratuuar nga forcat serbe. Ka qenë një humanist,
8 është marrë edhe me ndihma humanitare, shpesh thashë ka qenë
9 më tepër se skandaloze ndalimi i tij nga kushdo qoftë.

10 PY. Po për z. Kastrati?

11 PË. Z. Kastrati --

12 PY. Mesa keni ju dijeni, a ka ndonjë arsye?

13 PË. Z. Kastrati e kam njoftur vetëm mbas luftës dhe
14 përshtypjet e mia janë se një njeri familjar, një njeri i
15 sjellshëm, një njeri i edukuar mirë. Unë mendoj se nuk ka pas
16 as edhe një arsye të vetme që të ndalohej dhe ai. Kjo ka qenë
17 përshtypja ime që kam kriju nga takimi që kur kemi nejt mbas
18 lufte shoqnisht me të.

19 PY. Në Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafi 27, thuhet se i
20 keni thënë ZPS-së se Adem Demaçi ka qenë një personalitet me
21 autoritet të pakontestueshëm mbi komandantët e zonave apo me
22 ndikim të pakontestueshëm mbi komandantët e zonave, kështu?

23 PË. Adem Demaçi ka pas një autoritet, me thënë të drejtën,
24 nga gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, por gjatë
25 periudhës së luftës ka pas një ndikim të veçantë tek

1 komandantët e zonave. Ai herë pas here i takonte dhe i
2 vizitonte ata.

3 PY. Po pse thoni ju që ai kishte "autoritet të
4 pakontestueshëm" mbi komandantët e zonave, mbi ç'baza e thoni
5 këtë?

6 PË. Po e di se komandantët e zonave shpesh herë e kërkonin që
7 Demaçi të jetë prezent në takimet e tona me komandantët e
8 zonave. Të paktën një takim e kanë kërku kështu me këmbëngulje
9 me qenë. Nuk e di për çfarë teme është diskutuar, por e di se
10 kanë ngulur këmbë që Demaçi me qenë prezent.

11 PY. A ju kujtohet konkretisht cili prej komandantëve të
12 zonave ka kërkuar të jetë i pranishëm?

13 PË. Po kryesisht Remi ka qenë më i fuqishëm në kërkesat e
14 tina, por ka pas mbështetje nga të gjithë.

15 PY. A mund ta përsërisni emrin ju lutem --

16 PË. Remi.

17 PY. -- sepse nuk doli në transkript?

18 PË. Remi.

19 PY. Në Shënimin Përgatitor 2, paragrafët 32 deri në 35 ju
20 keni thënë se Adem Demaçi kishte dërguar një letër një ditë
21 përpara lirimit të ashtuquajturve gazetarë, këtyre dy
22 gazetarëve ku thuhej se këta persona do t'i dorëzoheshin
23 William Walker, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. A është e saktë ajo që i keni thënë Prokurorisë se nuk e

1 dini kush e urdhëroi lirimin e të dy ashtuquajturve gazetarë
2 dhe të zotërinjve Desku dhe Kastrati?

3 PË. Po.

4 PY. I thatë ZPS-së se keni mësuar prej tyre vetëm nga Shaun
5 Byrnes dhe Adem Demaçi, saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Tani do të doja të shihnim edhe një herë memon që pamë
8 dje.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës të
10 vendosë në ekran materialin që mban numrin 1D00219, e cila
11 është me numër provizor për momentin. Shohim fundin e faqes 3,
12 ju lutem.

13 PY. Këto janë shënime procesverbali, në fakt, pjesë e
14 procesverbalit nga takimi që keni pasur me avokatët e z.
15 Thaçi. Dua t'ju them që fillimi i këtij paragrafi në fakt
16 është korrigjuar në provën 1D00220 MFI, pra, aty kur thuhet z.
17 Thaçi, duhet të ketë qenë emri juaj. Kur thotë:

18 "Gjatë incidentit me dy gazetarët serbë, ju, ju keni qenë
19 në një fshat në Malishevë."

20 A është e vërtetë? A e keni thënë këtë vërtetë avokatëve
21 të z. Thaçi?

22 PË. Në Malishevë? Po.

23 PY. Ju këtu keni thënë:

24 "Po prisnit në shtëpi për një takim me disa amerikanë.
25 Shoferi i z. Demaçi erdhi dhe i tha S.B.", ju pra, "se

1 gazetarët do të liroheshin.”

2 Ka ndodhur vërtetë kështu?

3 PË. Po, unë atë ditë, domethënë, ditën e lirimit kur është bë
4 të këtyre dy gazetarëve dhe Cen Deskut dhe Jakup Kastratit,
5 unë e kam pritur një delegacion amerikan në shtëpinë time për
6 darkë. Dhe është dasht me shku një ditë, me shku vonë në
7 Malishevë në këtë fshatin Drenovc të Malishevës. Dhe nga aty
8 pastaj kam shku në Dragobil ku është bë ndërrimi, kështu më
9 kujtohet.

10 PY. Më pas thatë që:

11 “Ju kontaktoi z. Byrnes, z. Walker apo z. Byrnes
12 paraqitën një kërkesë diskrete që të përfshinin gazetarët e
13 Tanjugut në grupin e medias që ishin të pranishëm.”

14 Saktë?

15 PË. Po.

16 PY. “Ju folët me telefon me z. Demaçi. Z. Demaçi theksoi se
17 në deklaratën tuaj duhet të përmendni sa më shumë
18 demokracinë.”

19 Saktë?

20 PË. Po, kështu. Masandej ma merr mendja do i kem thënë se
21 kanë qejf ndërkombëtarët me përdorë këtë shprehje.

22 PY. “Z. Demaçi tha se kanalet serbe të mediave mund t’i
23 bashkëngjiteshin gazetarëve të tjerë.”

24 Kështu ka ndodhur?

25 PË. Po. Po këtë ma ka kërku pastaj edhe Shaun Byrnes. Kujtoj

1 ose okej, po më duket se Shaun Byrnes ma ka thënë se vijnë do
2 gazetarë nga -- s'e di nga Tanjug apo e ka përmend që vijnë me
3 përkatësi serbe në atë ngjarje dhe do të ishte mirë që me
4 incizu ngjarjet dhe ata vetë.

5 PY. Sipas shënimit, ju keni thënë që:

6 "Një person që mbante maskë, thatë që kishin dhe dy
7 persona të LDK-së, por ju nuk u pajtuat që dy personat e LDK-
8 së të shfaqeshin para grupit të gazetarëve."

9 Ju kujtohet?

10 PË. Po.

11 PY. Ju nuk kishin shumë dijeni për dy personat e LDK-së, Cen
12 Deskun dhe duhet të kishte qenë Jakup Kastrati këtu, "por
13 kishit dëgjuar se familjet e tyre dhe KVM-ja e KDOM-i po i
14 kërkonin".

15 Saktë?

16 PË. Po, i kanë kërkuar gjithandej ku kanë, ka kanë lëviz. E
17 ka përmend të KDOM-it se dhe KVM-i se janë kërku.

18 PY. "Z. Walker dhe z. Byrnes nuk lanë asnjë gur pa lëvizur
19 për t'i gjetur. Ju nuk e morët vesh asnjëherë se kush i
20 ndaloi."

21 Saktë?

22 PË. Saktë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

24 PY. Më pas vijuat dhe thatë?

25 "Konferenca për shtyp u mbajt në Dragobil përpara zyrës

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 16

1 së KDOM-it amerikan. Ju morët udhëzime nga z. Demaçi. Nuk ju
2 kujtohet nëse kishit marrë ndonjë udhëzim nga z. Thaçi.”

3 E vërtetë?

4 PË. Jo, nuk më kujtohet.

5 PY. Faleminderit. Pra, nuk ju kujtohet që atë keni marrë
6 ndonjë udhëzim nga z. Thaçi, saktë?

7 PË. Saktë.

8 PY. Por ama ju kujtohet që ju ka dhënë udhëzime z. Demaçi?

9 PË. Po, Demaçi, po. Se ma ka çu dhe letrën për atë ngjarje.

10 PY. Pyetja ime e fundit për ju është kjo, është një pyetje që
11 ka të bëjë me identifikimin e dikujt. A e njihni dikën që
12 quhet Nick Turnbull nga KDOM-i i BE-së? A ju kujtohet që të
13 keni folur ndonjëherë ose të keni folur ndonjëherë me Nick
14 Turnbull nga BE-ja, nga KDOM-i i BE-së?

15 PË. S’e di. S’po muj me kujtu.

16 PY. Në rregull. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje tjera
17 për ju.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
19 Nuk kam pyetje tjera për dëshmitarin.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
21 z. Misetiç.

22 Tani, z. Dixon, është fjala përpara rju për të vazhduar
23 me pyetjet tuaja.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

1 Z. DIXON: [Përkthim]

2 PY. Mirëmëngjes, z. Bashota. Unë quhem Rodney Dixon. Do t'ju
3 bëj disa pyetje në emër të klientit tim, z. Kadri Veseli.

4 PË. Mirëmëngjesi.

5 PY. Z. Bashota, dëshiroj të filloj me një dokument të cilin
6 ua treguan dje. Është një dokument i cili ka të bëjë me një
7 takim të Shtabit të Përgjithshëm me datën 13 dhjetor 1998. Ju
8 treguan disa shënime të atij takimi. A ju kujtohet ky dokument
9 ose këto pyetje?

10 PË. Nuk e kam në ekran.

11 PY. A ju kujtohen këto, Dëshmitar?

12 PË. Po. Po.

13 PY. Ju i shpjeguat Trupit Gjykses që këto ishin shënime të
14 cilat janë konfiskuar nga autoritetet serbe në Kosovë gjatë
15 periudhës së luftës, a ju kujtohet që t'ju jetë thënë kjo,
16 Dëshmitar?

17 PË. Jo. Veç në seancë këtu. Ma herët, jo.

18 PY. Po e kam fjalën këtu në seancë, dje, a ju kujtohet që u
19 tha ky si informacion?

20 PË. Po. Po.

21 Z. DIXON: [Përkthim] I kërkoj Sekretares që të paraqesë
22 në ekran një dokument dhe të shohim një dokument që ka të bëjë
23 me këtë temë. Është dokument i cili është i disponueshëm vetëm
24 në anglisht, megjithatë unë do lexoj pjesën përkatëse, ju mund
25 ta merrni përmes përkthimit dhe më pas do t'ju bëj disa pyetje

1 lidhur me të.

2 Dokumenti fillon në faqen 11957, është referenca që ka
3 dhënë z. Halling dje, domethënë, është nga 111957 deri në
4 111966. Domethënë, është përkthimi në anglisht i një dokumenti
5 serbisht. Faqen që do kërkoja të paraqitet në ekran mban
6 numrin 111960. I lutem Sekretares që të zmadhojë pjesën tek
7 paragrafi ose tek numri 47.

8 PY. Do t'jua lexoj të gjithë paragrafin këtu tek numri 47,
9 Dëshmitar. Ju lutem dëgjojeni me vëmendje dhe pastaj do ju bëj
10 disa pyetje:

11 "Shtabi Qendror i UÇK-së vëren nga takimi i 30 dhjetorit
12 1998' janë shënime të takimit të 30 dhjetorit 1998 për të
13 cilën nuk përcaktohen as koha, as vendi dhe as rrethanat e
14 gjetjes, megjithatë mbi bazën e krahasimeve me dokumente të
15 tjera është vërtetuar që shkrimi i dorës përkon me shkrimin e
16 dorës në dokumentin që mban titullin, 'Intervistë me z. Sokol
17 Bashota nga Glas Kosova që mban datën 25 dhjetor 1998', që
18 është gjetur gjatë thyerjes së një bastioni të UÇK-së në zonën
19 e përgjithshme të Metohisë në prill dhe në maj të vitit 1999,
20 siç përshkruhet në shënimin zyrtar të Prizrenit me numër ORDB-
21 je, numër 1926 me datë 15 maj 1999. Duke u mbështetur tek një
22 krahasim, është vërtetuar që shkrimi i dorës në bllokun e
23 shënimeve nga takimi i Shtabit të Përgjithshëm përkon me
24 shënimet e shkrimit të dorës që lidhen me intervistën që u cek
25 më sipër që tregon që autori është i njëjti persona,

1 domethënë, që dokumenti është autentik dhe që ka shumë të
2 ngjarë që të jetë gjetur në të njëjtin vend. Mbi bazën e
3 krahasimit, është konfirmuar se shkrimi i dorës kishte
4 ngjashmëri të dukshme në përgjithësi, në veçanti sa i takon
5 karakteristikave grafike, kështu që mund të thuhet me siguri
6 që shkrimi është shkruar nga i njëjti person, nga i njëjti
7 individ, domethënë, nga Sokol Bashota.”

8 A e shikoni këtë, e dëgjuar këtë paragraf, z. Bashota?

9 PË. Po.

10 PY. Sa për t’ju orientuar lidhur me këtë paragraf, ky është
11 një paragraf i cili vjen nga një raport i Ministrisë së
12 Brendshme serbe që ka datën 5 maj 2022. Është një raport i
13 cili i është dërguar ZPS-së në përgjigje të një prej kërkesave
14 të ZPS-së për informacion nga autoritetet serbe lidhur me
15 origjinën e dokumenteve ku janë gjetur dokumentet, ku janë
16 marrë, e tjerë e tjerë. A e kuptoni këtë informacion,
17 Dëshmitar?

18 PË. E kuptoj.

19 PY. Gjatë dëshmisë dje, a ju kujtohet që iu treguan një kopje
20 të një interviste që keni dhënë për një organ mediatik kosovar
21 dhe ju pyeti z. Halling në qoftë se ishte shkrimi i dorës i
22 juaji me ato shënime që kishit bërë në anë të faqes, a ju
23 kujtohet që ju bë kjo pyetje?

24 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe për procesverbal bëhet fjalë
25 procesverbal bëhet fjalë për dokumentin 09944.

1 PY. Ju kujtohen këto, Dëshmitar?

2 PË. Shkrimi ka qenë diçka tjetër. Gazeta diçka tjetër. Nuk po
3 di tash për ça dokument është fjala. S'muj, s'muj e ndaj.

4 PY. Për të qenë të qartë, juve ju tregua një intervistë dhe
5 keni të drejtë në atë çfarë thatë. Domethënë, ju tregua një
6 intervistë dhe Prokurori ju bëri pyetjen në qoftë se e dalloni
7 shkrimin e dorës në anë të faqes dhe ju thatë që nuk e dini.
8 Ju kujtohet që ju bë kjo pyetje dhe dhatë këtë përgjigje?

9 PË. Po, po.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Për të konfirmuar për
11 procesverbal, kjo nuk është treguar dje, por më datë 28
12 nëntor. Dhe tani është provë e pranuar P1876.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Po, faleminderit që më korrigjuat.

14 PY. Është dokument, i cili ju është treguar të enjten përpara
15 një jave, jo dje.

16 PË. Po.

17 PY. Pra, të jemi të qartë, ju në përgjigje të Prokurorit
18 thatë që nuk e dini në qoftë se ai ishte shkrimi i dorës i
19 juaji apo jo, a keni thënë këtë kur u pyetët të enjten përpara
20 një jave Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. A pajtoheni me mua se këtu në këtë raport nga autoritetet
23 serbe, pra, të Ministrisë së Brendshme thuhet që shënimet e
24 takimit më datë 30 dhjetor 1998 dhe e kam fjalën këtu për
25 shënimet që ju treguan dje dhe këto janë shënime të tjera,

1 pra, ju thuhet që "nuk është përcaktuar koha, vendi apo
2 rrethanat në të cilën janë gjetur këto dokumente"? Pra, këto
3 thuhet në raport. A e dëgjuat këtë dhe a pajtoheni me mua që
4 këto thoshte raporti?

5 PË. Po.

6 PY. A është e drejtë, z. Bashota, të thuhet që me sa ju
7 kujtohet ju edhe sot e kësaj dite juve nuk ju kujtohet në
8 qoftë se i keni shkruar vetë ato shënime lidhur me takimin e
9 datës 30 dhjetor, në qoftë se i keni shkruar në atë kohë ose
10 më vonë se mund të ketë qenë edhe në një datë të mëvonshme? A
11 është e vërtetë kjo?

12 PË. Nuk më kujtohet.

13 PY. A jeni në gjendje të thoni, në qoftë se ju kujtohet, në
14 qoftë se shënimet janë mbajtur të njëjtën kohë kur ka ndodhur
15 dhe takimi, jeni në gjendje ta konfirmoni këtë?

16 PË. Jo, nuk e di. S'muj me thënë këtë.

17 PY. Pra, atëherë i takon që është e mundur që shënimet të
18 jenë bërë më pas, domethënë, jo në kohën kur ka ndodhur
19 takimi, po në një datë të mëvonshme, domethënë, në muajt
20 pasues, vijues, kështu?

21 PË. Ka mundësi. Ka mundësi. Nuk e di.

22 PY. Faleminderit.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Tani të kalojmë tek një faqe tjetër
24 përpara sesa ta heqim dokumentin nga ekrani. Do i kërkoja
25 Sekretares që të paraqesë në ekran faqen 111964. Të kalojmë

1 tek mes i faqes ku shikojmë numrin 18 dhe 58.

2 PY. Do t'ju lexoj përsëri një pjesë të këtij dokumenti, z.

3 Bashota:

4 "Prova më konkrete lidhur me origjinën, kohën, vendin ose
5 mënyrën e gjetjes së dokumentit nuk janë konstatuar sepse një
6 pjesë e dokumentacionit të MUP-it është shkatërruar gjatë
7 bombardimeve ajrore kundër Serbisë në vitin 1999 dhe për
8 pasojë hollësi lidhur me origjinën e dokumenteve të dhëna më
9 poshtë nuk janë gjetur."

10 Një prej këtyre dokumenteve është numri 58 që është:

11 "'Manual me titullin 'Studim Strategjik dhe Taktikat e
12 Luftës në Kosovë - Shërbimi i Zbulimit dhe Kundërzbulimit'
13 Lëvizja Popullore e Kosovës, Prishtinë, 1993."

14 A e shikoni këtë shkruar këtu, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Kjo lidhet me studimin që iu tregoi Prokuroria dhe do
17 t'jua tregoj për një çast këtë dokument dhe ky studim
18 pretendohet që të jetë shkruar në vitin 1993, a është kështu,
19 Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Ky është dokumenti i cili ka numrin
22 provizor të provës P01879, ky është një dokument për të cilin
23 akoma nuk keni vendosur lidhur me pranueshmërinë e tij si
24 prova gjyqësore, të nderuar Gjykatës.

25 PY. Tani, z. Bashota, do shohim bashkë studimin, pra,

1 dokumentin që e ka titullin "Studim".

2 Z. DIXON: [Përkthim] Kështu që për këtë arsye do i
3 kërkoja Sekretares që të paraqitet në ekran.

4 PY. Besoj që ju kujtohet që ky dokument ju tregua nga
5 Prokuroria të enjten, apo jo, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Për Sekretarinë është dokumenti me
8 numër prove P01879, me numër provizor prove siç e thashë dhe
9 më sipër.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kam pjesë të ndryshme
11 për përkthimin në anglisht. A mund të ma sqaroni më
12 konkretisht se për kë dokument bëhet fjalë?

13 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë le të shohim faqen kryesore,
14 ballinën sa për të filluar dhe pastaj do të vazhdojmë me
15 pyetjet e tjera. Faleminderit.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se e ndihmoj avokatin,
17 faqja e parë ka numrin e identifikimit 018901.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Kjo është ballina ose faqja kryesore e dokumentit ose e
20 studimit. Data, sikurse mund ta shikoni këtu, është 1993.

21 Besoj që ju kujtohet që keni parë këtë dokument, apo jo,
22 Dëshmitar? Dhe ky është një dokument të cilin e kemi dhe në
23 versionin në shqip.

24 PË. Po.

25 PY. Z. Bashota, ju keni thënë në përgjigje të pyetjeve që

1 këtë dokument nuk e keni parë asnjëherë më përpara. A është e
2 saktë, se nga ajo çfarë keni parë tani, ky nuk është një
3 dokument të cilin ju e kuptoni që është një prej dokumenteve
4 të prodhuara nga LPK-ja në vitin 1993, a është e saktë kjo,
5 Dëshmitar?

6 PË. Unë nuk muj me e kontestu nëse është i Lëvizjes Popullore
7 të Kosovës, por kam shpreh dyshimet e mia për këtë dokument me
8 një person që nuk e di nëse është e vërtetë. Po unë nuk muj me
9 kontestu. Mund të jetë, po nuk e di.

10 PY. Në rregull. Megjithatë sigurisht që nuk është një
11 dokument që ju e keni parë kur keni qenë brenda LPK-së, kur
12 keni funksionuar brenda LPK-së, keni qenë anëtar i LPK-së, a
13 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Për herë të parë të parë e kam pa këtu.

15 PY. Pra, ju nuk e keni parë asnjëherë këtë dokument në punën
16 tuaj në LPK dhe, në fakt, nuk e keni parë as kur keni punuar
17 për UÇK-në kur keni qenë pjesëtar i UÇK-së, a është kështu,
18 Dëshmitar?

19 PË. Po, e saktë.

20 PY. Pra, me fjalë të tjera, ky nuk është një dokument i cili
21 është përdorur për formimin, formacionin e UÇK-së në mënyrë të
22 tillë që të udhëzohej puna e UÇK-së, apo jo, Dëshmitar?

23 PË. Nuk e besoj.

24 PY. Po ashtu është e saktë apo jo, Dëshmitar, që pa diskutim
25 që ky dokument nuk është përdorur fare nga UÇK-ja në asnjë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 25

1 formë apo në asnjë trajtë për sa i takon formimit të
2 strukturave të zbulimit dhe detyrave që do ju caktoheshin
3 këtyre strukturave në UÇK gjatë luftës, apo jo?

4 PË. Unë nuk jam marrë personalisht, domethënë, me krijimin e
5 atyre strukturave, po unë nuk besoj që ky dokument është një
6 bazë për ato struktura.

7 PY. Faleminderit. Tani do të kalojmë te një ose dy pjesë të
8 këtij dokumenti, sepse thatë më përpara që keni dyshimet tuaja
9 lidhur me këtë dokument.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares që
11 së pari të kalojmë tek faqja 0189-1161.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është faqja e
13 parë.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Po, është faqja e parë. Atëherë
15 duhet të kalojmë tek 1163 do të kalojmë tek pjesa ku thuhet
16 "Betimi ynë".

17 PY. Z. Bashota, e shikoni këtë pjesën që e ka titullin
18 "Betimi ynë". Në paragrafin e parë do t'jua lexoj dhe ju mund
19 ta ndiqni në përkthim, thuhet që:

20 "Unë, anëtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës, në gjuhë
21 përpara Flamurit Kombëtar, në emër të popullit tim, betohem:
22 se do të jem besnik i luftës nacionalçlirimtare, i papërkulur
23 deri në fund, i gatshëm në çdo çast që mos kursej as jetën
24 time për çlirimin e trojeve shqiptare të pushtuara dhe
25 bashkimin e tyre me Shqipërinë."

1 A e shikoni këtë paragrafin, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Është e saktë, apo jo, Dëshmitar, që nga përvoja juaj,
4 pozita e LPK-së ka qenë që -- nuk ka qenë asnjëherë që do
5 kishte bashkim midis Kosovës dhe Shqipërisë, a është kështu,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po mesa ne kemi pas atë informacion, unë e kam sqaru edhe
8 këtu se kam qenë në organizim lokal në komunën e Klinës dhe
9 nuk e di saktë qëndrimet e kryesisë së Lëvizjes Popullore të
10 Kosovës. Por realisht atëherë përpjekja jonë ka qenë thjesht
11 për Kosovën republikë.

12 PY. Pra, nuk ishte për bashkimin me Shqipërinë, apo jo?

13 PË. Po mesa mbaj mend unë nuk ka qenë për bashkimin me
14 Shqipërinë.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek një dokument
16 tjetër. Do i kthehem përsëri këtij dokumenti, por tani për
17 momentin do i kërkoja Sekretares që të kalojmë tek dokumenti
18 1D00203. Konkretisht jam i interesuar që të nxirrni në ekran
19 faqen 4460 në anglisht dhe në shqip, besoj që faqja është e
20 njëjtë si numër.

21 PY. Dokumenti që shikoni është një dokument i programit të
22 statutit të LPK-së. Është një dokument të cilin ua kanë
23 treguar gjatë seancës përgatitore, ju keni thënë që nuk keni
24 pas mundësi që ta njihni këtë si dokument, sepse nuk e keni
25 parë më përpara. Megjithatë tani do t'ju lexoj një pjesë, një

1 paragraf, që është paragrafi i fundit të cilin do ju ftoja që
2 ta dëgjoni në shqip. Pra, është paragrafi që thotë:

3 "Çlirimi dhe formimi i shtetit të pavarur të Kosovës nuk
4 u sjell asnjë të keqe popujve të Ballkanit. Përkundrazi, ai do
5 të jetë shembull i mirëqenies, bashkëpunimit dhe barazisë mes
6 kombeve."

7 E shikon këtë aty, këtë paragrafin, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. A e kujtoni dhe ju kështu realitetin, domethënë, që
10 përqendrimi i programit të LPK-së ka qenë për pavarësimin e
11 Kosovës dhe jo bashkimin e Kosovës me Shqipërinë?

12 PË. Kështu po shkrun tash këtu. Po unë po them se thjesht ka
13 qenë për Republikën e Kosovës në janar të vitit 1993.

14 PY. Po. Për këtë po flas, në veçanti duke e parë këtë
15 informacion edhe në kuadrin e studimit që ua tregoi
16 Prokuroria. Sa u takon pjesëve të tjera të këtij dokumenti,
17 nuk po harxhoj kohë sepse e njëjta temë, e njëjta pikë
18 theksohet dhe në to.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Tani do të kalojmë dhe një herë tek
20 studimi që pamë pak më herët në ekran. Më konkretisht do i
21 kërkoja Sekretares të kalojmë tek faqja 01891224. Mendoj që
22 faqet në shqip dhe në anglisht janë të njëjtat si numër.

23 PY. Jam i interesuar që të shikojmë paragrafin e tretë. Të
24 shohim që të paraqiten në ekran përpara sesa të vijojmë më
25 tej. Atëherë është paragrafi kur fillon që:

1 "Kur shqiptarët e Maqedonisë u grumbulluan për të
2 inauguruar Universitetin e Tetovës", thotë, po duhet të jetë i
3 Kosovës në vend të Tetovës.

4 "... në vitin 1995, në shkurt të 1995, policia ishte
5 njoftuar më herët edhe e kishte rrethuar të gjithë zonën."

6 E shikoni këtë paragraf, Dëshmitar?

7 PË. Po

8 PY. A ju kujtohet një incident në shkurt të 1995-s kur ka
9 ndodhur një gjë e tillë në Universitetin e Tetovës në
10 Maqedoni?

11 PË. Nuk më kujtohet.

12 PY. Megjithatë ju pajtoheni me mua, apo jo, që ka disa
13 papërputhshmëri këtu sepse diskutohet një ngjarje që
14 pretendohet që ka ndodhur në shkurt të 1995-s, ndërkohë që
15 data e këtij dokumenti është 1993. A pajtoheni me mua lidhur
16 me këtë?

17 PË. Jo, nuk po muj me identifiku këtë, me thënë të drejtën.
18 Është e panjohur për mu si dokument.

19 PY. Këtë e kuptoj. Megjithatë këtu përpara kemi një dokument,
20 pra, është një studim i cili pretendohet që të mbajë datën
21 1993, ndërkohë që në këtë pjesë të raportit që ua lexova
22 raportohet diçka që pretendohet të ketë ndodhur në 1995. A nuk
23 ju bën përshtypje kjo, nuk ju duket se është papërputhshmëri?

24 PË. Jo. ndonëse dokumenti është i vitit 1993 dhe i referohet
25 ngjarjeve të vitit 1995, atëherë kjo s'ka kuptim fare. Se nuk

1 po parashoh diçka që do të ndodhë në 1995, por po thotë se po
2 i referohet një ngjarjeje të 1995. Kështu që nuk ka
3 përputhshmëri mes saj.

4 PY. Faleminderit.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 189-1175 tani
6 në versionin anglisht. Ndërkohë që versioni në shqip besoj se
7 ka të njëjtin numër po ashtu.

8 PY. Të shohim paragrafin e parë:

9 "Veprimtaria e shërbimit informativ duhet të jetë e
10 gjithanshme dhe e shumëllojshme."

11 E shikoni këtë këtu, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Ka një rresht aty ku thuhet që informatorët duhet të
14 vërshojnë nga të gjitha anët për t'u bërë syri dhe veshi i
15 luftës çlirimtare."

16 A e shikoni këtë shprehjen e përdorur këtu, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Pra, "për tu bërë syri dhe veshi i luftës çlirimtare".

19 PË. Po.

20 PY. Mesa keni njohuri ju, a është një shprehje kjo që
21 përdorej nga shërbimi informativ nga koha e hershme e
22 komunizmit, domethënë, a e lidhni këtë si shprehje ose si
23 togfjalësh me kohën e komunizmit dhe shërbimin informativ të
24 asaj kohe?

25 PË. Nuk e di këtë. S'muj me thënë se s'më ka rastis ndoshta

1 me ni këtë fjalë ose nëse një tash unë kam mujt me harru, por
2 jo, nuk mujt ta kujtoj.

3 PY. Gjithsesi për të kursyer kohë, dua t'ju them që kemi edhe
4 disa shprehje të tjera në libër, megjithëse nuk di i shikojmë
5 konkretisht, për shembull, jepet një shprehje në faqen 0189
6 deri në 1242 që flitet për partizanët. Po ky si term, pra,
7 partizanët a është një term që sipas jush lidhet me komunizmin
8 në Shqipëri?

9 PË. Po, po, po.

10 PY. Pra, është një term që lidhet me kohën e komunizmit në
11 Shqipëri, kështu e kujtoni, Dëshmitar?

12 PË. Po, po.

13 PY. Z. Bashota, mbase ju nuk kemi pasur mundësi që të shikoni
14 të gjithë dokumentet, megjithatë a jeni në gjendje që të thoni
15 në qoftë se keni parë apo jo në të disa terma të kësaj natyre
16 të cilat juve ju kujtojnë kohën e komunizmit dhe zhvillimet në
17 Shqipëri dhe jo në Kosovë, a do ishte një vlerësim i drejtë ky
18 mbështetur në atë se çfarë keni parë?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Pyetja duhet të kufizohet vetëm
20 tek ato që ka parë sepse nuk e ka parë të gjithë dokumentin në
21 seancë përgatitore.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po prandaj e shtova në fund fare të
23 pyetjes që mbështetur në atë çfarë ka parë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
25 kundërshtimi.

1 Mund të vazhdoni, Dëshmitar.

2 DËSHMITARI: Atëherë duhet me ma bë pyetjen dhe një herë,
3 të lutna?

4 Z. DIXON: [Përkthim]

5 PY. Ajo çfarë po them unë kjo, pra, nga çfarë keni parë nga
6 ky dokument e kuptoj që e keni parë për herë të parë këtë
7 dokument dhe nuk e keni përdorur asnjëherë atë, por nga ajo
8 çfarë e keni parë këtë dokument, ato pjesë që keni parë, a do
9 ishte një vlerësim i drejtë që të thuhej që shumë nga termat e
10 përdorura në këtë vlerësim lidhen me periudhën e komunizmit në
11 Shqipëri dhe lidhen me Shqipërinë, jo me Kosovën, do ishte një
12 vlerësim i drejtë të thuhej ky?

13 PË. Është zor me ardh deri te një përkufizim i tillë në kaq
14 pak sa e kam pa këtë dokument, por me thënë të drejtën bukur
15 shumë ngjason edhe me atë që po thoni.

16 PY. Faleminderit, z. Bashota.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Këto janë pyetjet që kisha lidhur me
18 këtë dokument. Mund të hiqet dokumenti nga ekrani. Mendoj që
19 është momenti i përshtatshëm për të bërë një pushim, në qoftë
20 se do të bëjmë pushim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 z. Dixon.

23 Dëshmitar, tani do bëjmë një pushim të shkurtër prej
24 dhjetë minutash. Do kthehemi përsëri në sallë për dhjetë
25 minuta. Mund të dilni nga salla nën shoqërinë e Sekretares.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
3 pushim për dhjetë minuta.

4 --- Seanca ndërpritet në orën 09.59

5 --- Seanca rifillon në orën 10.11

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam një çështje administrative
7 nëse më lejoni.

8 Më 28 nëntor 2024, ZPS-ja dorëzoi një njoftim të ri për
9 dëshmitarit e rinj që do të vijnë në janar në parashtrimin e
10 protokolluar F02752. Këtu përfshihet dhe informacioni që
11 kërkohet në bazë të paragrafit 74 të Urdhrit mbi Zhvillimin e
12 Procesit Gjyqësor në të cilin përfshihet -- më falni, sipas të
13 cilit duhet të japim dhe ne parashikimet kohore për
14 kundërpyetjet tona dhe kundërshtimet që mund të kemi për
15 provat e propozuara brenda shtatë ditësh sipas kërkesës -- të
16 kërkesës sipas rregullës 154.

17 Mbrojtja ka dy afate të ndryshme atëherë për t'ju
18 përgjigjur dy pjesëve të ndryshme të kërkesës së ZPS-së, një
19 është shtatë ditë, një është dhjetë ditë. Si rrjedhojë, ju
20 kërkojmë që të dyja afatet të shtyhen në mënyrë që t'u
21 përgjigjemi të dyja pjesëve të kërkesave. E diskutuam me ZPS-
22 në paraprakisht dhe ata nuk e kundërshtuan. Dhe dëshironim të
23 dorëzonim përgjigjen tonë deri në 9 dhjetor.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo kërkesë
25 aprovohet.

1 Sillni dëshmitarin në sallë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
4 z. Bashota. Do vazhdojmë me pyetjet e z. Dixon.

5 Z. Dixon, fjala është për ju.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Z. Bashota, tani dua të flas për vitin 1997. Do t'ju bëj
8 disa pyetje lidhur me Shtabin Qendror të asaj kohe.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Po i referohem Shënimit Përgatitor
10 numër 1, paragrafi 4 dhe 36. Nuk është nevoja që të shfaqet në
11 ekran.

12 PY. Por, desha t'ju pyesja a është e vërtetë që ju keni thënë
13 se nuk ka ekzistuar Shtabi i Përgjithshëm në 1997-n. Ka qenë
14 një Shtabi Qendror. Dhe keni thënë se bashkë, se anëtarët
15 kryesorë të atij që u bë Shtabi Qendror ishin Azem Sylja,
16 Xheladin Gashi, Nait Hasani, Xhavit Haliti dhe ju
17 personalisht, pra, anëtarët e parë. Dhe ju keni thënë që nuk
18 ka qenë një shtab në kuptimin e mirëfilltë, ka qenë thjesht
19 "një grup shokësh që u përpoqën të konsolidonin veprimtaritë
20 në terren". Saktë?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, në atë kohë, z. Kadri Veseli nuk ka qenë pjesë e
23 grupit tuaj, apo jo?

24 PË. Nuk ka qenë.

25 PY. Mesa dini ju, kthehemi më pas në kohë, ai nuk ka qenë

1 pjesë e asnjë mbledhjeje dhe zhvillimeve të LPK-së në Zvicër,
2 nëse e dini, kuptohet?

3 PË. Jo, nuk e di. Se në Zvicër s'kam qenë para lufte kurrë.

4 PY. Po. Ju nuk keni qenë. Ju keni qenë në Kosovë, në 1993 dhe
5 vitet pasardhëse, po.

6 PË. Po nuk e di që ka marrë pjesë në ndonjë mbledhje.

7 PY. Po flasim për mbledhjet në Zvicër ë? Që ta konfirmojmë, u
8 kuptuam, pra, ju nuk keni dijeni që ai të ketë marrë pjesë në
9 ndonjë mbledhje të LPK-së në Zvicër?

10 PË. Nuk kam dijeni.

11 PY. Tani kalojmë nga viti 1997 dhe ky "shtabi" për të cilin
12 keni folur ju. Në qershor të 1998-s, ju e keni përmendur disa
13 herë, ju keni thënë se ka pasur një mbledhje në Negroc. A ju
14 kujtohet që keni dhënë dëshmi lidhur me këtë?

15 PË. Po.

16 PY. Kjo është e pasqyruar në Shënimin Përgatitor 2, paragrafi
17 46 dhe 47, këtu keni thënë që janë bërë përpjekje asokohe për
18 të krijuar apo për të bërë një riorganizim të UÇK-së edhe z.
19 Veseli dhe të tjerë kanë qenë pjesë e atij takimi, kështu?

20 PË. Po.

21 PY. Tani unë dua t'ju lexoj diçka nga Shënimi Përgatitor
22 numër 2 dhe më pas do t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Është paragrafi 47.

24 PY. "Ky është takimi ku u bë zëdhënës Jakup Krasniqi për UÇK-
25 në. Emërimet e tjera u përmendën por mbetën thjesht në letër.

1 Por këto emërimet në letër nuk ishin për drejtoritë si G1/G2/
2 e të tjera, në këtë kohë. Marrëveshja ishte që emërimet e
3 tjera që do të bëheshin nuk do të prezantoheshin sepse nuk
4 ishin të pranishëm të gjithë personat e Shtabit të
5 Përgjithshëm dhe ishte e nevojshme të ruhej fshehtësia në
6 mënyrë që njerëzit të kishin mundësi të lëviznin lirisht.”

7 A ju kujtohet ta keni thënë këtë? A ka qenë vërtetë
8 kështu situata asokohe?

9 PË. Po. Dhe në atë kohë, për me plotësu atë, në atë kohë ka
10 qenë vetëm -- ende kanë qenë ato grupe të vogla të organizuara
11 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

12 PY. Po. Dhe ju në këtë takim jeni përpjekur të filloni një
13 riorganizim të UÇK-së, saktë?

14 PË. Po.

15 PY. Ju thatë që u përmendën emërimet por thjesht mbetën në
16 letër. A është e vërtetë që një ato diskutime ajo që keni bërë
17 ju në thelb është që të evidentoni për herë të parë emërimet e
18 ndryshme, sektorët e ndryshëm, por ama në praktikë në ato
19 momente nuk po përpiqeshit që t'i vendosnit në jetë apo t'i
20 vendosnit në praktikë në funksion këto emërimet, saktë?

21 PË. Unë e kam thënë dhe në seancën përgatitore, po edhe këtu,
22 këto diskutime që janë bë për disa emërimet. Thjesht nuk e di
23 as saktë kush për ku është fol dhe pse ato emërimet kanë qenë.
24 Po se thjesht është ka qenë shumë herët për me mendu për me
25 kriju një bërthamë e cila kishte me udhëheqë luftën. Por

1 fokusi më i madh i atij takimi ka qenë pikërisht tek emërtimi
2 apo tek vendosja e një personi si zëdhënës të Ushtrisë
3 Çlirimtare të Kosovës, me qëllim e kemi vendosë që të jetë z.
4 Jakup Krasniqi, një personalitet i shquar atëherë i jetës
5 politike dhe patriotike të kohës dhe një njeri që mendoj se e
6 ka kry punën ma së miri.

7 Po jo fokusi me kriju këto drejtori, për arsye se në atë
8 kohë as nuk ka qenë Azem Sylja, as nuk ka qenë Xhavit Haliti.
9 Pastaj, mesa mbaj mend dhe më kujtohet kjo, z. Thaçi dhe z.
10 Veseli kanë lëvizur disa herë për Shqipëri, gjë që nuk kemi
11 mujt me i funksionalizu këto emërime për të cilat faktikisht
12 s'ka pas emërim dhe të saktë. Ka mujt me u bë diskutime. Po
13 unë nuk e di sesi kanë dalë ato emërime. Po ka pasur vetëm
14 diskutime dhe jo diçka konkrete.

15 Thjesht, madje-madje për me i dhënë përgjigje kësajna,
16 kam thënë se as në letër s'kanë ekzistuar këta emërime.

17 PY. Ju e pranoni se janë mbajtur diskutime, por që nuk janë
18 marrë vendime për krijimin e ndonjë drejtorie. A është një
19 përshkrim i drejtë?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe në të vërtetë, nuk ka pasur drejtori pranë Shtabit të
22 Përgjithshëm të cilat të funksiononin në periudhat korrik,
23 gusht, shtator. Thjesht nuk kanë ekzistuar?

24 PË. Nuk kanë ekzistuar.

25 PY. Tani do të flasim për atë çka ka ndodhur nga nëntori i

1 1998 e në vijim, por sidoqoftë deri në ato momente, pra, vetëm
2 nga mesi i nëntorit të 1998 janë ndërmarrë hapat e parë për
3 krijimin e këtyre drejtorive, saktë?

4 PË. Po.

5 PY. Unë po përpigem ta kuptoj, z. Bashota, çfarë keni bërë ju
6 në këto grupime në muajt qershor, korrik, shtator deri në
7 nëntor. A ishit ju në gjendje, si grup, të drejtonit
8 operacione luftarake në zonat e ndryshme ku kishte prani të
9 njësive të UÇK-së?

10 PË. Jo, nuk kemi mujtur. Këto njësi kanë qenë të
11 vetorganizuara nga komandantët aty ku ka pas zonat të formuara
12 janë udhëhequr nga komandantët e zonave. Por ne si shtab nuk
13 kemi mujt -- si grup, se po them shtab, si grup, nuk kemi mujt
14 për arsye se nuk kemi pas, nuk kemi mujt me u identifiku para
15 tyre.

16 PY. Në atë periudhë a ka ndodhur ndonjëherë që disa nga
17 anëtarët e shtabit të kenë shkuar në këto zona, jo të gjithë
18 anëtarët, po a ka ndodhur që ndonjë prej këtyre anëtarëve të
19 ketë shkuar në këto zona ose në disa prej zonave?

20 PË. Nuk e mbaj mend. Nuk e di.

21 PY. Mesa dini ju ndonjë prej anëtarëve të shtabit është
22 përpjekur t'i vizitojë zonat për të kuptuar çfarë po ndodhte
23 në terren? A ju kujtohet të jetë bërë ndonjë përpjekje në këtë
24 periudhë për të kuptuar çfarë po ndodhte në terren?

25 PË. Mesa më kujtohet, Bislam Zyrapit ka dalë në terren, në

1 teren se është marrë me strukturimin e Ushtrisë Çlirimtare të
2 Kosovës. Për të tjerët nuk kam ndonjë informacion se këta kanë
3 lëvizë, për arsye se nuk e di me kën janë pa, po shumë rrallë
4 kemi pas mundësi me u taku. Në atë kohë kanë qenë edhe
5 ofensivat e shtrine shumë dhe ka pas dhe luftime në pjesë të
6 ndryshme të Kosovës.

7 PY. Pra, ju në atë kohë nuk keni pasur ndonjë takim ballë
8 përballë si grup pas qershorit të 1998?

9 PË. S'e besoj. Nuk e besoj. S'më kujtohet.

10 PY. Z. Zyrapi, kur filloi të punonte, a ju raportonte ju se
11 çfarë po bënte?

12 PË. Jo, por derisa ka përfundu tërë punën e tina, dikun ka
13 fundi i nëntorit -- nga fillimi i nëntorit më duket. Thashë,
14 kur kam qenë në atë pjesë, kam qenë në fshatin tim të lindjes
15 ku ka pas një ofensivë. Se ka qenë fshati i parë që lidhet me
16 zonën e Drenicës. Dhe ka pas luftime të pareshtura aty, aty
17 kanë qenë të grumbulluar një pjesë e djemve të rinj dhe
18 thjesht e kam ni të nevojshme me qenë më afër tyre në ato
19 luftime. Dhe kam qëndru pjesën më të madhe aty. Në qershor, ju
20 thashë edhe dje, kam pas -- e kam humb babën dhe jam marrë
21 kryesisht me familjen në atë pjesë.

22 Dhe nuk më kujtohet saktë nëse ka pas vërtetë një takim.

23 PY. Po. Takimi i nëntorit për të cilin do të flasim ka qenë
24 takimi i parë ku shumica prej jush arritët të mblidheshit
25 bashkë dhe të ndanit informacione, saktë?

1 PË. Po. Mendoj se po. I pari është.

2 PY. Ju thatë që ka pas luftime të ashpra përpara kësaj. Do të
3 flasim dhe për këtë. Por a nuk do të thotë kjo që për shkak të
4 luftimeve ishte tejet e vështirë të komunikoni dhe të
5 takoheshit?

6 PË. Po lëvizja prej një pjese në pjesën tjetër ka pas
7 rreziqe, rreziqe të mëdha për arsye se kurrë s'e ke ditur se
8 ku janë të përqendruara forcat, forcat serbe. Për arsye se ato
9 janë kanë forca mobile dhe kanë lëvizë nga një hapësirë në
10 hapësirën tjetër, përpos atyre pikave të kontrollit që kanë
11 pas të rregullta.

12 PY. Atëherë duke marrë parasysh këto rrethana, ju ia keni
13 lënë në dorë zonës që ta përballnin vetë situatën, të bënin
14 ç'të mundeshin që të luftonin forcat serbe, apo jo?

15 PË. Po zonat të cilat kanë qenë të formuara, po dhe në ato
16 vende ku s'ka pas zona ka pas vetëm njësi të vogla të
17 organizuara, ato me vetorganizim janë përballur me forcat
18 serbe. Për aq sa kanë ditur, për aq sa kanë mujt në atë kohë
19 ato janë vetorganizu.

20 PY. Dhe atëherë u la në dorë të zonave që të bënin emërimet e
21 personave që do të kryenin funksione dhe detyra të ndryshme.
22 Pra, në atë kohë kjo nuk ka qenë përgjegjësia juaj, kështu?

23 PË. Zonat kanë vendos për emërimet brenda, brenda zonës.
24 Madje dhe komandantin e zonës e ka vendosë vetë zona.

25 PY. Dhe ju keni dëgjuar për shumë nga këto emërimet pas

1 faktit, pasi kishin përfunduar?

2 PË. Po.

3 PY. Dua të flasim për diçka që thatë lidhur me z. Zyrapi, kur
4 thatë që z. Zyrapi shkoi në disa nga këto zona për të pasur
5 takime. Ju thatë që ai nuk ju raportoi ju personalisht. Po me
6 sa keni ju dijeni, i ka raportuar ndokujt tjetër në Shtabin e
7 Përgjithshëm në atë kohë?

8 PË. Nuk e di. Nuk e di. Dhe nuk di nëse ka pas nevojë, për
9 arsye se ende s'ka qenë shtabi i formuar në atë kohë. Por ai
10 kryesisht ka punu me komandantë të zonave, ka punu me pika që
11 janë quajtur atëherë të grumbulluara të ushtarëve që kanë qenë
12 në zona të ndryshme. Kryesisht me ta. Ka marrë evidenca. Ka
13 marrë evidenca si në armatim, si në numër të ushtarëve. Ka
14 marrë evidenca edhe për emërime që janë bërë nëpër zona dhe
15 këto. Pastaj në fund, në nëntor i ka paraqitur të gjitha.

16 PY. Po, do flasim dhe për nëntorin, por po përpiqem të kuptoj
17 çfarë ka ndodhur përpara kësaj periudhe, dua të kuptoj deri në
18 ç'përmasa ka pasur koordinim në Shtabin e Përgjithshëm. Dhe po
19 përpiqem të kuptoj nëse ato që bënte z. Zyrapi, vendimet që
20 merrte Zyrapi, hapat që ndërmerre, ndaheshim me ju
21 personalisht apo me të tjerët brenda Shtabit të Përgjithshëm,
22 po përpiqem të kuptoj shkalën e koordinimit.

23 PË. Po në atë kohë me Bislim Zyrapi nuk di se jam taku krejt
24 një herë apo dy. Mund të jetë kështu. Nuk jam shumë i sigurtë.
25 Një herë kur ka qenë në fillim kur ka ardhun dhe s'e di saktë

1 dhe një herë apo dy herë të tjera, për arsye se ai ka lëvizur
2 në tërë, gati në tërë territorin e Kosovës ku ka pas ushtarët
3 të grumbulluar të UÇK-së. Dhe mundësia e tij për me raportu
4 dikujna ka qenë shumë e vogël.

5 PY. Pra, a mund të themi atëherë se në atë kohë nuk ka pasur
6 asnjë sistem për grupin tuaj në Shtabin e Përgjithshëm për
7 ndarjen e informacioneve mes njëri-tjetrit që të kuptonit ju
8 çfarë po ndodhte? Pra, nuk ka ekzistuar një sistem?

9 PË. Jo, nuk ka pas. Nuk ka pasur sistem të tillë. Secili ka
10 shku aty ku vërtetë e ka ni ma të nevojshme se duhet me kanë.
11 Unë thashë në këtë rast kam qëndru në një pikë aty ku janë ka
12 vëllazërit e mi, bashkëfshatarët e mi në pjesën mbi fshatin
13 Kievë ku ka qenë, është një vatër shumë e rrezikshme. Ku
14 përditë jemi granatuar, përditë jemi sulmuar nga forcat, nga
15 forcat serbe. Dhe këto luftime kanë zgjatë prej, mendoj, prej
16 prillit deri në dhjetor më duket, nëntor, dhjetor, në atë
17 pjesë derisa jemi thy si pozicion dhe jemi zhvendosë pastaj ma
18 lart.

19 PY. Pra, kur thonit ju që personat shkonin atje ku e gjykonin
20 të nevojshme, kjo do të thotë që anëtarët e Shtabit të
21 Përgjithshëm shkonin kudo që mendonin se mund të kryenin një
22 detyrë, por kjo nuk ishte diçka që e vendosnit bashkërisht si
23 grup ku duhet të shkoj njëri dhe ku duhet të shkoj tjetri,
24 saktë?

25 PË. Po, po, saktë.

1 PY. Dhe ju thatë se z. Veseli ka shkuar disa herë në Shqipëri
2 gjatë kësaj periudhe kohore që i takon korrik, gusht. Ju
3 kujtohet që e keni thënë këtë?

4 PË. Po.

5 PY. Për këtë a duhet të merrte ndonjë autorizim prej jush apo
6 anëtarëve të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm apo shkonte me
7 iniciativën e vet të kryente detyrat që ai i gjykonte se ishin
8 të nevojshme?

9 PË. Me iniciativën e vet.

10 PY. A e dini ju çfarë detyrash kryente ai kur shkonte në
11 Shqipëri?

12 PË. Nuk e di. Nuk e di. Por e di që sa herë ka ardh në Kosovë
13 e di që ka sjellë armatim. Po ndonjë detyrë specifike të tijna
14 nuk e di. Thjesht s'kemi pyet në atë kohë fort.

15 PY. A është e vërtetë që në atë kohë korrik, gusht, shumë
16 persona kalonin kufirin të merrnin armë, t'i sillnin në
17 Kosovë, të përpiqeshin të forconin njësitet që ishin në Kosovë
18 në mënyrë që të përpiqeshin t'u kundërpërgjigjeshin sulmeve
19 serbe?

20 PË. Po. Mbas thymjes së kazermave të armatimit në Shqipëri,
21 ka qenë një mundësi ma e lehtë. Pastaj të gjithëve që me ardh
22 deri tek posedimi i armëve atje edhe grupe, qofshin grupe,
23 qoftë njerëzit individualisht, qoftë në mënyrë të organizuar
24 kanë shku në Shqipëri dhe janë armatosë.

25 PY. Faleminderit. Tani dua t'ju pyes lidhur me një betejë të

1 caktuar, e kam fjalën pikërisht për betejën e Rahovecit që ka
2 ndodhur në korrik të vitit 1998. Në seancën përgatitore, në
3 paragrafin 64, keni thënë që nuk ka pasur bisedë lidhur me
4 sulmin në Rahovec në Shtab të Përgjithshëm, pra, në nivel të
5 Shtabit të Përgjithshëm përpara sesa të ndodhte sulmi i
6 korrikut të 1998. A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë ZPS-së,
7 Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Është e drejtë, apo jo, Dëshmitar, që vendimi për këtë
10 betejë është marrë nga njësitet lokale atje? Dhe që nuk është
11 dhënë asnjë urdhër në nivel të Shtabit të Përgjithshëm për ta
12 bërë këtë gjë, pra, për të luftuar, a është kështu?

13 PË. Po, kurrë nuk ka pas një urdhër për të hy në Rahovec nga
14 Shtabi i Përgjithshëm. Thjesht ka qenë një gabim shumë i madh
15 madje hyrja e atij grupi, por që s'kemi mujt me e kontrollu
16 ne.

17 PY. Kur thoni që ka qenë "një gabim shumë i madh" e keni
18 fjalën që ka qenë gabim shumë i madh për shkak të reagimit
19 shumë të fortë që pësuar nga forcat serbe si përgjigje, për
20 këtë e keni fjalën?

21 PË. Jo. Edhe kemi parandie për arsye se s'kemi qenë të
22 përgatitur absolut me hy, me sulmu në një vend ku ka, ku ka
23 civilë duke banuar aty. Për shkak të shkallës së
24 rrezikshmërisë së qytetarëve, ne s'kemi guxuar kurrë me marrë
25 një veprim të tillë në vendet urbane. Ky ka qenë gabimi që ata

1 janë fut. Pastaj i ka sjellë pasojat e veta më vonë. Kemi pas
2 edhe humbje të mëdhaja aty dhe thjesht ka qenë edhe një, do të
3 thoja, një çakordim i vetë ushtarëve në atë pjesë.

4 PY. Pra, ishte mungesë përgatitjeje, apo jo dhe Shtabi i
5 Përgjithshëm nuk është se ka qenë i përfshirë në asnjë mënyrë,
6 në asnjë formë në këtë betejë, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. A është e drejtë të thuhet që për arsye të ngjashme si
9 këto, z. Syla vendosi që të sillte z. Zyrapit, që ju e
10 përmendët, në Kosovë si ushtar profesionist i cili do përpiqej
11 që të riorganizonte dhe ristrukturonte UÇK-në? A është kjo
12 arsyeja që pse ka ndodhur kjo?

13 PË. Po nga të gjithë ata emrat që kemi qenë në mbledhjen që
14 kur është zgjedhë zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
15 asnjëri prej neve nuk kemi ndonjë prirje ose aspak s'kemi
16 prirje ushtarake. Ardhja e Bislim Zyrapit në Kosovë me Agim
17 Çelën, pastaj edhe ardhja oficerëve të tjerë të karrierës
18 thjesht i kanë, kanë dhënë një kuptim organizimit të Ushtrisë
19 Çlirimtare të Kosovës dhe ka fillu një strukturim i Ushtrisë
20 Çlirimtare të Kosovës nga njësitet më të vogla deri tek Shtabi
21 i Përgjithshëm. Unë mendoj se e kanë kry një punë shumë të
22 mirë. Kanë sjellë përvoja të vendeve të ndryshme më duket, por
23 realisht gjithmonë duke iu adaptu kushteve dhe mundësive që
24 kemi pas ne si Ushtri Çlirimtare të Kosovës.

25 Por realisht i kemi pas edhe ato probleme. Edhe mbas

1 ristrukturimit i kemi pas problemet tona për shkak të
2 betejave, për shkak pastaj se këto ndodhën në nëntor edhe për
3 shkak të kohës së ftohtë, dimrit që ka mbizotëru për me i
4 implementu këto, por në mënyrë graduale ka shku drejt, drejt
5 finalizimit kjo punë.

6 PY. Do kalojmë tek periudha nga nëntori deri në fund të
7 luftës pak më vonë, megjithatë përpara sesa ta bëjmë këtë gjë
8 do ju bëj disa pyetje për periudhën përpara në mënyrë të tillë
9 që të përfundojmë me këtë pjesë të pyetjeve të mia.

10 Keni thënë në seancën përgatitore që sa i takon betejës
11 së Rahovecit - dhe për procesverbal këtë e keni dhënë në
12 paragrafin 65 - se ju nuk e dini në qoftë se Hashim Thaçi,
13 Kadri Veseli apo Rexhep Selimi kanë shkuar në atë zonë pas
14 sulmit, a është e vërtetë, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
15 PË. Po, nuk e mbaj mend që kam mujt me i taku. Nuk e mbaj
16 mend.

17 PY. Pra, ju keni shkuar vetë në zonë, por ata nuk i keni parë
18 aty. Këtë po thoni, kështu ka ndodhur?

19 PË. Po. Po. Kur kam ndëgjju për rastin unë kam marrë një
20 ushtar aty te vëllavi im në njësinë e tina dhe vullnetarisht
21 kam shku deri tek Rahoveci, po nuk kemi mujt me hy. Aty kemi
22 taku plotë ushtarë të cilët realisht nga sulmet e mëdhaja që
23 bënte ushtria serbe nuk kanë mujt me hy brenda, po flas për
24 këtë pjesën që ishte këndeje nga Malisheva.

25 PY. Në rregull. Faleminderit. Dua t'ju bëj një pyetje që ka

1 të bëjë me të gjitha ofensivat serbe. Nuk dua që të futemi në
2 hollësi lidhur me këtë. Sepse kemi marrë shumë dëshmi sa i
3 takon atyre, po ashtu edhe ju keni dhënë dëshmi për ofensivat
4 serbe. Por dëshiroj t'i kërkoj Sekretares që të paraqesë në
5 ekran një dokument nga fundi i shtatorit të vitit 1998.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Është një dokument i cili është i
7 disponueshëm vetëm në anglisht. Megjithatë do t'ju tregoj një
8 dokument dhe do t'ju bëj pyetje për të ditur në qoftë se
9 situata në terren në fund të shtatorit ka qenë ajo që
10 përshkruhet në atë dokument. Dokumenti mban numrin
11 SPOE00304290 deri në 4293, jam i interesuar që të shikojmë
12 faqet 1 dhe 2 të këtij dokumenti.

13 PY. Nuk ka version në shqip, siç e thashë, megjithatë do t'ju
14 lexoj pjesët përkatëse në anglisht, janë diskutime të cilat
15 ose janë raporte që vijnë nga organet të cilat bëjnë
16 monitorimet, e kam fjalën për ndërkombëtarët që kanë
17 monitoruar situatën në Kosovë, është një dokument i cili mban
18 datën 23 shtator 1998. A e shikoni këtë në fillim fare,
19 Dëshmitar, domethënë, datën a e shikoni, pavarësisht që është
20 në anglisht, po që është 23 shtator 1998. E shihni?

21 PË. Po.

22 PY. Atëherë titulli është "Situata ushtarake" në mes të faqes
23 dhe aty thuhet që:

24 "Përderisa Armata Jugosllave dhe forcat e sigurisë kanë
25 filluar me ofensivat e tyre në fund të korrikut, ata kanë

1 rifituar në mënyrë të suksesshme pjesën më të madhe të
2 territorit që më përpara ka qenë kontrolluar nga UÇK-ja,
3 veçanërisht zonat rreth Malishevës, Deçanit, Junikut, pjesën
4 dërrmuese të Drenicës dhe tani edhe në Shalë.”

5 Ndërkohë që pjesa tjetër është e redaktuar, është e zezë.

6 Kur thuhet Shala, ku është Shala, ku gjendet Shala? A
7 gjendet në pjesën jugore të Kosovës?

8 PË. Në pjesën, kujtoj, në pjesën veriore të Kosovës.

9 PY. Po. Faleminderit për korrigjimin e bërë. Pra, është një
10 pjesë që prefshin Prishtinën deri në veri, deri në kufi me
11 Serbinë, kështu, Dëshmitar?

12 PË. Ajo pjesë është. Nuk e di a përfshinë Prishtinën, po ajo
13 pjesë është. Nuk i di saktë kufijtë e zonave.

14 PY. Atëherë në veri që shkon në kufirin me Serbinë, kështu i
15 takon --

16 PË. Po.

17 PY. -- që të orientohemi pak më mirë, Dëshmitar?

18 PË. Qaty.

19 PY. Faleminderit.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Tani kalojmë tek faqja 2 e
21 dokumentit, kalojmë tek titulli që thotë “Çfarë i ka ndodhur
22 UÇK-së?”.

23 PY. “UÇK-ja duket sikur ë shpërbërë, është shkatërruar.
24 Infrastruktura e UÇK-së, megjithëse nuk ka qenë asnjëherë e
25 sofistikuar, është ndërprerë në mënyrë të suksesshme dhe UÇK-

1 ja është zvogëluar në xhepa-xhepa të shpërndarë në të gjithë
2 vendin. Kjo shpërndarje gjeografike duket që të përkohë me
3 zhvendosjen ideologjike ku mbase ka nivele të ndryshme
4 angazhimi të objektivit fundor të pavarësisë. Vetë Demaçi ka
5 pranuar që UÇK-ja tani është shpërbërë apo është ndarë në
6 grupime të ndryshme autonome duke u hapur kështu potenciali
7 për rivalitetet dhe për luftime të brendshme.”

8 A e dëgjuat përkthimin, Dëshmitar?

9 PË. Kur thotë që UÇK-ja është shkatërruar, është shpërbërë,
10 është kolapsuar, a mendoni ju që ky është një përshkrim i
11 saktë i asaj çfarë ka ndodhur në muajt korrik, gusht, shtator
12 për shkak të ofensivave serbe?

13 PË. Që është shkatërruar nuk mund të them që është shkatërru
14 Ushtria Çlirimtare e Kosovës, për arsye se -- po që është
15 kolapsuar po, për arsye se ka qenë ofensiva shumë të mëdha të
16 ushtrisë serbe dhe është e vërtetë që aty kemi pësuar një
17 goditje shumë të madhe nëpër krejt qendrat ku ka qenë Ushtria
18 Çlirimtare e Kosovës e përqendruar dhe realisht, po, kanë ra
19 territore të cilat realisht janë ka në kontrollin e Ushtrisë
20 Çlirimtare të Kosovës.

21 PY. Po ç'mund të na thoni për komentit këtu që mund të hapej
22 mundësia për rivalitete dhe për përçarje të brendshme ose
23 luftime të brendshme, çfarë mund të thoni lidhur me këtë? Në
24 pozitën që keni pasur juve a ishte diçka për të cilën ishit i
25 shqetësuar ju në atë kohë?

1 PË. Ma përkthe dhe një herë, të lutna?

2 PY. Atëherë pyetja që kam për ju është kjo: Në këtë raport
3 thuhet që situata ose kolapsi i UÇK-së kishte hapur gjithashtu
4 edhe mundësinë ose potencialin për rivalitet dhe për luftime
5 të brendshme, për përplasje të brendshme në UÇK dhe po ju pyes
6 në qoftë se kjo është diçka që ju e keni parë vetë në
7 pozicionin ose në rolin që keni pas në atë kohë?

8 PË. A fjala domethënë është për mundësitë për probleme se ka
9 mujt me pas Ushtria Çlirimtare mes vete?

10 PË. Po.

11 PË. Nuk kam ndonjë informacion që ka pas të bëjë një
12 përplasje të këtyre përmasave sa me e dëmtu reputacionin e
13 UÇK-së për atë kohë. Nuk kam informacion.

14 PY. Atëherë cilat janë vështirësitë e tjera që keni parë dhe
15 çfarë mund të thoni sa i takon aftësisë për të kontrolluar
16 persona në zona të caktuara në Kosovë? A është kjo diçka që ka
17 dalë në pah dhe që ka vazhduar gjatë kësaj periudhe, është
18 diçka që e keni vënë re, Dëshmitar?

19 PË. Po kanë qenë, lëvizjet kanë qenë më shumë se çdo herë
20 gati të kufizuara për me lëvizë në terren. Është e vërtetë se
21 furnizimi nga Shqipëria është vështirësu shumë me u furnizu me
22 armë nga atje. Edhe pastaj edhe logjistika tjera na kanë
23 mungu, si veshmbathje e logjistikë tjetër. Kështu që, po, i ka
24 pas vështirësitë e veta të mëdha në atë periudhë.

25 PY. Në rregull. Është e drejtë, apo jo, që të thuhet që kjo

1 në fakt ka stresuar dhe ka mundur që të krijojë gjurmë mbi
2 organizatën dhe që të dëmtonte organizatën. Do ishte një
3 vlerësim i duhur ky? Domethënë, që ka pasur pasoja negative
4 mbi UÇK, me fjalë të tjera?

5 PË. Ka pas. Ka pas mundësi, po.

6 PY. Atëherë do kalojmë tek nëntori dhe pjesa në vijim,
7 megjithatë këtë synonit juve që të trajtonit ju me z. Zyrapin,
8 domethënë, ideja ishte që të vinte z. Zyrapin dhe ta zgjidhte
9 këtë situatë pasi kishin ndodhur dëmet përkatëse nga ofensivat
10 serbe mbi UÇK-në, kështu?

11 PË. Nuk e di saktë për naj problem që ka mujt me bë tash i
12 atyre përmasave sa me dëmtu UÇK-në. Nuk më kujtohet naj
13 problem i madh dikund.

14 PY. Nuk jam i sigurtë në qoftë se e kuptova përgjigjen që
15 dhatë. Unë thjesht po ju parashtroja, po ju thoja që UÇK-ja si
16 rezultat ishte dëmtuar për pasojë të ofensivave serbe dhe ju
17 në nëntor po përpiqeshit që të trajtonit këtë situatë që
18 kishte ndodhur.

19 PË. Po.

20 PY. A ju kujtohet që keni ndjekur këtë sekuencë ose këtë rend
21 ngjarjesh?

22 Tani do ju kërkoj që të shikojmë një tjetër pjesë të
23 dokumentit, domethënë, është në faqen 3, është një faqe e cila
24 flet për "Situatën humanitare". Këtu thuhet si më poshtë:

25 "Ofensivat e verës i kishin përkeqësuar një situatë që

1 ishte edhe e rëndë që në fillim. Vlerësohet që rreth 250,000
2 persona ishin zhvendosur si brenda vendit ashtu edhe jashtë
3 vendit. Shqipëria kishte rreth 15.000 refugjatë, ndërkohë
4 Maqedonia kishte 1000 dhe Mali i Zi 40,000.”

5 I shikoni këto shifrat në këtë tekst që sapo ju lexova,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. A ju kujtohet që keni qenë në terren dhe që keni parë
9 numra të konsiderueshëm të personave të zhvendosur, persona të
10 cilët kalonin nga një fshat tek tjetri, persona që mundoheshin
11 që të mbijetonin dhe shumë prej tyre të cilët kalonin dhe
12 kufirin, a ju kujtohet kjo?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Cila është relevanca e kësaj
14 pyetjeje?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
16 kundërshtimi.

17 Ju lutem përgjigjuni pyetjes.

18 DËSHMITARI: Po, ka pas, ka pas lëvizje të qytetarëve nga
19 një fshat në tjetrin. Familja, duke u nisur prej familjes time
20 e cila ka lëvizur, ka ndërruar përmbi 10-15 vendqëndrime. E
21 plotë familje të tjera të qytetarëve të Kosovës kanë lëvizur
22 duke u munduar me mbijetu në qendra të ndryshme. Dhe
23 shpeshherë kanë kriju tollovi aq të mëdhaja qytetarët sa janë
24 grumbullu me mijëra vetë nën një fushë apo në një pjesë të
25 ndonjë mali apo vende të ndryshme.

1 Z. DIXON: [Përkthim]

2 PY. Megjithatë ajo çfarë dua t'ju pyes, dhe që ka lidhje me
3 postin që keni pas ju ose pozitën që keni pas ju, është që
4 çfarë sfide ka krijuar kjo për ju, domethënë, në Shtabin e
5 Përgjithshëm? Çfarë sfidash ju janë krijuar kur ju është
6 dashur të krijoni këtë problem?

7 PË. Po. E para, është dasht që Ushtria Çlirimtare e Kosovës
8 të ketë një përqendrim më të madh rreth mbrojtjes, u quajshin
9 refugjatë ose lëvizjeve të qytetarëve në mënyrë që mos me ra
10 pre e forcave të armikut, për aq sa ka pas mundësi. Andaj i ka
11 pas edhe këto pasoja se u dasht me u përqëndru shumë më shumë
12 gjatë lëvizjes tyre. Për arsye se shumica prej tyre nuk kanë
13 ditur pozicionet e serbëve ku kanë qenë. Kështu që u është
14 dasht me ushtarë të ndryshëm me ju diktu rrugën se ka të
15 kalojnë ose ka të shkojnë. Kështu që ka qenë një sfidë. Pastaj
16 shpeshherë kanë pas probleme edhe me furnizimin në ushqim e
17 nevoja tjera që të shumtën e rasteve ushtarët e UÇK-së kanë
18 qenë në mbështetje të qytetarëve që u quajshin në atë kohë
19 refugjatë edhe brenda Kosovës.

20 PY. Po. Edhe për t'i ndihmuar ata për të kaluar kufirin, apo
21 jo, sepse nuk ishte e sigurtë që të kaloje as kufirin, a është
22 kështu, Dëshmitar?

23 PË. Me siguri. Neve në atë pjesë nuk kam ndonjë informacion
24 për pjesën me kufirin. Po përbrenda zonave e di se aty i kam
25 pas edhe familjen në disa grumbullime. Kështu që për kufi nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashora (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 53

1 e di, po me siguri që edhe për pjesën e kufirit është dashtë
2 dikush me organizu që ata me kalu ma mirë mundësinë më të mirë
3 të mundshme mos me u rreziku.

4 PY. Në rregull. Faleminderit.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që ky
6 dokument, ky raport përmbledhës i shtatorit të vitit 1998 të
7 pranohet si prova gjyqësore sepse sipas nesh përmbushet *prima*
8 *facie* për pranueshmërinë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
10 kundërshtim?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, me kushtin
12 që klasifikimi të jetë konfidencial për këtë dokument.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që ka
14 redaktime që janë bërë për pjesët që kanë informacion të
15 ndjeshëm ose konfidencial, kështu që nuk e kuptoj sepse
16 ndoshta nuk mund të klasifikohet si publik dokumenti, nuk e
17 kuptoj arsyen.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj se ky është një kusht i
19 dhënë nga ofruesi i informacionit.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Atëhere e kuptojmë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
22 SPOE00304290 deri në 10304293 pranohet në provë gjyqësore dhe
23 klasifikimi është konfidencial.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
25 të marrë numrin e provës 2D33.

1 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Z. Bashota, kam edhe një temë tjetër për të trajtuar
3 përpara sesa të bëjmë pushimin. Në periudhën dhe tani po
4 flasim në fakt për fundin e shtatorit, në këtë periudhë
5 vazhdoni negociatat me FARK-un jashtë shtetit, domethënë, në
6 Shqipëri dhe në Turqi. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar? Dhe a
7 ishit të informuar, a ishit në dijeni lidhur me këtë?

8 PË. Jo, unë nuk kam qenë i informuar për këtë, për këtë
9 pjesë. Mbasi është bë një marrëveshje me FARK-un, Bislim
10 Zyrapit kur ka ardh në Kosovë më ka thënë se marrëveshja është
11 arrit me FARK-un që ushtarët dhe oficerët e FARK-ut të hijnë
12 në Kosovë dhe të hijnë nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të
13 Kosovë. Vetëm kaq kam marrë informacion prej Bislim Zyrapit,
14 ma tepër jo.

15 PY. Pra, me sa kuptoj unë, ju po thoni që ai nuk erdhi dhe
16 bisedoi me ty përpara sesa të shkonte dhe të organizonte këtë
17 takim me FARK-un, po ai shkoi te z. Veseli. Pra, ai nuk është
18 se erdhi te ju në mënyrë të tillë që të kishte kompetencë
19 kolektive ose nga të gjithë në mënyrë të tillë që të shkonte
20 jashtë shteti dhe t'i kryente këto negociata, a po thoni këtë,
21 është e saktë kjo?

22 PË. Me mu nuk është konsultu për këtë rrugëtim të tina.

23 PY. A e dini që s'është konsultuar ai me z. Veseli apo me
24 anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm përpara sesa të
25 shkonin këto udhëtime për bërë këto negociata, këto biseda?

1 PË. Këtë nuk e di. Këtë nuk e di.

2 PY. Hera e parë që keni dëgjuar lidhur me atë se çfarë po
3 ndodhte apo si ishte situata është kur ata u kthyen,
4 domethënë, kur z. Zyrapi dhe z. Veseli u kthyen nga udhëtimet
5 e tyre dhe kur ju raportuan që marrëveshja ishte kryer. Kështu
6 e kujtoni, kështu ka ndodhur?

7 PË. Mu nuk më kujtohet nëse është kthi z. Veseli me Bislimi.
8 Por kur e kam taku Bislimin këtë ma ka thënë, mes të tjerave,
9 se FARK-u ka pranuar që t'i dërgojë oficerët nën emblemen e
10 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ushtarët. Nuk më është
11 dhënë asnjë, asnjë marrëveshje, asnjë dokument tjetër rreth
12 kësaj teme.

13 PY. Po. Ky ka qenë një zhvillim pozitiv kur e keni dëgjuar,
14 apo jo, sepse më pas në nëntor i takonte që ushtarët
15 profesionistë të FARK-ut do të ishin pjesë e UÇK-së dhe do të
16 përpiqeshin që të jepnin kontributin e tyre për ristrukturimin
17 dhe gjithashtu edhe do të jepnin kontributin e tyre dhe për të
18 luftuar forcat serbe, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Po ne, me thënë të drejtën, duke mos qenë njohës të mirë
20 të artit ushtarak atëherë dhe të idesë se si të organizohet
21 Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ardhja e oficerëve të karrierës
22 a kanë inkurajuese për gjithsecilin, për arsye se pavarësisht
23 se ata shkollën e kanë kryer në ish-Jugosllavi atëherë, besoj,
24 se të qënurit e tyre në mërgim iu ka ndihmuar që të kenë
25 njohuri pastaj edhe tjera dhe i kanë implementuar në Kosovë.

Dëshmitari: Sokol Bashora (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 56

1 Kështu që ka qenë një veprim i mirë që është bërë në atë kohë.
2 Nuk e s'e kam gjyku kurrë. Thjesht e kam përshëndet si ide
3 ardhjen e tyre për arsye se e thashë i kanë dhënë një dinamikë
4 tjetër.

5 PË. Faleminderit, Dëshmitar.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Z. Gjykatës, nuk e di në qoftë se do
7 bëjmë pushimin tani.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do bëjmë
9 pushim për gjysmë ore, Dëshmitar. mund të dilni së bashku me
10 Sekretaren nga salla e gjyqit, do të takohemi përsëri këtu në
11 orën 11.30.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Sa i takon kohës, dua t'ju
13 përditësoj, se besoj që do përfundoj në seancën tjetër për 45
14 minuta.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
16 z. Dixon.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
19 pushim deri në orën 11.30.

20 --- Pauza fillon në orën 11.01

21 --- Seanca rifillon në orën 11.31

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
23 sillni dëshmitarin në sallë.

24 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Unë ju
25 thashë fillimisht që do më duheshin katër orë me këtë

1 dëshmitar. Por, thjesht dy orë do të përdor përfundimisht.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
3 Faleminderit.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë kisha kërkuar një orë e
5 gjysmë. Do të përdor më pak kohë se ç'kisha kërkuar dhe
6 ekziston dhe mundësia që të mos bëj asnjë pyetje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,
10 Dëshmitar. Do të vazhdojë me pyetjet z. Dixon.

11 Z. Dixon, fjala është për ju.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Z. Bashota, dua t'ju pyes diçka që po bisedonim para
14 pushimit. Pra, lidhur me FARK-un. Ju keni thënë më përpara,
15 dhe unë po i referohem Shënimit Përgatitor numër 1, paragrafi
16 10. Nuk është nevoja ta shfaqim në ekran. Ju keni thënë, pra,
17 se shfaqja e emblemave të FARK-ut -- dhe bëhet fjalë përpara
18 shtatorit dhe përpara procesit të unifikimit. Pra, shfaqja e
19 emblemave të FARK-ut ishte diçka që sipas jush ishte një
20 informacion që ua kishin dhënë shërbimet e zbulimit. Pra ju
21 keni thënë:

22 "Burimi i informacionit që të ka ardhur nga shërbimi i
23 zbulimit ishte prej personave të panjohur. Pra, nuk e dinit
24 konkretisht se prej cilit person, por ju besonit se kishte
25 ardhur nga shërbimi i zbulimit."

1 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë ZPS-së?

2 PË. Po.

3 PY. Atëherë, a është e drejtë të themi që ju nuk keni ndonjë
4 informacion konkret sa u takon këtyre shenjave apo emblemave
5 të FARK-ut nëse vërtet ka ardhur apo nuk ka ardhur nga
6 shërbimet e zbulimit pranë UÇK-së, saktë?

7 PË. Saktë.

8 PY. Ju nuk e keni ditur as kush ish in këta persona, as me kë
9 punonin dhe as kujt i raportonin?

10 PË. Jo, nuk kam dit.

11 PY. Gjithashtu ju bënë disa pyetje lidhur me z. Tahir Zemaj,
12 mbase ju kujtohet kjo gjë. Bëhet fjalë për informacionin që
13 kishit marrë për të se ai ishte një person që merrej me drogë,
14 dhe ky ishte një informacion që kishte ardhur nga shërbimi i
15 zbulimit. Ju kujtohet kjo?

16 PË. Po.

17 PY. A është e vërtetë që dhe në këtë rast ju nuk kishit
18 ndonjë informacion konkret që vërtet ky informacion erdhi nga
19 shërbimi i zbulimit, nga ndonjë person konkret në sektorin e
20 zbulimit, apo nga ndonjë grup në UÇK?

21 PË. Po nuk e mbaj mend se çfarë funksioni kanë pas, por
22 thjesht nga rëndësia e këtij informacioni kam konstatuar se
23 mund të jenë punëtorët e shërbimit. Kjo ka qenë vetëm
24 përshtypja imja.

25 PY. Pra, është një supozim ky nga ana juaj. Nuk është se

1 kishit ndonjë informacion konkret që informacioni të kishte
2 buruar nga sektori i zbulimit?

3 PË. Nuk i kam njoft ata persona. Thjesht janë kanë të
4 rëndomtë. Andaj edhe kam mendu se është pikërisht shërbimi.

5 PY. Ju po ashtu thatë që njihej botërisht që kishte akuza se
6 ai ishte trafikant droge. Ishte e vërtetë një -- më falni,
7 ishte vërtetë një informacion që njihej nga të gjithë ky, që
8 dhe personat flisnin për këtë gjë?

9 PË. Po, këtë ma vonë tani e kemi mësu. Në fakt e kam mësu se
10 edhe gjyqi është mbajtur ma herët, por këtë e kam mësu mbas
11 luftës.

12 PY. Që ta sqarojmë këtë pikë. Ne po flasim për periudhën
13 përpara nëntorit, që ta kemi të qartë. A është e vërtetë pra
14 që në nivelin tuaj në nivel të Shtabit të Përgjithshëm, nuk ka
15 pasur as shërbim të zbulimit, dhe as sektor të zbulimit?

16 PË. Në cilin muaj dhe njëherë, për cilin muaj, ju lutna?

17 PY. Përpara nëntorit. Përpara nëntorit e kam fjalën. Para
18 nëntorit. Nuk ka ekzistuar ndonjë sektor zbulimi në nivelin
19 tuaj. Kur them në nivelin tuaj, në nivel të Shtabit të
20 Përgjithshëm.

21 PË. Nuk ka pas.

22 PY. Pra, nëse kryhej ndonjë punë zbulimi, kjo mund të kryhej
23 në zona apo në grupime brenda komandës së zonës. A ju kujtohet
24 dhe ju kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Por nuk ka pasur ndonjë koordinim nga ana e Shtabit të
2 Përgjithshëm për këtë fushë?

3 PË. Në atë kohë jo, për arsye se komandantët e zonave, apo
4 shtabet e zonave, kanë bo strukturimin e vet nëpër zona, duke
5 imituar ose duke marrë prej ndonjë organizimi ushtarak dikund
6 tjetër, qoftë Shqipëri qoftë dikund tjetër, dhe i kanë kry
7 disa strukturime mbrenda zonës së vet.

8 PY. Po. Dhe ju në Shtabin e Përgjithshëm nuk kishit lëshuar
9 asnjë urdhëresë dhe asnjë rregullore se si duhej bërë kjo
10 punë, saktë? Si duhej trajtuar kjo punë.

11 PË. Jo. S'ka pas, tamam.

12 PY. Dhe as nuk keni marrë ndonjë raport në Shtabin e
13 Përgjithshëm?

14 PË. Jo, s'kemi marrë.

15 PY. Sa i takon masave disiplinore ndaj ushtarëve në UÇK në
16 atë kohë. Kur themi në atë kohë, themi gjithmonë përpara
17 nëntorit të 1998. Nuk ka qenë detyra juaj dhe e personave të
18 tjerë në Shtabin e Përgjithshëm të merrnin masa disiplinore
19 ndaj ushtarëve apo qoftë dhe të mbikëqyrnin masat disiplinore,
20 saktë?

21 PË. Po.

22 PY. Një aspekt tjetër përpara se të flasim për nëntorin. Në
23 Shënimin tuaj Përgatitor numër 1, në paragrafët 12 dhe 13, ju
24 përmendni çështje disiplinore, por lidhur me ushtarët e Ramush
25 Haradinajt në zonën e Dukagjinit. A ju kujtohet ta keni

1 diskutuar këtë çështje?

2 PË. Po.

3 PY. A është e vërtetë se ndonëse i keni sqaruar këto aspekte
4 në Shënimin Përgatitor 1, pra a është e vërtetë, me sa ju
5 kujtohet ju, nuk keni ndonjë informacion që të jetë i
6 përfshirë z. Veseli në ndonjë formë në disiplinimin e
7 ushtarëve të Ramush Haradinaj? Kjo ishte një çështje që e
8 trajtonte vetë z. Haradinaj në zonën e tij, saktë?

9 PË. Po, saktë është.

10 PY. Faleminderit. Tani dua të flas për takimin e nëntorit që
11 e kemi përmendur disa herë. A është e vërtetë që ky takim
12 është mbajtur më 12 dhe 13 nëntor të 1998?

13 PË. Saktë nuk e di datën, por në nëntor po. Mund të jetë ajo
14 datë.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Të shohim procesverbalin me shkrim
16 dore të këtij takimi. Mban numrin 4D00011, e kemi dhe në
17 anglisht edhe në shqip. Të shohim nëse përputhet kjo me
18 kujtesën tuaj. Janë shënime me shkrim dore nga ky takim i
19 datës 12 dhe 13 nëntor.

20 PY. E njihni shkrimin e dorës në të majtë të ekranit tek
21 versioni i shqipes?

22 PË. Jo, nuk e njoh.

23 PY. Jeni i njohur me përmbajtjen e këtij teksti? Pra,
24 mbledhja është mbajtur në 12 nëntor, dhe ka vijuar më tej më
25 13 nëntor dhe persona të ndryshëm kanë qenë të pranishëm në

1 këtë takim.

2 PË. Mund të jetë kështu, por unë këtë dokument nuk e kam pa
3 kurrë.

4 PY. Në rregull. Atëherë, na ndihmoni ju lutem. Ju keni qenë
5 aty. Cilat kanë qenë diskutimet kryesore në këtë takim? Më
6 përpara thamë që ky është takimi i parë kur jeni mbledhur të
7 gjithë së bashku qysh prej qershorit. Me pak fjalë, mund të na
8 tregoni çfarë keni diskutuar në këtë takim?

9 PË. Po këtu në -- tash, saktë, se kjo është para 26 viteve,
10 25-26. Detajet nuk muj me i dit, dhe nuk e kam dit se një ditë
11 kanë me më hy në punë kështu për me i thanë këto detale. Por,
12 realisht në këtë takim është, janë, është diskutuar rreth
13 strukturimit të cilët i ka pru Bislam Zyrapi në Shtabin e
14 Përgjithshëm, dhe rreth emërimeve duke u nisur nga komandanti,
15 zëvendëskomandantët, shefi i shtabit, dhe këto drejtoritë --
16 jo drejtoritë, por këto, ato kanë qenë të organizuara G1, G2,
17 G3, G4, këto që është informacion ushtarak. Është një udhëzim,
18 kështu ushtarak që unë për vete nuk e kam njoft, dhe nuk e
19 njoh.

20 PY. Pra, synimi ka qenë krijimi i drejtorive në nivel të
21 Shtabit të Përgjithshëm, saktë?

22 PË. Po.

23 PY. Këtë e keni bërë me propozim të z. Zyrapi, në mënyrë që
24 të përpiqeshit dhe të krijonit një farë rendi mbi kaosin që po
25 mbizotëronte, saktë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashora (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 63

1 PË. E saktë.

2 PY. Po ashtu e keni bërë dhe që t'u tregonit ndërkombëtarëve
3 forcën ushtarake tuajën dhe që t'ju merrnin seriozisht ose të
4 paktën të jepnit në pamje të parë, domethënë, faktin që kishit
5 një organizatë të strukturuar ushtarake, të jepnit ndonjë
6 pamje të parë --

7 PË. I nderuar avokat, në atë periudhë strukturimi i një
8 formacioni ushtarak në kushte të luftës besoj që mundet me e
9 marrë me mend nga gjithsecili dhe problematikat me të cilat ne
10 jemi përballur gjatë këtij strukturimi. Edhe një, personalisht
11 dhe çdo qytetar i Republikës së Kosovës në atë kohë ka pasur
12 dëshirë që Shtabin e Përgjithshëm dhe Ushtrinë Çlirimtare të
13 Kosovës ta ketë në hierarkinë ma të mirë të mundshme. Por,
14 qëllimi ky ka qenë. Thjesht me dalë sa ma të organizuar para
15 opinionit ndërkombëtar, para opinionit vendor, se është,
16 ekziston një strukturë e organizuar mirë. Janë përdor edhe
17 hiperbolizime në deklaratat të ndryshme, por realisht qëllimi
18 ka qenë që të paraqitet Ushtria Çlirimtare e Kosovës sa ma
19 mirë në atë kohë.

20 PY. Po. Por nuk ka ndodhur menjëherë? Pra, u desh të kalonte
21 dhe dhjetori, janari, shkurti, që të hidhnit themelet dhe të
22 ishit funksionalë, saktë?

23 PË. Saktë. Mbas problemeve që ndodhën edhe me komandantët e
24 zonave, saktë. Veç kjo mbas, dikund, shkurt, mars është
25 përfunduar.

1 PY. Nuk po e mbuloj pjesën që e diskutuam tashmë sa u takon
2 vështirësive që patët ju për çështjet eprore. Por unë tani dua
3 të flas konkretisht për z. Kadri Veseli. A ju kujtohet ju që
4 dhe ai ka qenë pjesërisht në këtë takim më 12 nëntor?

5 PË. E kam të pamundur me dit të gjithë emrat e atyre që kanë
6 qenë, për arsye se kemi qenë një numër ma i madh i anëtarëve
7 aty prezent, dhe nuk muj me dit nëse vërtet ka qenë prezent
8 Kadri Veseli aty. Nuk mbaj mend, nuk më kujtohet.

9 PY. A ju kujtohet ose do t'jua them në këtë formë. A ju
10 kujtohet që ai erdhi me z. Zyrapi sepse ata kanë qenë të
11 përfshirë në bisedimet me FARK-un, dhe ka ardhur për këtë
12 takim dhe ka qëndruar vetëm një pjesë të kohës në takim, a ju
13 kujtohet kjo?

14 PË. Nuk e mbaj mend. Nuk e mbaj mend. Unë thashë kur ka ardh
15 Bislum Zyrapi nuk kam dit që kanë ardh së bashku me z. Veseli.
16 Por në këtë takim nuk më kujtohet saktë se sa ka qëndru apo a
17 ka qenë z. Veseli në takim. Mund të jetë, mund të jetë,
18 por --.

19 PY. Në rregull. Atëherë, a ju kujtohet që në këtë momente
20 janë bërë disa diskutime dhe është arritur një marrëveshje që
21 ai do të ishte përgjegjës për drejtorinë informative, për G2?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe si rezultat i kësaj, i këtij vendimi, ai u dërgua
24 jashtë Kosovës që të merrte formimin e nevojshëm. Ka qenë kjo
25 pas takimit të nëntorit. A ju kujtohet dhe ju të ketë ndodhur

1 kjo?

2 PË. Këtë ma ka thanë Bislum Zyrapi kur kemi diskutu pastaj
3 dhe në kohë të lirë ashtu, se z. Veseli duhet me i taku
4 shërbimet e huaja, dhe me i marrë trajnimet e nevojshme për
5 këtë detyrë, për arsye se është një sektor i ri që po hyn në
6 organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe thjesht i
7 duhet përgatitja e nevojshme për këtë fushë. Dhe ma z. Veseli
8 s'e kam pa, në kohë të gjatë s'e kam pa.

9 PY. Po. Ka ndodhur pas Rambujesë në fakt. Është kthyer pas
10 Rambujesë. Do flasim për këtë pak më vonë. Por unë do të doja
11 të sqaroja atë që ju ka thënë z. Zyrapi. Z. Zyrapi a ju tha ju
12 që po e dërgojmë z. Veseli jashtë vendit edhe për t'u
13 stërvitur, apo për t'u trajnuar, por dhe që të takohet me
14 shërbimet e huaja informative, saktë?

15 PË. Po, po. Kështu për afërsisht.

16 PY. A ju tha ai ju që ai do të mbulojë shërbimin informativ
17 jashtë vendit në mënyrë që të ndërtojë marrëdhënie me
18 shërbimet homologe informative jashtë vendit në mënyrë që të
19 ndihmonin UÇK-në?

20 PË. Po tash këto detale krejt nuk i mbaj mend. Por që ka
21 nevojë me shku jashtë, dhe me pas kontakte me shërbimet e
22 huaja, po. Edhe për nevoja trajnimi, edhe për nevoja të punës
23 me të cilën është ngarku.

24 PY. A ju kujtohet ju që është diskutuar edhe fakti që kjo ne
25 mund të na ndihmojë t'ju tregojmë ndërkombëtarëve se UÇK-ja po

1 zhvillohet dhe do të bëhet një ushtri profesioniste, sepse do
2 të kishte kontakte edhe me sektorët informativë jashtë vendit?

3 PË. S'më kujtohet kjo.

4 PY. E kuptoj, ka kaluar shumë kohë. Unë thjesht po përpiqem
5 të kuptoj çfarë keni ditur ju në atë kohë.

6 PË. Po, [E pakuptueshme].

7 PY. Ju thoni që nuk ju kujtohet që të ketë qenë i pranishëm
8 z. Veseli. Po a mbani mend të jetë diskutuar në atë takim
9 krijimi i G2?

10 PË. Po. Kur e ka prurë një organigramë Bislir Zyrapi është
11 përmendur edhe G1, G2, G3, deri në -- disa numra, tash nuk e
12 mbaj mend saktë sa. Por, po.

13 PY. Ju thotë që gjatë kohës që z. Veseli ka qenë jashtë
14 vendit, ju nuk e keni parë për një kohë të konsiderueshme. Por
15 ju personalisht, apo persona të tjerë në Shtabin e
16 Përgjithshëm, keni mbajtur kontakte me të gjatë kësaj kohe? Ju
17 kujtohet?

18 PË. Unë personalisht, jo. S'e besoj që kam mujt me pas ndonjë
19 kontakt me ta.

20 PY. Me sa keni ju dijeni, nuk ka ekzistuar ndonjë sistem në
21 Shtabin e Përgjithshëm për ta përditësuar apo për ta informuar
22 atë lidhur me ato që po ndodhnin?

23 PË. Nuk e di.

24 PY. Por ju thotë që ju vetë s'keni pas kontakte me të. Po
25 ndonjë tjetër në Shtabin e Përgjithshëm ka pasur, ndonjë

1 kontakt, diskutim me të gjatë kohës që ai ka qenë jashtë
2 Kosovës?

3 PË. S'e di, s'e mbaj mend.

4 PY. Me sa dini ju, i është dërguar atij ndonjë raport nga
5 Kosova në drejtim të vendit ku ai qëndronte ose në vendet që
6 ai qëndronte?

7 PË. Nuk e mbaj mend që është dërgu ndonjë raport z. Veseli
8 nga shtabi ose nga dikush. S'më kujtohet kjo.

9 PY. Në rregull.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Ju lutem, vendosim në ekran provën
11 materiale P01109. Ky është shënimi apo procesverbali i takimit
12 të Shtabit të Përgjithshëm në dhjetor të 1998, në nëntor
13 [Sipas përkthimit] të 1998. Është, origjinali është në shqip
14 dhe është i përkthyer në anglisht. Shkojmë në faqen 7, ju
15 lutem.

16 PY. Po, kjo është faqja dhe ju treguan dhe më përpara.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Këtu, ju gjetët nënshkrimin tuaj. Dalluat nënshkrimin
19 tuaj.

20 PË. Po.

21 PY. Ju kujtohet?

22 PË. Po.

23 PY. Këtu në fund thotë "Mbledhja e ardhshme të mbahet më 5
24 janar".

25 A ju kujtohet nëse vërtet u mbajt kjo mbledhje më 5

1 janar?

2 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet, jo.

3 PY. A është e vërtetë, bazuar në atë që thatë dhe ju, që z.

4 Veseli nuk ka qenë i pranishëm në këtë mbledhje, sepse në këtë
5 periudhë ka qenë jashtë vendit, saktë?

6 PË. Unë nuk e di se nëse ka qenë jashtë, por e di që s'e, një
7 kohë të gjatë, nuk e kam taku z. Veseli. Nuk e di. Mbas, gjatë
8 kohës së Rambujesë, apo jo mbas kohës së Rambujesë, por nuk e
9 kam taku një kohë të gjatë.

10 PY. Po. Do flasim për Rambujenë. Por fillimisht doja t'ju
11 pyesja që në këtë mbledhjen këtu nuk ka qenë, ku keni qenë ju.
12 Ju vetë nuk e keni parë?

13 PË. Jo s'e kam pa.

14 PY. Pas mbledhjes më 30 nëntor [Sipas përkthimit], ju
15 personalisht apo ndokush tjetër, a i raportoi atij lidhur me
16 atë që ishte diskutuar në këtë takim?

17 PË. Jo, s'më kujtohet.

18 PY. A është e vërtetë që ai vetë nuk ka dërguar ndonjë
19 informacion nga vendi ku qëndronte për këtë takim në mënyrë që
20 të shqyrtohej, të diskutohej në këtë takim?

21 PË. Nuk besoj. Unë të paktën nuk e kam një informacion si ka
22 mujt ai ne me na çu ne informacion neve nga atje ku ka qenë.
23 Thjesht unë s'kam informacion.

24 PY. Ju bënë pyetje këtu nëse kishit shkruajtur ju "zëvendësi
25 i Kadriut", pjesa këtu, "Zv i Kadri", e shihni? Tek shërbimi

1 informativ, e shihni? Në kllapa "Zv i Kadri". Është në mes të
2 dokumentit. Ju bëri një, ju bënë pyetje për këtë.

3 PË. Po, po. Në rregull është. Domethënë te komisioni i
4 gradimit, apo te komisioni kadrovik? Te komisioni i gradimit,
5 a po?

6 PY. Thotë, tek pika c që është komisioni për përcaktimin e
7 vijave kufizuese të zonave operative, në mes të dokumentit
8 përbri keni disa emra. Poshtë në kllapa e keni:

9 "Zv i Kadriut". Thotë me shkurtime, SH.INF., shërbimi
10 informativ. Dhe në kllapa thotë "Zëvendësi i Kadriut", "Zv i
11 Kadriut". A e shihni, e gjetët në tekst?

12 PË. Po. Këtu me thanë të drejtën nuk muj me e kuptu se çka
13 kam dash me, çka është bisedu në këtë rast. Por me siguri se në
14 mungesë të Kadrisë ka pas me ardh dikush tjetër se nuk po ma,
15 domethënë kjo, ky vend iu kalu me siguri shefit të informimit.
16 Por në mungesë të tij, me ardh dikush tjetër një person
17 tjetër. Kjo ka mundësi. Me u zëvendës Kadriu në këtë rast. Nuk
18 ka qëllim këtu për zëvendës të Kadrisë. Si zëvendës, si
19 funksion. Se s'ka pas mundësi në atë kohë me pas Kadrija
20 zëvendës të informimit. Me aq sa kam informacion unë, nuk e di
21 që është emëru dikush nga z. Kadri Veseli si zëvendës i
22 shërbimit informativ. Kjo mundësi, kjo ka mundësi të jetë.

23 Por është një dokument që s'e kam pa sa vite, dhe kjo
24 para 20 e ca vite ka ndodh. S'po muj me përcaktu saktë.

25 PY. Faleminderit. Megjithatë, është e drejtë me aq sa ju

1 kujtohet ju, apo, që z. Kadri Veseli nuk ka pasur zëvendës të
2 emëruar, të cilët kanë marrë pjesë në këtë takim? A është e
3 saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po, e saktë është.

5 PY. Dhe nuk ka pasur zëvendës atje, domethënë, nuk është se
6 kemi ndonjë emër as në këtë dokument, asnjë zëvendësi i tij
7 nuk është se ka raportuar për këtë raportim, se s'ka pasur
8 zëvendës, kështu?

9 PË. Jo, jo, s'ka pas. Prandaj është dhe në kllapa.

10 PY. Në fund jepet një numër telefoni, në qoftë se e shikoni.
11 Domethënë që është ky numri 0041. Poshtë këtij numri është
12 "Luli". Ju treguan gjatë pyetjeve dhe këtë pjesë të
13 dokumentit.

14 PË. Po.

15 PY. A e dini se i kujt është ky numri? Është një numër me
16 prefiks zviceran. A e dini se i kujt ka qenë ky numër?

17 PË. Realisht nuk e mbaj mend. Nuk muj me e mbajt mend. Dhe
18 nuk e di se a përkon emri, numri i telefonit me emrin e Lulit.
19 Këtu s'muj me thanë kurrëgjë.

20 PY. A e keni marrë ndonjëherë në telefon këtë numër në atë
21 kohë.

22 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet.

23 PY. A ju kujtohet në qoftë se ndonjë person tjetër e ka
24 përdorur këtë numër, domethënë ka marrë në këtë numër telefoni
25 në atë kohë?

1 PË. Unë nuk më kujtohet se kjo, kjo shkresë, nuk besoj që
2 është përshkrimi që i kam bo këtu. Nuk besoj që janë
3 procesverbali i Shtabit të Përgjithshëm, këto janë thjesht, ka
4 të ngjarë që janë bo për nevoja të mijat. Se nuk e kam -- e
5 kam harru edhe si letër që ka, si ka ekzistuar dikund. Por që
6 procesverbal edhe me i bo këto shkarravina mbi një
7 procesverbal, realisht kjo është shumë e palogjikshme. Dhe ky
8 numër këtu, nuk më kujtohet nëse i kujt ka qenë në atë kohë.

9 PY. Dua t'ju pyes edhe lidhur me diçka tjetër, z. Qadraku
10 [Sipas përkthimit]. A ka pasur procesverbale të tjera zyrtare
11 të këtij takimi ose të takimeve të tjera të Shtabit të
12 Përgjithshëm që ju kujtohet ju?

13 PË. Z. Bashota jam, i nderuar avokat.

14 PY. Ju kërkoj ndjesë. Po, atëherë, po mundohesha t'ju thoja,
15 z. Bashota, që a ka pasur ndonjë procesverbal zyrtar të këtyre
16 takimeve?

17 PË. Procesverbal zyrtar, nuk, më duket ka pas, por unë ky
18 s'besoj se është zyrtar. Se s'kisha leju me i bo këto
19 shkarravina mbi një procesverbal të Shtabi të Përgjithshëm.
20 Këto, thjesht -- as vetë s'kam kuptuar pse e kam bo këtë, por me
21 siguri i kam bo për nevoja të mijat, e jo që një dokument
22 zyrtar që mundet me u përdor për nevojat e shtabit.

23 Mund t'iu kem referu rendit të ditës edhe punëve që janë
24 bo në këtë mbledhje, por të jetë dokument zyrtar ky, s'e
25 besoj.

Dëshmitari: Sokol Bashora (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 72

1 PY. Jo, dua t'ju them që a jeni në dijeni, a keni ndonjë
2 informacion në qoftë se ndonjë person brenda grupit tuaj është
3 caktuar me detyrën për të mbajtur shënime zyrtare ose për të
4 mbajtur procesverbal të takimit?

5 PË. Jo, s'e mbaj mend. Nuk e mbaj mend që ka pas një person
6 zyrtar.

7 PY. Faleminderit. Një pyetje të fundit lidhur me këtë numrin
8 e telefonit për të cilin ju pyeta dhe pak më herët. A është e
9 mundur që ai numri mund t'i jetë shtuar më vonë, domethënë, që
10 nuk e keni mbajtur shënim kur keni shkruar këtë dokument herën
11 e parë, por që mund të jetë shtuar më vonë. Sepse këtu thuhet
12 "1999". A është e mundur kjo, është si option ky?

13 PË. Ka mundësi, ka mundësi. Thjesht nuk e di as i kujt është.
14 Por në një dokument zyrtar nuk e kisha shkru një numër të
15 tillë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përkthyesit
17 po kërkojnë që ju të bëni një pauzë ndërmjet pyetjeve dhe
18 përgjigjeve në mënyrë të tillë që të përfundojë i plotë
19 përkthimi përpara se të bëni pyetjen e radhës.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, dhe do mundohem që
21 ta respektoj këtë, që të bëj një pauzë.

22 Atëherë, mund të hiqet dokumenti nga ekrani. Ndërkohë, që
23 në vend të këtij dokumenti do lutesha që të paraqisnit provën
24 P00182.

25 PY. Është dokumenti, z. Bashota që e keni parë dhe më herët.

1 Dua që të shikojmë bashkë një faqe të këtij dokumenti. Dhe në
2 të flitet lidhur me takimin e 6 shkurtit të vitit 1999.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti
4 SPOE00226401.

5 PY. Ju lutem, hidhi një sy përmbajtjes së dokumentit që keni
6 përpara. Atëherë, ju bënë pyetje sa i takon komandantëve të
7 zonave të cilët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm për
8 emërimin tuaj si zëvendëskomandant. Dhe këtu në këtë dokument
9 flitet për këtë:

10 "SHI-në", pra sigurimi, "i cili nuk mund të sigurojë
11 ushtrinë nga jashtë."

12 Dhe më pas vijohet që:

13 "Ne mendojmë që duhet që të caktojmë një profesionist si
14 komandant i cili të na mbajë në kontakte dhe në kontroll."

15 Domethënë ky është një dokument i cili pretendohet që t'i
16 referohet, që të jetë shkruar ose të ketë lidhje me 6 shkurtin
17 1999. A ju kujtohet që të jetë ngritur kjo çështje sa i takon
18 shërbimit inteligjent ose informativ që ishte jashtë shteti:

19 ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

20 PË. Jo, s'më kujtohet.

21 PY. Nuk ju kujtohen fare fakti që komandantët e zonës po
22 ankoheshin sa i takon faktit që shërbimi informativ nuk ishte
23 në vend, ishte jashtë shtetit, dhe që ata thonin që duhet që
24 të emërojmë dikë që të na raportojë neve?

25 PË. Nuk e di nëse kam qenë unë në atë takim. Nuk e mbaj mend.

1 Nuk e mbaj mend.

2 PY. Për të qenë i drejtë me juve, ju e keni thënë këtë, por
3 thjesht po ju pyes në qoftë se keni dëgjuar, nëse është
4 shfaqur një ankesë e tillë apo jo. Domethënë, fakti që
5 shërbimi informativ nuk ka qenë në vend gjatë kësaj periudhe.
6 Domethënë, ky është dokument që i referohet shkurtit të 1999.
7 Keni dëgjuar ndonjë shqetësim të tillë, Dëshmitar?

8 PË. Jo, jo. S'kam dëgjuar.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani.

10 PY. Tani dua që të diskutojmë lidhur me Rambujenë, sikurse e
11 thashë dhe më herët. Ju personalisht, a keni qenë i përfshirë
12 në biseda në Shtabin e Përgjithshëm lidhur me personat që do
13 të caktoheshin për të shkuar në Rambuje për negociata?

14 PË. Jo, nuk e besoj. Janë caktu, në atë kohë më duket ka qenë
15 edhe Azem Syla në Kosovë, dhe me sa di unë, ai ka marrë vendim
16 se kush duhet të shkojë atje. Nuk e di a është diskutu edhe në
17 Shtabin e Përgjithshëm, nuk e mbaj mend, por saktë nuk më
18 kujtohet.

19 PY. Pra, nuk është se ishte një vendim i përbashkët i Shtabit
20 të Përgjithshëm për të vendosur se kush do të shkonte në
21 Rambuje dhe çfarë do të thuhej atje. A është e saktë kjo?

22 PË. Po, nga vetë logjika që përbërja e delegacionit ka qenë
23 kryesisht nga njerëz të cilët janë marrë me ndërkombëtarët,
24 mendoj se është e vetëkuptueshme kjo se ata duhej të shkonin,
25 dhe mendoj se një vendim, nuk më kujtohet nëse ka qenë direkt

1 i, veç i Azem Sylës, por thjesht me logjikën time është dasht
2 me shku këta.

3 PY. Ai nuk u konsultua me juve lidhur me këtë vendim, apo jo?

4 PË. Mua s'më kujtohet që është konsultu dikush me mu për
5 këtë, për delegacionin.

6 PY. A ju kujtohet që ta keni ditur që z. Veseli ka qenë një
7 prej personave që ka shkuar në Rambuje për të marrë pjesë në
8 negociata atje? E keni ditur këtë gjë?

9 PË. Që ka qenë në Rambuje kam dëgju, por nuk e di nga kush,
10 nga kush më është thanë. Por e di që është përmendur dhe që
11 është Veseli atje. Por me sa e mbaj mend, nuk ka qenë i
12 caktuar me shku nga Shtabi i Përgjithshëm. Në çfarë forme ka
13 shku, nuk e di. Kënd e ka, me kënd është konsultuar nuk e di,
14 por më duket se është, kam dëgjuar se ka qenë në Rambuje.
15 Informacion direkt për këtë s'kam pas.

16 PY. Pra, edhe një herë, kjo nuk është diçka për të cilën ju
17 jeni konsultuar, domethënë fakti që ai ka shkuar atje ose që
18 është emëruar që të shkojë atje.

19 PËRKTHYESI: E ka fjalën avokati për Rambujenë.

20 Z. DIXON: [Përkthim]

21 PY. Domethënë, as për këtë nuk është se jeni konsultuar,
22 kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Ju keni thënë se e keni parë për herë të fundit -- jo, në
25 fakt keni thënë që nuk jeni i sigurt në qoftë se ka qenë

1 nëntor i 1998, pra në takimin e nëntorit të 1998. Ndërkohë që
2 unë ju supozoj që ai ka qenë, ju sugjeroj që ai ka qenë aty
3 për ca kohë. Por ju thoni që nuk keni qenë i sigurt. Ai ka
4 qenë aty për një periudhë të gjatë. Kur ka ndodhur që ta keni
5 parë atë përsëri, pas Rambujesë, apo jo?

6 PË. Kujtoj, pas Rambujesë.

7 PY. Kur ka qenë kjo, në fund të marsit të 1999?

8 PË. Nuk e di saktë, nuk e di saktë. Por me sa e di, më duket
9 se ka qenë edhe prezent në takimin kur është bo marrëveshja e
10 Rambujesë.

11 PY. Po. A ju kujtohet që të keni marrë ndonjë raport prej
12 tij, domethënë, që ai t'ju ketë raportuar juve konkretisht
13 vetë si person sa i takon Rambujesë?

14 PË. Jo.

15 PY. A është e saktë që në fillim të prillit, domethënë pak
16 kohë pas kësaj periudhe që po diskutonim, z. Veseli u bë
17 ministër për shërbimin informativ të Kosovës si pjesë e
18 qeverisë së përkohshme të Kosovës, dhe u largua si anëtar i
19 Shtabit të Përgjithshëm. Pasi ky ishte një prej gjërave që
20 rrodhi nga procesi i Rambujesë. A ju kujtohet të ketë ndodhur
21 kështu, Dëshmitar?

22 PË. Unë në atë kohë -- jo, ministër nuk besoj që ka qenë
23 Kadri Veseli. Ka qenë, mbas luftës ka qenë vetëm shef i
24 shërbimit informativ.

25 PY. A ju kujtohet që ai më 2 prill është emëruar në

1 strukturën e qeverisë së përkohshme?

2 PË. Jo, s'më kujtohet kjo. Unë nuk kam qenë pjesë e atij
3 takimi, edhe -- nuk kam qenë pjesë e atij takimi, për arsye se
4 atëherë kam dhanë dorëheqje prej shtabit -- prej shtabit. Dhe
5 nuk e di nëse është vendos ministër në atë takim apo vetëm
6 shef. Por mbas luftës e di që ka qenë shef i shërbimit
7 informativ.

8 PY. Kjo ishte shërbimi civil informativ i Kosovës, për këtë e
9 keni fjalën, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Po. Po, mbas luftës.

11 PY. Kur ju dhatë dorëheqjen, kur ka ndodhur kjo, më çfarë
12 date e keni dhënë dorëheqjen?

13 PË. Kjo dikund nga shkurti i, kah mesi i shkurtit të 1999,
14 mbas revoltës së komandantëve të zonave, e thashë ma herët. Më
15 duket në shkurt ka qenë, më duket në shkurt ka qenë.

16 PY. Ju nuk keni pasur kontakt me z. Veseli si rezultat i
17 dorëheqjes tuaj, domethënë pas kësaj kohe, për shkak se dhatë
18 dorëheqjen, s'keni pasur më kontakt me z. Veseli, kështu?

19 PË. Po, mund të kuptohet edhe kështu. S'i kem pas të ndaluara
20 kontaktet, por nuk e di se, nëse e kam taku.

21 PY. Do t'ju bëj disa pyetje lidhur me z. Sokol Dobruna. E
22 dini për kë e kam fjalën? Sokol Dobruna është caktuar si shef
23 i shërbimit gjyqësor.

24 PË. Po.

25 PY. Në fund të vitit 1998.

1 PË. Po.

2 PY. A ju kujtohet sepse ju keni qenë pjesë e Shtabit të
3 Përgjithshëm atëherë, a ju kujtohet që roli i tij ishte që të
4 kujdesej për organizimin ose krijimin e një shërbimi juridik
5 profesional brenda UÇK-së?

6 PË. Po, kështu është, është emëruar në atë kohë. Për këtë
7 funksion.

8 PY. A ju kujtohet se ai e filloi këtë punë në fillim të vitit
9 1999, pra filloi që të krijonte kodet ligjore dhe
10 legjislacionin, ligjet, aktet e ndryshme juridike të
11 nevojshme? Ju kujtohet kjo?

12 PË. Nuk e di përshkrimin e punëve të tijna, se nuk kam pas
13 kontakte kështu me të për punën e tijna në -- asnjëherë. Dhe
14 nuk e di nëse janë diskutuar punët e tijna që ka bo ai në atë
15 kohë me stafin e, se ka pas edhe një staf më duket, që janë
16 diskutuar në Shtabin e Përgjithshëm.

17 PY. Edhe një herë, nuk është se ka pas biseda të përbashkëta
18 ose kolektive në Shtabin e Përgjithshëm sa i takon rolit të
19 tij, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Me aq sa unë e mbaj mend, për arsye se mu më ka ra me
21 ndejt shkurt aty, se në shkurt kam dhanë dorëheqjen, dhe nuk
22 kam mujt me e pa punën e Sokol Dobrunës në Shtabin e
23 Përgjithshëm.

24 PY. Po, por përpara se sa të jepnit dorëheqjen në dhjetor,
25 janar, nuk është se ka pasur biseda, nuk ka pas diskutime si

1 grup, sa i takon faktit që çfarë do të bënte ai apo çfarë

2 përgjegjësisë do të ishte, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Nuk e mbaj mend.

4 PY. Nuk kishte kërkesa, apo jo, brenda Shtabit të

5 Përgjithshëm që informacioni i lidhur me kolaboracionistët i

6 dërgohej atij, domethënë asnjëherë nuk ju është kërkuar juve

7 një gjë e tillë që informacioni që kishte të bënte me

8 kolaboracionistët i dërgohej atij, kështu, Dëshmitar?

9 PË. Jo, s'e besoj.

10 PY. Në rregull. Kam edhe një temë të fundit që dua ta trajtoj

11 me ju.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Për këtë do i lutesha Sekretares të

13 paraqesë në ekran dokumentin P00303 në versionin në shqip dhe

14 anglisht.

15 PY. Do kemi dhe versionin në shqip, z. Bashota.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Është dokumenti 00303. Duhet të jetë

17 komunikata numër 4. Njoftimi për shtyp numër 4.

18 PY. Z. Bashota, do ju kërkoja që t'i hidhnit një sy. Ju bënë

19 disa pyetje lidhur me këtë temë sot, dhe tani dua t'ju pyes në

20 qoftë se këtë kumtesën numër 4 a e keni parë ndonjëherë lidhur

21 me këtë temë? Pra është një kumtesë që mban datën 1 nëntor

22 1998.

23 PË. Nuk më kujtohet kjo. S'e kam pa kurrë.

24 PY. Është hera e parë që e shikoni këtë dokument tani?

25 PË. Po. Ndoshta nuk di a e kam pa seancë përgatitore apo atë

1 ditë, po ma herët s'e kam pa. Në kohën kur është përpiluar kjo
2 nuk e kam pa. As kur është shkruar.

3 PY. Titulli i kumtesës është "U arrestuan nga policia
4 ushtarake e UÇK-së dy funksionarë të LDK-së". A e lexoni këtë
5 në fillim të faqes?

6 PË. Po.

7 PY. Pastaj në fund shkruhet: "Ushtria Çlirimtare e Kosovës,
8 Drejtoria e Policisë Ushtarake."

9 A e shikoni në fund të kumtesës, Dëshmitar? E shikoni në
10 fund fare.

11 PË. Fare, fare, në fund. Ah, "Drejtoria e Policisë
12 Ushtarake", po.

13 PY. Është e saktë, apo jo, z. Bashota, se në nëntor të vitit
14 1998, nuk kishte një drejtor të policisë ushtarake në UÇK, a
15 është kështu, është e saktë kjo?

16 PË. Më 5 nëntor 1998, besoj se është e saktë. S'e besoj që ka
17 pas [E padëgjueshme] -- s'ka pas drejtor atëherë.

18 PY. Atëherë, është data 1 nëntor. Por pavarësisht datës,
19 rreth kësaj periudhe, në këtë periudhe, nuk ka pasur drejtor
20 të policisë ushtarake në UÇK, apo jo, Dëshmitar? Është e saktë
21 kjo?

22 PË. S'besoj që në atë kohë ka pasur drejtor të policisë
23 ushtarake.

24 PY. Po ashtu nuk ka pasur as drejtor informative të UÇK-së
25 në këtë kohë, apo jo? E kam fjalën për fillimin e nëntorit të

1 1998, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. E saktë. Unë thashë që drejtoritë janë bo vetëm me
3 miratim dikund kah mesi i nëntorit, mbas raportimit që ka bo
4 Bislim Zyrapi. Aty janë vendos edhe drejtoritë, edhe vartësit
5 e tyre.

6 PY. Pra, ky dokument, pavarësisht se çfarë përfaqëson ai,
7 është e saktë apo jo, z. Bashota, që ky dokument nuk mund të
8 jetë lëshuar nga drejtoria e policisë ushtarake të UÇK-së
9 sepse nuk ka pasur një drejtori të tillë. A është e saktë kjo?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Faleminderit. Z. Bashota, nuk kam pyetje të tjera për ju.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 z. Dixon.

15 Z. Roberts.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

17 Nuk kam pyetje për dëshmitarin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

19 Alagendra.

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
21 Gjykatës.

22 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

24 PY. Mirëdita, z. Bashota. Unë jam Venkateswari Alagendra dhe
25 jam avokate e Jakup Krasniqit.

1 PË. Mirëdita.

2 PY. Në seancën përgatitore dhe përsëri dje dhe sot po ashtu,
3 keni thënë që në 1997-n anëtarët e Shtabit Qendror ishin Azem
4 Syla, Xheladin Gashi, Nait Hasani, Xhavit Haliti dhe ju vetë,
5 a është e saktë kjo?

6 PË. Po, po.

7 PY. Z. Jakup Krasniqi nuk ka qenë pjesë e këtij grupi, a
8 është e saktë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Po, e saktë.

10 PY. Ju jeni në dijeni, apo jo, z. Bashota, që z. Krasniqi ka
11 qenë shefi i degës së LDK-së në Gllogoc deri në prill të 1998?

12 PË. Deri në çfarë date nuk e di, por që ka qenë pjesë e
13 Lidhjes Demokratike të Kosovës, e di, dhe ka qenë mjaft aktiv
14 në atë periudhë.

15 PY. Në rregull. Dhe kjo ka ndodhur deri në fillim të 1998,
16 apo jo? Ju kujtohet domethënë, kjo ka qenë nga fillimi i 1998,
17 është e mundur të paktën kjo?

18 PË. Nuk e di. Nuk e di.

19 PY. Me sa keni ju dijeni, Jakup Krasniqi nuk ka qenë
20 asnjëherë anëtar i LPK-së, apo jo?

21 PË. S'kam informacion. Që ka qenë i burgosur politik po, por
22 cilës organizatë i ka takuar ai s'kam hulumtu kurrë. Por që
23 është burgos për veprimtari ilegale të asaj kohe, po, e di.

24 PY. Dje ju konfirmuat që ristrukturimi i UÇK-së u bë
25 plotësisht funksional me mbërritjen e Bislime Zyrapit në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashora (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 83

1 Kosovë, dhe ishte një proces i cili përfundoi me strukturimin
2 e plotë të UÇK-së deri në fund të vitit 1998. A ju kujtohet ta
3 keni thënë këtë, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të
6 paraqesë në ekran dokumentin 4D00011, ju lutem.

7 PY. Këto janë shënimet e një mbledhjeje të Shtabit të
8 Përgjithshëm më datë 12 nëntor 1998, z. Bashota. Në fillim të
9 dokumentit shpjegohet që:

10 "Në këtë takim është diskutuar ristrukturimi organizativ
11 i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së". Ose "U bë ristrukturimi
12 operativ i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së".

13 PË. Po.

14 PY. Ky ishte takimi në fund të vitit 1998 ku ju flisni për
15 ristrukturimin, a është kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Në fillim të dokumentit shohim strukturën e re të UÇK-së,
18 domethënë parashikojmë që, parashihet një komandant dhe dy
19 zëvendëskomandantë, një për operacionet dhe një për
20 mbështetjen. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Ju jeni caktuar zëvendëskomandant për operacionet,
23 ndërkohë që Jakup Krasniqi është caktuar zëvendëskomandant për
24 mbështetjen, a është e saktë kjo?

25 PË. Po.

1 PY. Si pjesë e ristrukturimit të Shtabit të Përgjithshëm

2 Bislime Zyrapi është emëruar shef i shtabit. A është e saktë

3 kjo?

4 PË. Po.

5 PY. Në seancën përgatitore përpara një jave, në paragrafin 50

6 të Shënimit Përgatitor 2, keni thënë që Bislime Zyrapi ishte

7 shefi i drejtorisë operative dhe ishte, dhe Azem Syla, dhe jo

8 ju, i keni dhënë detyra Bislime Zyrapi. A është e saktë kjo?

9 PË. Po.

10 PY. Të enjten e javës së shkuar, i thatë Prokurorisë se kur

11 mbërriti Bislime Zyrapi në Kosovë, ai krijoi një dinamikë krejt

12 të re sa i përket ristrukturimit të UÇK-së. A ju kujtohet që

13 ia thatë këtë?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe kjo ka ndodhur sepse ai ishte një oficer karriere me

16 përvojë ushtarake, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Detyra e Bislime Zyrapi në drejtorinë operative -- më

19 falni, zëvendësi i tij ka qenë Sali Veseli në drejtorinë

20 operative, apo jo?

21 PË. Më duket, nuk e mbaj mend. Më duket se po. Ka qenë edhe

22 ai një oficer i karrierës. Mund të ketë qenë.

23 PY. Gjithashtu ka qenë dhe Naim Maloku dhe Safet Syla. A ju

24 kujtohet që dhe këta kanë qenë pjesë të drejtorisë operative?

25 PË. Nuk më kujtohet. Por e di që edhe Naim Maloku ka hy në

1 Kosovë.

2 PY. Safet Sylja?

3 PË. S'e kujtoj këtë.

4 PY. Por sidoqoftë, mund ta konfirmoni që Sali Veseli dhe Naim
5 Maloku ishin oficerë karriere?

6 PË. Po.

7 PY. Azem Sylja nuk kishte formim ushtarak, ka qenë arsimtar
8 kimie, mësues kimie përpara luftës, apo jo?

9 PË. Po. Kam qenë dhe nxënës i tij.

10 PY. Dhe ju na keni thënë që as ju personalisht, dhe as z.

11 Krasniqi, nuk keni përvojë, nuk keni formim ushtarak, saktë?

12 PË. Saktë.

13 PY. Në paragrafin 51 të Shënimit Përgatitor numër 2, thuhet
14 se, ju keni thënë që:

15 "Bislim Zyrapi ka qenë personi që ka bërë dhe përshkrimet
16 e drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm ..."

17 Saktë?

18 PË. Skicimin, po. Ai e ka bo.

19 PY. Në rregull.

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran ju lutem
21 provën P1408.

22 PY. Këto janë shënime të një takimi me drejtorinë në Shtabin
23 e Përgjithshëm në Divjakë më 29 dhjetor 1998. Shohim listën e
24 pjesëmarrësve dhe sipas listës në takim ka marrë pjesë Bislim
25 Zyrapi, Adem Grabovci, Fatmir Limaj, Berat Luzha, Ramë Buja,

1 dhe Sali Veseli, saktë?

2 PË. Po.

3 PY. As ju personalisht dhe as z. Krasniqi nuk keni qenë të
4 pranishëm në këtë mbledhje, saktë?

5 PË. Saktë.

6 PY. Shohim rendin e ditës, pika 1, thotë:

7 "Shpjegimi i udhëheqjes dhe komandës së Shtabit të
8 Përgjithshëm".

9 E gjetët?

10 "Shpjegimi i udhëheqjes dhe komandës së Shtabit të
11 Përgjithshëm". Pika 1.

12 PË. Po. Paragrafi -- po, pika 1, paragrafi 3.

13 PY. Po, pika 1. Më poshtë thotë:

14 "Takimin e kryesoi z. Bislim Zyrapi, që foli për
15 udhëheqjen dhe strukturën komanduese."

16 Ose më saktë në shqip është: "Rreth udhëheqjes dhe
17 komandimit foli udhëheqësi i mbledhjes z. Bislim Zyrapi."

18 PË. Po.

19 PY. E lexuat?

20 PË. Po.

21 PY. Kjo është e vërtetë, apo jo? Dhe përputhet dhe me atë që
22 keni thënë në seancën përgatitore, pra që ka qenë z. Bislim
23 Zyrapi ai që ka dhënë informacione lidhur me strukturën
24 komanduese.

25 PË. Po.

1 PY. Drejtoritë i raportonin z. Zyrapi, nuk ju raportonin ju,
2 apo jo?

3 PË. Jo, neve kurrë.

4 PY. Në paragrafin 50 të Shënimit Përgatitor 2, pasqyrohet
5 sikur keni thënë se:

6 "Ndonëse ndodhte rrallëherë, ishte Bislum Zyrapi ai që i
7 organizonte mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm me komandantët
8 e zonave."

9 Kështu?

10 PË. Po.

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do kërkoja që të vendoset
12 në ekran materiali SITF00009426 deri në 94 -- 4930 [Sipas
13 përkthimit]. Shkojmë në faqen 2 të dokumentit, ju lutem.

14 PY. Kjo është një deklaratë që e keni dhënë në vitin 2011,
15 apo jo, z. Bashota? Ia keni dhënë Speciales së Kosovës.
16 Prokurorisë Speciale, më falni.

17 PË. Po.

18 PY. Do t'ju lexoj një pyetje dhe përgjigje, por do fillojmë
19 nga numri 5, ku thotë:

20 Pyetja:

21 "Ku ka qenë baza e SHP-së?

22 "Në Divjakë.

23 "Ku ishte baza e shtabit?

24 "Në Divjakë."

25 Pyetje:

1 "Atëherë, shkonit herë pas here ju në Divjakë?"

2 Përgjigje:

3 "Po.

4 "Kush ishte kryesuesi i shtabit?"

5 Përgjigja juaj:

6 "Bislim Zyrapi."

7 Kështu është pra, saktë?

8 PË. Po.

9 PY. Si zëdhënës i UÇK-së, z. Krasniqi ka qenë një prej
10 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm që shërbente si pikë
11 kontakti me ndërkombëtarët, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Z. Krasniqi shpesh takohej me ndërkombëtarët si Shaun
14 Byrnes, bashkë me ju, dhe Ramë Bujën, apo jo?

15 PË. Po, jam taku disa herë si me Hill, me Petritschin, me
16 Walker, me David Meyer, e së bashku me Jakup Krasniqin edhe me
17 Ramë Bujën. Nganjëherë vetëm me Jakupin, por edhe Jakupi është
18 takuar edhe pa prezencën time ose të Ramës.

19 PY. Po. Dhe përpara se të shkonte në konferencën e Rambujesë,
20 z. Krasniqi ka qenë i angazhuar në takime me ndërkombëtarët
21 dhe përgatitej për këto bisedime, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Dje iu përgjigjët disa pyetjeve lidhur me kundërshtimet
24 që i kishin komandantët e zonës për ju personalisht, z.

25 Krasniqi dhe z. Azem Syla. Dhe do t'ju tregoj disa dokumente

1 lidhur me këto çështje.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do lutesha të vendosej në
3 ekran materiali 4D00073. Shqipen, ju lutem.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Versionin në shqip nuk
5 e keni në listën e materialeve tuaja, kështu që do të duhet të
6 më jepni numër tjetër.

7 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju kërkoh ndjesë. Është
8 materiali me numër U009-1991 deri në 1994. Po.

9 PY. Z. Bashota, ky është një dokument në emër të Ramush
10 Haradinajt, që i drejtohet Shtabit të Përgjithshëm dhe mban
11 datën 19 janar.

12 Pika 5, në krye të faqes, te pika 5. Po ua lexoj çfarë
13 thotë. Thuhet:

14 "Kërkoh që Shtabi i Përgjithshëm në përbërje të tij vend
15 të veçantë t'i kushtojë komandantëve të zonave, të lirohet nga
16 pseudopatriotët që i japin të drejtë vetes të veprojnë si
17 kuadër dhe si anëtarë të Shtabit."

18 E gjetët?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, një nga kërkesat e Ramush Haradinaj është që t'u
21 jepej më shumë vend komandantëve të zonave sikurse ishte ai
22 vetë, apo jo?

23 PË. Unë nuk e kam pa këtë kërkesë të tijna në Shtabin e
24 Përgjithshëm. Për herë të parë po e shoh si dokument. Por, se
25 ka pas ego, po, ajo dihet botërisht.

1 PY. E kuptoj që nuk e keni parë këtë dokument më përpara, por
2 do shikojmë paragrafin e parafundit në këtë faqe.

3 Po lexoj:

4 "Kërkoj që të njoftohen komandantët e zonave, ose unë si
5 komandant i zonës të caktuar me kriterin e caktimit të kuadrit
6 komandues pranë Shtabit i Përgjithshëm. Konkretisht, kërkoj të
7 di për kriterin e emërimit të Jakup Krasniqit, si
8 zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm."

9 A e keni ditur ju, z. Bashota, që ka qenë kjo përshtypja
10 asokohe apo kjo ndjenjë?

11 PY. Po është përfolur se kanë hatërmbetje në emërimin tim
12 edhe të bacit Jakup, edhe të Azem Sylës, komandantët e zonave.
13 Është përfol, por ma vonë tani janë shpërfaqë në një takim që
14 është mbajt në Likovc. Por këtë dokument, nuk e kam pa, nuk e
15 di as se i cilës datë është, as kur e ka dërgue.

16 PË. Po përmbajtja, përmbajtja është diçka me të cilën ju
17 njiheni, apo jo?

18 PY. Po.

19 PË. Sipas dokumentit ai vijon dhe kërkon emërim të reja për
20 komandantë e zëvendëskomandantë, e keni ditur ju asokohe këtë
21 kërkesë të tijën?

22 PY. Jo.

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do lutesha të vendosej
24 në ekran materiali 4D00068. Besoj se kemi dokumentin e gabuar
25 në ekran. ERN-ja është SPOE00226473. Faqen që sapo ju lexova,

- 1 ju lutem. Dokumenti ishte i duhuri, por faqja ishte gabim.
- 2 PY. Këto janë shënime të një mbledhje që kanë bërë anëtarët e
3 Shtabit të Përgjithshëm me komandantët e zonave më 21 janar
4 1999. Ju z. Bashota, keni qenë në këtë takim?
- 5 PË. S'e besoj nëse kam qenë. Nuk e di. Nuk më kujtohet, s'e
6 besoj.
- 7 PY. Pika 1 në rendin e ditës thotë që:
8 "Ka pasur kritika për mënyrën e organizimit të Shtabit të
9 Përgjithshëm, Sokol Bashota ..."
- 10 E shihni?
- 11 "Ka pas vërejtje në organizimin e SHP-së".
- 12 Pika 1. Domethënë, pika 1. "Ka pas vërejtje", "...kanë
13 vërejtje në organizimin e SHP-së".
- 14 PË. Po. Fjala para emrit tem është e palexueshme.
- 15 PY. Por ama flet, flitet këtu, për vërejtje në mënyrën e
16 organizimit të ish-Shtabit të Përgjithshëm dhe për ju si
17 person.
- 18 PË. Po.
- 19 PY. Dhe kjo përputhet në fakt dhe me përshkrimin tuaj të asaj
20 që ka ndodhur asokohe.
- 21 Pika tjetër lexon:
22 "Çështja e zëvendës -- të sqarohet çështja e
23 zëvendëskomandantit Jakup Krasniqi."
- 24 Pika e parafundit. Edhe kjo përputhet me atë që dinit dhe
25 ju asokohe, apo jo?

1 PË. Po.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do lutesha që të vendosej
3 në ekran prova materiale me numrin P001102 [Sipas përkthimit]
4 në faqen konkrete SPOE00226402.

5 PY. Këto janë shënime të takimit 6 shkurt 1999 të cilat i
6 përmendi dhe z. Misetić dje. Ju kujtohet?

7 PË. Po.

8 PY. Ju kujtohet, në rregull. Në këtë faqe, flet Sylejman
9 Selimi. Shohim pikën 2 dhe sipas këtij shënimi thuhet:

10 "Emërimet që janë bërë në Shtabin e Përgjithshëm janë
11 shqetësuese. (Sokol Bashota dhe Jakup Krasniqi). Besoj Sokol
12 Bashota nuk është në nivelin e zëvendëskomandantit. Shtabi i
13 Përgjithshëm i ka shpërfill kërkesat që kemi bërë në lidhur me
14 këtë pikë."

15 A përputhet kjo, z. Bashota, me atë që ju dinit
16 asokohe që kishte ankesa?

17 PË. Po, saktë.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim faqen tjetër.

19 PY. Rreshti i parë thotë:

20 "Jakup Krasniqi, me gjithë respektin që ka, nuk e meriton
21 postin si zëvendëskomandant."

22 Edhe kjo përputhet me atë që ju dinit asokohe, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Në faqen tjetër, rreshti i fundit thotë si në vijim:

25 "Nëse Sokol Bashota dhe Jakupi mbeten në këtë pozitë, unë

1 nuk i raportoj Shtabit të Përgjithshëm.”

2 Edhe kjo përkon me atë që ju dinit lidhur me situatën
3 asokohe, apo jo?

4 PË. Po.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shkojmë në faqen
6 SPOE00226407, ju lutem.

7 PY. Këtu thotë:

8 “Derisa të, pa u bërë emërimet e reja unë nuk i
9 përgjigjem dhe as nuk ju raportoj edhe do të kontestohet edhe
10 posti im si komandant zone.”

11 Kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Pra, është e vërtetë, z. Bashota, që ndonëse ju dhe z.
14 Krasniqi u emëruat nga Shtabi i Përgjithshëm në nëntor të
15 1998, si zëvendëskomandant, komandantët e zonave asnjëherë nuk
16 i njohën apo nuk i pranuan emërimet tuaja, saktë?

17 PË. Saktë.

18 PY. Mes datës 6 dhe 25 shkurt të 1999, z. Krasniqi nuk ka
19 qenë në Kosovë, por ka qenë në bisedimet për paqen në Rambuje,
20 kështu?

21 PË. Po, në Rambuje ka qenë z. Krasniqi.

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do kërkoja të vendosej
23 në ekran materiali 4D0047 [Sipas përkthimit], ju lutem.

24 PY. Nuk ka një version në anglisht të këtij dokumenti, kështu
25 që do ju lexoj pjesët përkatëse, më ndiqni përmes përkthimit.

1 Është një dokument i AFP-së që mban datën 13 mars 1999. Në të
2 thuhet si më poshtë:

3 "Prishtinë, Jugosllavi, 13 mars (AFP) - Delegacioni
4 shqiptar i Kosovës u larguan këtu të shtunën përmes një avioni
5 francez për biseda në Paris lidhur me të ardhmen e provincës
6 së tyre, thanë dëshmitarët okularë."

7 A është e saktë kjo, Dëshmitar? Domethënë, a është e
8 saktë që z. Krasniqi është larguar më datë 13 mars 1999 për
9 Francë për raundin e dytë të negociatave atje? A është e
10 drejtë, e vërtetë kjo?

11 PË. Po, kjo është e vërtetë, se unë së bashku me Shaun Byrnes
12 dhe me David Mayer, i kemi bo edhe agjendën e rrugëtimit të
13 tyre për deri në aeroport.

14 PY. Në rregull. Gjatë periudhës rreth dyjavore ndërmjet
15 raundit të parë dhe raundit të dytë të negociatave, z.
16 Krasniqi dhe pjesa tjetër e delegacionit kryesisht kanë qenë
17 të përfshirë në biseda me anëtarë të UÇK-së në mënyrë të tillë
18 që të merrnin pëlqimin e tyre lidhur me projekt-propozimin për
19 marrëveshjen e paqes. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Ju jeni në dijeni, apo jo, Dëshmitar, që z. Zyrapin ka
22 dhënë dëshmi përpara këtij Trupi Gjykses?

23 PË. Po.

24 PY. Në dëshminë e dhënë prej tij më datë 2 korrik 2024, z.
25 Zyrapin u pyet nga Prokuroria në qoftë se pas takimit të datës

1 27 shkurt 1999, z. Krasniqi ka dhënë dorëheqjen nga pozita e
2 tij si zëvendëskomandant për mbështetjen. Përgjigja e tij
3 ishte:

4 "... po, në fakt po, sepse pas kësaj, z. Krasniqi ka
5 shkuar bashkë me delegacionin në Rambuje ku u bë nënshkrimi
6 dhe më pas nuk u kthye në Kosovë, por qëndroi në Shqipëri."

7 A është e saktë kjo, Dëshmitar? Domethënë, që nga Parisi,
8 z. Krasniqi shkoi në Shqipëri dhe nuk u kthye në Kosovë?
9 PË. Në të njëjtën ditë, unë, Azem Syla dhe Jakup Krasniqi
10 kemi dhanë dorëheqjen nga pozicionet tona si rezultat i
11 kërkesës së komandantëve të zonave. Arsyet i kam shpjegu këtu
12 pse e kemi marrë këtë akt. Është diskutuar në atë takim se
13 Jakupi mundet mos me, mos me dhanë dorëheqjen. Iu kanë lut që
14 mos me dhanë dorëheqjen, me sa mbaj mend unë, por ai mbas do
15 kohe ka shku për Rambuje dhe nuk di se ka mujt me ushtru ma,
16 nuk e di a e ka ushtru ma funksionin si zëvendëskomandant apo
17 jo, se ka shku për Rambuje.

18 PY. Po. Dhe ai shkoi në Paris. Dhe nga Parisi ka shkuar në
19 Shqipëri dhe nuk është kthyer në Kosovë deri nga qershori
20 1999, kështu?

21 PË. Unë nuk e di ma, se mbasi kam dhanë dorëheqjen nga Shtabi
22 i Përgjithshëm, pastaj jam marrë vetëm me, s'jam marrë me këtë
23 pjesën e anëtarëve të tjerë të Shtabit i Përgjithshëm. Dhe nuk
24 e di saktë, sa ka ndejt në Shqipëri dhe kur është kthy.

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran materialin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashora (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 96

1 SPOE00228668, ju lutem.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më duket se
3 është bllokuar transkripti.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ka ngrirë
5 ekрани.

6 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] A dëshironi atëherë ta
7 ndërpres tani dhe të vazhdojmë pas pushimit të drekës?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
10 këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
12 bëjmë tani pushimin.

13 Dëshmitar, mund të largoheni tani. Do të bëjmë pushimin e
14 drekës. Do të ktheheni në orën 14.30 në sallën e gjyqit.

15 Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj deri tani.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
18 deri në orën 14.30.

19 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.57

20 --- Seanca rifillon në orën 14.30

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa
22 të vazhdojmë më tej, Trupi Gjykses do të nxjerrë një urdhër
23 gojor që ka të bëjë me kërkesën e Mbrojtjes lidhur me
24 kundërpërgjigjen e Prokurorisë që ka të bëjë me parashtrimin
25 F02633.

1 Më 20 nëntor 2024, Mbrojtjet e Thaçit, Veselit, Selimit
2 dhe Krasniqit kërkuan leje që të dorëzonin një kundërpërgjigje
3 për kundërpërgjigjen e ZPS-së lidhur me parashtrimin F02633.
4 Parashtrimin iu dha numri F02737.

5 Zyra e Prokurorit të Specializuar u përgjigj më 21 nëntor
6 2024 në parashtrimin e protokolluar F02741, duke parashtruar
7 që kërkesa për kundërpërgjigjet duhet që të mohohet.

8 Trupi Gjykses vëren se në parashtrimin F02633, ZPS-ja
9 kërkoi pranimin e dëshmisë së ekspertit sipas rregullës 138,
10 49 [Sipas përkthimit] dhe 154 dhe Trupi Gjykses është i bindur
11 që Mbrojtja pati mundësinë që t'i përgjigjej plotësisht
12 mocionit të ZPS-së dhe të ngrinte çështje që lidhen me
13 pranueshmërinë e këtyre dokumenteve. Trupi Gjykses po ashtu
14 është i bindur që në kundërpërgjigjen e vet lidhur me
15 parashtrimin F02633, ZPS-ja trajtoi argumente që ngriheshin
16 nga përgjigja e Mbrojtjes në lidhje me çështjet e
17 pranueshmërisë dhe asnjë problem nuk u ngrit.

18 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses e mohon kërkesën e Mbrojtjes
19 për një kundërpërgjigje për kundërpërgjigjen e Prokurorisë që
20 ka të bëjë me parashtrimin F02633.

21 Ky është fundi i urdhrin gojor.

22 Znj. Sekretare, tani mund të sillni dëshmitarin në sallë.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përpara sesa
24 të sillet dëshmitari kemi diçka tjetër për të ngritur. ZPS-ja
25 synon që të dorëzojë një version ose kërkim të konsoliduar

1 sipas rregullit 155 këtë muaj. Neve duam që të na miratohet
2 kërkesa që të shtojmë numrin e fjalëve.

3 Kështu që i kemi pyetur ekipet e Mbrojtjes dhe ata nuk na
4 kanë thënë që kanë mbështetje -- kanë kundërshtim lidhur me
5 këtë dhe që pranojnë shtimin e me një mijë fjalë të kërkesës
6 sonë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
8 miratohet kërkesa. Nuk e di në qoftë se doni që të thoni diçka
9 tani apo të thoni diçka më pas.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi diçka që
11 ka të bëjë me transkriptin, në qoftë se do të më lejoni. Është
12 një temë që ka të bëjë me 30 dhjetorin. Mendoj që në dy vende
13 unë kam thënë takimi i 30 nëntorit, dhe jo i 30 dhjetorit. Dhe
14 kjo është për arsye se ne duhet të jemi të gjithë në të
15 njëjtën linjë. Për procesverbal ky sqarim duhet të bëhet në
16 faqen 56, në rreshtin 13 dhe në faqen 57, rreshtin 13. Aty
17 duhet të jetë 30 dhjetor 1998 dhe jo 30 nëntor.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në të dyja
19 rastet?

20 Z. DIXON: [Përkthim] Po, në të dyja rastet.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Atëherë, në qoftë se ekipet e Mbrojtjes kanë nevojë për
23 shtimin e numrit të fjalëve pasi ta shqyrtoni më tej kërkesën
24 mund ta njoftoni lidhur me këtë. Megjithatë duket sikur nuk ka
25 kundërshtim lidhur me këtë kërkesë.

1 [Mikrofoni çaktivizuar].

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Bashota,
4 do të vazhdojmë më tej me pyetjet e znj. Alagendra. Znj.
5 Alagendra do të vazhdojë më tej. Ju lutem, dëgjojeni me kujdes
6 pyetjet.

7 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Përpara sesa të shkonim për
8 pushimin e drekës unë kërkova që të paraqiten në ekran një
9 dokument. Megjithatë do të tërhiqem nga pyetja që kisha
10 planifikuar dhe dua që të vazhdoj me një tjetër pjesë.

11 PY. Z. Bashota, tani do të kalojmë te periudha nga nëntorit i
12 vitit 1998 deri në fund të shkurtit të vitit 1999. Dje dhatë
13 dëshmi dhe thatë që keni pasur takime të vazhdueshme me
14 ndërkombëtarët që kanë ardhur dhe kanë vizituar Kosovën. A ju
15 kujtohet ta keni thënë këtë, z. Bashota?

16 PË. Po.

17 PY. A është dëshmia juaj që gjatë kësaj periudhe veprimtaria
18 juaj ka pasur kryesisht natyrë politike?

19 PË. Po.

20 PY. Në veçanti keni thënë që ishit një person i besuar
21 kontakti dhe që kishit marrëdhënie ose raporte më të mirë me
22 Shaun Byrnes; a është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. Bashkëpunimi me dhe ndihma e ndërkombëtarëve ishte
25 përparësi për ju dhe për grupin politik të UÇK-së të cilët

1 ish in në kontakt me ndërkombëtarët; a është e saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Duke marrë parasysh marrëdhënien e ngushtë me Shaun
4 Byrnes në atë kohë, ju pajtohem i me mua, apo jo, që ju mendoni
5 që ai ka qenë i ndershëm, i sigurtë në ndërveprimet që ka
6 pasur me ju; apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Unë besoj se ai ka qenë korrekt me të gjithë neve, jo
8 vetëm me mua, por edhe me të tjerët që kanë pas rastin me
9 kontakt me të.

10 PY. Tani le të kalojmë te dëshmia që dhatë dje lidhur me
11 incidentin e dy druvarëve. Ju në dëshminë tuaj thatë që nuk
12 kishit informacion paraprak lidhur me këtë incident dhe u vutë
13 në dijeni për këtë rast vetëm atëherë kur Shaun Byrnes ju
14 informoi ju lidhur me të; është e saktë kjo?

15 PË. Po.

16 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do ju lutesha të kalonim në
17 seancë private.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për çfarë
19 arsye?

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Besoj që për kufizimet e
21 ofruesit të materialit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
23 në seancë private në mënyrë që të mbrojmë informacionin e
24 dhënë nga ofruesi i informacionit.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 jemi në seancë publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

23 PY. Në '96 dhe '97 komunikatat e Shtabit Qendror janë botuar
24 te Zëri i Kosovës, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Nuk e di saktë, se s'kam me -- Zëri i Kosovës nuk ka

1 ardh në atë kohë në Kosovë. Kështu që nuk kam -- nuk e di
2 saktë.

3 PY. Në rregull.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares
5 tani të paraqesë në ekran dokumentin 074625 deri në 07466-ET
6 [Sipas përkthimit]. Ndërkohë dokumenti në shqip ka të njëjtin
7 numër reference.

8 PY. Ndërkohë që paraqitet ky dokument në ekran, Zëri i
9 Kosovës ka qenë gazeta e LPK-së; apo jo, z. Bashota?

10 PË. Po.

11 PY. Këtë dokument jua tregoi Prokuroria përpara një jave.

12 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të kalojmë te faqja 2 e
13 këtij dokumenti.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
15 dua të them për procesverbal që është prova materiale P1874.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Mendoj që akoma ka numër provizor
17 prove, nuk ka numër përfundimtar.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

19 PY. Ky është historiku kohor i veprimtarive të LPK-së; apo
20 jo, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Atëherë shënimi i parë në faqen 2 thotë si më poshtë:

23 "Gjatë 1983-shit, aktiviteti, veprimtaria e Zërit të
24 Kosovës dhe ekipi i redaksisë kanë shkuar në Zvicër, kanë
25 lëvizur në Zvicër."

1 A shikoni këtë pjesën, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të kalojmë te faqja 7 e
4 dokumentit. Të shohim shënimin e katërt nga fundi.

5 PY. Do t'jua lexojmë:

6 "Dhjetor 1999: Organi i LPK-së Zëri i Kosovës filloi të
7 dalë në Kosovë pas 18 vjet botimi jashtë vendit."

8 Pra, nga viti '83 dhe dhjetori i '99 i takon që Zëri i
9 Kosovës gjithmonë ka qenë i botuar jashtë. A pajtoheni me mua?

10 PË. Po.

11 PY. Në dëshminë tuaj javën e shkuar ju na thatë që në vitin
12 1997 komunikatat shkruheshin jashtë shtetit; a është e saktë
13 kjo?

14 PË. Po. Jam informuar nga Nait Hasani dhe [E pakuptueshme]
15 Xheladin Gashi.

16 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të paraqesim në ekran
17 provën P273.

18 PY. Kjo është Komunikata numër 22, data 12 janar 1997 dhe e
19 botuar te Zëri i Kosovës më 16 janar 1997. Këtë dokument jua
20 tregoi Prokurori javën e shkuar dhe ju thatë se nuk e kishit
21 parë ndonjëherë komunikatën ose më saktë nuk e keni parë këtë
22 komunikatë në kohën që është botuar, saktë?

23 PË. Saktë.

24 PY. Shohim paragrafin e dytë të dokumentit. Dokumenti flet
25 për përgjegjësinë që kanë marrë për vrasjen e Maliq Shehollit

1 që është përshkruar si deputet i PSS-së, bashkëpunëtor i

2 vjetër i UDB-së, saktë? Paragrafi i dytë.

3 PË. Po.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani shohim në ekran

5 materialin që mban numrin DJK0907. Lutem dhe shqip edhe

6 anglishten në ekran.

7 PY. Ky është një artikull gazete i botuar tek Epoka e Re më

8 29 shtator 2020 dhe këtu flitet për disa deklarata që ka bërë

9 Fatmir Sheholli, i biri i Maliq Shehollit. Ju lutem, lexojeni
10 vetë me zë, z. Bashota, dhe na thoni kur të keni përfunduar.

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ndërkohë i lutem

12 Sekretarisë që ta çojë deri në fund tekstin.

13 DËSHMITARI: Ta lexoj gjithë tekstin apo?

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

15 PY. Po, lexojeni të gjithë tekstin me zë.

16 DËSHMITARI: I ati i Fatmir Shehollit ishte vra.

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, lexojeni pa zë, me

18 vete. Lexojeni me vete dhe pastaj do ju bëj disa pyetje.

19 DËSHMITARI: Okej.

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

21 PY. E lexuat?

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më falni që po ju ndërpres,

23 mos ka një faqe tjetër? Sepse në fund të faqes thotë faqja 1

24 nga 2. Ka mundësi të ketë një faqe të dytë ky artikull. Do

25 donim ta shihnim dhe faqen e dytë në qoftë se ka një faqe të

1 dytë.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk besoj, por po e
3 verifikojmë dhe do t'ju njoftojmë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

6 PY. Pra, Fatmir Sheholli i referohet këtua Komunikatës 28,
7 saktë?

8 PË. Dhe thotë:

9 "Është konkluzë familjare dhe konkluzë e imja. UÇK-ja nuk
10 ka gisht në vrasjen e babait tim"; saktë?

11 PË. Po.

12 PY. Më tej vijon e thotë -- pra, vijon dhe thotë: Kush e ka
13 shkruar Komunikatën numër 28 është e pavërtetë në tre
14 komponentë. Është totalisht jo e vërtetë në tre komponentë,
15 kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Z. Bashota, a ka të ngjarë që Zëri i Kosovës të ketë
18 botuar informacione që i merrte pa verifikuar nëse këto
19 veprime guerile ishin kryer në të vërtetë, apo jo nga UÇK-ja?

20 PË. Po mendoj që ky është një ndër rastet që më së miri e
21 ilustron këtë që po thoni ju tani.

22 PY. Në rregull. Në '97 dhe '97 komunikatat kanë qenë një
23 instrument propagande, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe përdorëshin për të dhënë përshtypjen që UÇK-ja ishte

1 një strukturë e organizuar dhe se ishte e aftë dhe në gjendje
2 të luftonte forcat serbe, kështu?

3 PË. Nuk kam mujt me i përcjellë të gjitha komunikatat, por
4 ato çka kemi mujt me i vërejt, po.

5 PY. Po në realitet situata ishte krejt ndryshe asokohe. Në
6 atë kohë UÇK-ja ishte një grup gueril i vogël dhe i
7 pakoordinuar, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe në fakt në atë kohë kishte dhe propagandë që thoshte
10 që UÇK-ja nuk ekzistonte fare; apo jo?

11 PË. Nuk e di saktë nëse është në atë kohë, por është thënë në
12 një periudhë kohore që UÇK-ja nuk ekziston.

13 PY. Të marrësh përgjegjësi për këto ngjarje, mbase ishte një
14 formë për të treguar ekzistencën e UÇK-së dhe për të treguar
15 që UÇK-ja në fakt ishte më efikase dhe më e fortë se ç'ishte
16 në realitet. A pajtohemi me këto që po them unë?

17 PË. Po.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e
19 verifikuam. Faqja e dytë janë thjesht reklama të gazetës.
20 Teksti ishte ajo që pamë në ekran; teksti i plotë ishte në
21 ekran. Në kryer të faqes keni një link. Mbase kjo do t'ju
22 ndihmojë nëse e shihni.

23 Të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin e artikullit në të
24 dyja versionet.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Personi në artikull thotë që është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 116

1 konkluzë familjare. Sidoqoftë, ne nuk po e kundërshtojmë
2 pranimin.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
4 dokumenti DJK0907 pranohet.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marri
6 numrin 4D98 dhe ju lutem të më thoni dhe klasifikimin, sepse
7 aktualisht është një dokument publik.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

9 PY. Në paragrafin 16 --

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Më falni, po, është publik.
11 Është dokument publik.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
13 jepeni klasifikimin publik.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit

15 PY. Në paragrafin 16 të Shënimit Përgatitor numër 1, që
16 aktualisht ka numrin e provës P1872, pra, ky është një nga
17 shënimet përgatitore të seancës suaj parapërgatitore. Thuhet:

18 "Ushtarët e UÇK-së u informuan se nuk duhet prekur
19 popullata civile -- nuk duhej prekur popullata civile, por
20 urdhra të tillë nuk e kishin burimin ose më saktë nuk u
21 lëshuan nga drejtoria politike. W4401", që jeni ju, pra, si
22 dëshmitar, "e di që këto urdhra vinin nga komunikatat por
23 komunikatat në vetvete nuk ishin urdhra; komunikatat ishin
24 politike - më falni - ishin deklarata politike që i
25 drejtoheshin popullatës në mënyrë që këta të fundit të ishin

1 të përgatitur”.

2 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

3 PË. Po, më kujtohet që e kam thënë.

4 PY. Deklaratat politike jepnin në vija të përgjithshme
5 pikëpamjet politike të UÇK-së, apo jo?

6 PË. Po. Po ishin edhe udhëzim për qytetarët dhe për ata të
7 cilët iu referoheshin.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran provën me
9 numër P545.

10 PY. Kjo është pjesë e një deklaratë politike që është
11 përfshirë në një libër të z. Krasniqi dhe është botuar në
12 vitin 2019. Në fund është teksti i deklaratës publike numër 2
13 që është botuar më 27 prill të '98-s.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shkojmë më poshtë në tekst,
15 ju lutem.

16 PY. Pra, botuar më 27 prill të '98-s.

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju
18 lutem.

19 PY. Paragrafi i tretë nga lart thotë:

20 “UÇK-ja dënon terrorizimin dhe format e tjera të dhunës
21 mbi popullsinë civile dhe pjesës së zënë rob. UÇK-ja njeh dhe
22 përfill Aktet Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe
23 Konventën mbi luftën.”

24 Ky është një shembull i një deklaratë publike të Shtabit
25 të Përgjithshëm përmes së cilës dënonin çdo formë dhune ndaj

1 popullsisë civile, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Kjo deklaratë politike ishte veçanërisht e rëndësishme se
4 ka qenë deklarata e parë ku UÇK-ja kishte përcaktuar politikën
5 e vet, a kam të drejtë?

6 PË. Po.

7 PY. A ishte pikërisht kjo ajo që kishit në mendje ju gjatë
8 seancës përgatitore kur thatë se kishte urdhra nga komunikatat
9 që popullsia civile nuk duhej prekur?

10 PË. Po me siguri se kam mujt me iu referu edhe një deklaratë
11 të tillë.

12 PY. Komunikata të tilla ishin instrumente të fuqishme
13 propagande në përgjithësi, komunikatat në përgjithësi.

14 PË. Patjetër se sikur në çdo luftë thashë propaganda edhe e
15 armikut por edhe të tjerëve ka pas mundësi që të bënë
16 propagandë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të tjerët
17 t'i sqaronin përmes tyre qëllimi ka qenë që me i sqaru
18 opinionin e gjerë për krejt qëllimin e luftës së pastër të
19 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

20 PY. Dhe synimi i komunikatave ishte po ashtu për të ngritur
21 moralin e ushtarëve dhe të popullit shqiptar, duke iu dhënë
22 atyre përshtypjen që UÇK-ja ishte një ushtri më e fortë, më e
23 organizuar që do ta luftonte luftën, apo jo?

24 PË. Po. Kanë pas mesazhin e shpresës se lufta e Ushtrisë
25 Çlirimtare të Kosovës do t'ia sjellë popullit lirinë.

1 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, të vendosim në
2 ekran dokumentin me numër SPOE00304903 deri në 00304195 [Sipas
3 përkthimit]. Ju kërkoj ndjesë. Edhe një herë. Ka numër prove,
4 ju lutem, nxirrni në ekran numrin me P -- provën me numër
5 P269. Prapashtesa ET.16 -- në fund, ju lutem. Në shqip
6 referenca është 2760 deri në 2761, ju lutem. Shkojmë më
7 poshtë, ju lutem.

8 PY. Lexojeni vetë, z. Bashota, pa zë. Na thoni kur të keni
9 përfunduar që të kalojmë te faqja tjetër.

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në anglisht shkoni në fund
11 të faqes, ju lutem. 26 nëntor, po, këtu.

12 DËSHMITARI: Po.

13 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju
14 lutem, te shqipja tani.

15 PY. Lexoni paragrafin që fillon me datën 26 nëntor, ju
16 lutem. E shihni? Po jua lexoj edhe unë në anglisht:

17 "Më 26 nëntor, një njësit special i UÇK-së sulmoi
18 aeroportin e Goleshit. Me këtë rast u godit një aeroplan i
19 tipit 'Cessna 310' i cili pastaj u rrëzua, me ç'rast u vranë
20 edhe pesë armiq. Njësitë u kthye në bazë pa humbje."

21 E gjetët, e lexuat?

22 PË. Po.

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani, ju lutem, të vendosim
24 në ekran materialin SPOE00304903 deri 304915 dhe faqja
25 konkrete është faqja me numër 304914, ju lutem.

1 PY. Prapë këtu lexo atë paragrafin -- në fakt do jua lexoj 26
2 nëntorin 1997, thotë:

3 "Një avion Cessna 310 u gjuajt afër Prishtinës. Pesë
4 persona vdiqën në këtë goditje (ndonëse UÇK-ja mori përsipër
5 përgjegjësinë për këtë incident, mendohet se rrëzimi i avionit
6 ka qenë një aksident)."

7 Ky është një raport në fakt që ka përgatitur Misioni i
8 Monitorimit i Komisionit Evropian.

9 Tani a është e vërtetë që në '97 UÇK-ja nuk kishte as
10 mjete as mundësi të rrëzonte një avion?

11 PË. Arma më e madhe në atë kohë, besoj, kallashnikov ka pas.
12 S'di për ndonjë armë më të madhe.

13 PY. Pra, ky është një shembull tjetër që tregon se Zëri i
14 Kosovës botonte artikuj sipas të cilëve UÇK-ja merrte përsipër
15 veprime me të cilat në fakt në të vërtetë s'kishte fare
16 lidhje, kështu?

17 PË. E vërtetë.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
19 pranimin e kësaj faqeje. Faqja SPOE003094 [Sipas përkthimit],
20 ju lutem.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
22 kundërshtime?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim. Vetëm ju
24 lutemi që të pranohet me klasifikimin konfidencial.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 121

1 SPOE00304914 pranohet dhe do të mbetet konfidencial.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marri
3 numrin e provës 4D99 dhe do të mbetet konfidencial.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

5 PY. Javën e kaluar, por dhe dje, z. Bashota, ju përmendët
6 disa herë policinë lokale, a ju kujtohet?

7 PË. Po.

8 PY. Njësitë e policisë lokale u krijuan nga administrata
9 serbe dhe përbëheshin prej serbëve, shqiptarëve dhe romëve të
10 armatosur, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe në thelb ishin pjesë përbërëse e policisë serbe dhe
13 bashkëpunonin në operacione me policinë dhe ushtrinë serbe,
14 apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe ishin të shpërndarë në të gjithë Kosovën, apo jo? Të
17 krijuar në gjithë Kosovën, apo jo?

18 PË. Po, në shumë pjesë të Kosovës, po.

19 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
20 DJK01023 deri në 01038-ET, ju lutem. Ky është në serbisht
21 versioni që do të shohim, ndërsa shqipja është DJK00992 deri
22 në 01022.

23 PY. Ky është transkripti i një takimi të Sigurisë Lokale,
24 Këshilli i Kosovës dhe Metohisë [Sipas përkthimit] që mban
25 datën 4 shkurt 1999. E shikoni? Takimi është mbajtur më 4

1 shkurt të '99-s në Këshillin Ekzekutiv Provizor të Kosovës dhe
2 Metohisë.

3 PË. Po.

4 PY. Tema e takimi kanë qenë "Veprimtarimet..." Nuk e di a
5 lexoni, a lexoni serbisht, Dëshmitar?

6 Por takimi thotë që ka qenë takim për "Peprimtaritë e
7 deritanishëm për formimin e sigurisë lokale." Ky është
8 titulli.

9 PË. Nuk e njoh mirë gjuhën serbe. E njoh deri dikun, por jo
10 mirë, jo mirë.

11 PY. Fatkeqësisht dokumentin në shqip nuk është, por ne po ju
12 lexojmë nga anglishtja.

13 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shkojmë në faqen DJK012035-
14 ET, ju lutem.

15 PY. Në kryer të faqes, një nga pjesëmarrësit, z. Stanojevic,
16 thotë:

17 "Siguria lokale është krijuar në shtatë komuna deri tani.
18 Uniforma, pistoleta, llogore dhe pranga u janë dhënë në
19 Gjakovë."

20 A përputhet kjo dhe me atë që dinit ju asokohe se
21 subjektet apo organet serbe kishin armatosur oficerët lokalë
22 të policisë?

23 PË. Po, këtë informacion e kena pas.

24 PY. Disa rreshta më poshtë vijon dhe thotë:

25 "Kemi pasur rezultate të deritanishme që në fillim tre-

1 katër persona janë kapur dhe janë çuar te MUP-i lokal
2 /Ministria e Brendshme/ në bashkëpunim me sigurinë lokale. Veç
3 kësaj kemi kapur hajdutë gjatë kohës që do të kryenin vjedhje.
4 Deri tani kanë qenë shqiptarë dhe prandaj duhet të kujdesemi
5 për pronat e personave në mënyrë të MUP-i dhe siguria lokale
6 të kenë bashkëpunim të mirë. Kanë punuar mirë dhe për çështje
7 të tjera, pasi kemi marrë një listë me dy mijë emra
8 terroristësh përmes sigurisë lokale.”

9 Pra, kur përfaqësuesit serbë flasim për terroristët këtu,
10 kjo ishte një fjalë që ata e përdornin për të përshkruar
11 shqiptarët mes të cilëve dhe UÇK-në, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. A e dini ju se policia lokale ka kryer dhe arrestime dhe
14 u ka dhënë një listë të shqiptarëve dhe ushtarëve të UÇK-së
15 MUP-it, e keni ditur ju këtë?

16 PË. Për listë që ka dhënë nuk e di. Por raste konkrete kemi
17 pas në -- një rast e kemi pas ku një ushtar i ynë është
18 plagosur pikërisht nga njerëz të tillë dhe dy janë arrestuar
19 vetëm se kanë kaluar afër shtëpisë së tij. Edhe pse aty ka
20 qenë rruga e fshatit.

21 PY. Më poshtë nga gjysma e faqes Stanojevic thuhet se ka
22 raportuar se:

23 “Siguria lokale ka operuar kryesisht që nga korriku dhe
24 kanë pasur një ndikim të madh. Janë kapur rreth 80 terroristë
25 që në fund të fundit ky është një rezultat i mirë.”

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 124

1 Pra, edhe këtu kur thonë terroristë e kanë fjalën për
2 ushtarët e UÇK-së, apo jo?

3 PË. Po, me siguri se nuk e di që ka pas informacione
4 ushtarake të tjera në atë kohë.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
6 pranimin e dokumentit DJK01023 deri në 01038.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ndërsa numri i plotë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kisha
10 fjalën, doni të gjithë dokumentin apo të gjithë faq -- vetëm
11 këtë faqe?

12 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të gjithë dokumentin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
14 kundërshtime?

15 Z. HALLING: [Përkthim] S'ka kundërshtime

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
17 numër DJK01023 deri në DJK01038-ET bashkë me përkthimin në
18 serbisht pranohet.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
20 numrin 4D100 dhe vërej që është dokument publik.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
22 bëjmë 10 minuta pushim tani. Mund të dilni nga salla me
23 Sekretaren e Seancës dhe do fillojmë për dhjetë minuta.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 --- Seanca ndërpritet në orën 15.29

2 --- Seanca rifillon në orën 15.39

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
4 silleni dëshmitarin në sallë.

5 Znj. Alagendra, mund të na thoni sesa kohë ju duhet?

6 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Sapo po thoja pasi pashë
7 pjesën e mbetur të shënimeve të mia, nuk kam pyetje të tjera
8 për këtë dëshmitar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal, ne kemi disa
12 pyetje plotësuese. Në fakt kemi nxjerrë një listë të materiale
13 që do përdorim për pyetjet plotësuese. E di që ka pasur shumë
14 kundërshtime të diskutuara jashtë pranisë së dëshmitarit,
15 megjithatë në qoftë se ka ndonjë gjë për të diskutuar nga
16 ekipet do të ishte mirë që ky diskutim të bëhet pa praninë e
17 dëshmitari.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 [Përkthim] Mos e sillni dëshmitarin ende këtu.

20 Në rregull. Çfarë kundërshtimi ka?

21 Z. MISETIC: [Nuk ka përkthim].

22 Z. HALLING: [Përkthim] Për sa i takon kundërshtimit të
23 Thaçit në veçanti, do kërkoja që të kalonim në seancë private.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi dy kundërshtime. Do fillojmë
25 me kundërshtimin që nuk është e nevojshme që të kalojmë në

1 seancë private, pra që mund ta themi në seancë publike, dhe
2 pastaj në qoftë se ekipet e tjera kanë për të shtuar, mund të
3 shtojnë me atë dhe pastaj mund të kalojmë tek pjesa tjetër,
4 domethënë, tek kundërshtimi i dytë.

5 Kundërshtimi i parë ka të bëjë me provën 123941-123949.
6 Kjo provë na është nxjerrë ne për herë të parë në orën 10.10
7 paradite, sot pasi përfundova me pyetjet për këtë dëshmitar.
8 Është nxjerrë në pajtim me rregullin 102(3), që kërkon që
9 Prokurori i Specializuar të nxjerrë me kërkesë të Mbrojtjes
10 material që Mbrojtja beson se ka rëndësi materiale për
11 përgatitjen e Mbrojtjes.

12 Pra, nuk është nxjerrë sipas rregullës 102(1)(b) dhe ne
13 kundërshtojmë që të përpigjet Prokuroria që të përdorë
14 rregullën 102(3) si një mënyrë për të justifikuar një shkelje
15 të nxjerrjes së materialeve.

16 Ky është një dokument i cili është nga fillimi i viteve
17 2000. Pra, po ashtu pretendohet që të jetë nga një dëshmitar i
18 cili ka qenë në listën e dëshmitarëve të ZPS-së. Nuk ka asnjë
19 arsye të shpjegueshme se pse nuk është nxjerrë ky dokument
20 përpara goxha kohe, dhe nuk kemi absolutisht asnjë lloj
21 shpjegimi se pse është nxjerrë kaq kohë ky dokument. Aq më
22 tepër që Prokuroria ka kërkuar pasi kemi përfunduar pyetjet me
23 këtë dëshmitar që të japë dhe këtë dokument, domethënë të
24 nxjerrë këtë dokument në listën e vet të dokumenteve.

25 Rregulli 110 konkretisht autorizon Trupin Gjykses që të

1 përjashtojë provat të cilat nxjerr, siç kërkohet nga
2 rregullat.

3 Ndërkohë që ka pasur një situatë të ngjashme ku Trupi
4 Gjykues po ashtu kanë vendosur - që është F01352 në paragrafin
5 20 - ku Trupi Gjykues përjashtimisht ka vendosur ndryshe, ku
6 thuhet që:

7 "Pavarësisht kësaj, në qoftë se ZPS-ja parashikon që do
8 të përdorë ndonjë material të tillë gjatë dëshmime të
9 dëshmitarëve, duke përfshirë, për shembull, rifreskimin e
10 kujtesës së dëshmitarit ose me leje të Trupit Gjykues për të
11 konfrontuar një dëshmitar armiqësor, detyrimi për të kërkuar
12 autorizimin e Trupin Gjykues për të ndryshuar listën e provave
13 materiale do të vihet në lëvizje. ZPS-ja kërkon ndërkohë që të
14 shtohet një listë e -- një dokument i këtillë në listën e
15 materialeve, ndërkohë që nuk e kuptojmë arsyen se pse këtë
16 material Prokuroria nuk e ka shtuar më përpara."

17 Ndërkohë që kur e shikojmë këtë material ne na duket që
18 ky material lidhur me çështje që ne kemi diskutuar, që janë
19 diskutuar në marrjen në pyetje të dëshmitarit nga Prokuroria,
20 çështje të cilat janë diskutuar me dëshmitarin në seancën
21 përgatitore që parashtrohen në paragrafët 32 deri në 35 të
22 Shënimit Përgatitor 2. Asgjë të re nuk kemi të demonstruar që
23 do të vinte në lëvizje nxjerrjen e këtij dokumenti pasi është
24 përfunduar marrja në pyetje e këtij dëshmitari nga Mbrojtja.
25 Dhe jo vetëm kaq, por mendoj që është pa vend dhe vendos një

1 precedent të gabuar që ZPS-ja kërkon pranimin e një materiali
2 mbështetur në rregullën 102(3) dhe që tani të mund të kërkohet
3 shtimi i këtij materiali në këtë pikë kohe.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ekipet e
5 tjera të Mbrojtjes?

6 Z. DIXON: [Përkthim] Ne e mbështesim në mënyrë unanime.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dhe neve.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe neve.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
10 vazhdoni z. Halling.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtimi i Mbrojtjes ka dy
12 pjesë të ndryshme. Është e rëndësishme që të bëhet ndarja
13 ndërmjet tyre.

14 Së pari sa i takon nxjerrjes së këtij dokumenti sot duhet
15 të them kjo është diçka që është nxjerrë pasi janë kërkuar në
16 burimet të hapura, pasi kemi marrë fatura të -- pasi kemi
17 marrë shënime të hetuesit për këtë dëshmitar që është në
18 1D219. Është diçka të cilën e kemi regjistruar gjatë 24 orëve
19 të fundit, dhe ndërkohë kjo është marrë nga burime të hapura.
20 Ne do të përdorim vetëm një faqe. Pra, është faqja 123947. Dhe
21 jemi tërësisht të informuar dhe e dimë që bëhet fjalë për
22 dokument që bie nën rregullën 102(3).

23 Sa i takon pjesë së dytë të kundërshtimit, domethënë se
24 sa e përshtatshme është që të vendoset një dokument në listën
25 e materialeve sipas rregullës 102(3). Kjo çështje ka dalë edhe

1 në shtator, por ne e lamë pa e çuar deri në fund përpjekjen
2 tonë dhe qëndrimi ynë është që kërkesat që materialet të jenë
3 në listën e provave materiale, në listën e dokumenteve duhet
4 që të lidhen vetëm thjesht me pyetjet kryesisht nga
5 Prokuroria.

6 Ndërkohë që sa i takon pyetjeve plotësuese, këto pyetje
7 plotësuese kanë të bëjnë me çështjet që dalin në sallën e
8 gjyqit. Dhe përderisa u ngritën çështje të caktuara nga ekipet
9 e Mbrojtjes, kjo na vuri ne në lëvizje dhe për këtë arsye ne
10 mendojmë që duhet të lejohej që të përdorim këtë dokument siç
11 është renditur ai.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Halling, këtë dokument
13 kur e keni marrë ju? Domethënë ZPS-ja e ka marrë këtë dokument
14 sot?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Është një dokument i cili mund të
16 gjendet në burim të hapur, domethënë mund të gjendet në burim
17 të hapur, është regjistruar sot dhe është nxjerrë sot.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Fakti që bëhet fjalë për një
20 dokument që mund të gjendet në burime të hapura është faktor
21 kundër përdorimit të këtij materiali. Domethënë pse nuk e kanë
22 zbuluar më përpara Prokuroria këtë dokument? Kjo është pyetja
23 e parë. Domethënë Prokuroria duhet që ta kishte gjetur këtë
24 dokument më përpara. Dhe ndërkohë që nuk shpjegohet se pse
25 gjatë analizës që ato kanë bërë, pse nuk e kanë nxjerrë këtë

1 dokument më përpara

2 Më lejoni një minutë. Ju lutem.

3 Ndërkohë, pika e dytë është që nuk mjafton që vetëm
4 thjesht të thuhet që janë ngritur çështje të caktuara në
5 mënyrë përmbyllëse dhe të mos thuhet konkretisht se cilat
6 çështjet që janë ngritur, sepse në parashtrimet e mia
7 paraprahe unë thashë që të gjitha këto janë mbuluar, të paktën
8 *prima facie*, të paktën me aq sa mund të kuptojmë nga
9 dokumenti, këto mbulohen në seancën përgatitore në Shënimin
10 Përgatitor 32 deri në 35 dhe janë mbuluar në pyetjet e bëra
11 nga Prokuroria.

12 Ajo çfarë bëmë ne është thjesht që i jemi përgjigjur
13 pyetjeve tuaja. Kështu neve parashtrojmë që duhet të thuhet
14 diçka më konkrete dhe në qoftë se do t'i referohem shprehjes
15 së përdorur nga Trupi Gjykues në paragrafin 20 të vendimit
16 është që duhet që të tregohen shkaqet e arsyeshme që të jenë
17 specifike që të justifikohet kërkesa e shtimit të një
18 materiali të tillë.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ndërkohë që ne mund të themi që
20 çështja në vetvete është diskutuar, është trajtuar në seancën
21 përgatitore, unë po ju shpjegoj atë çfarë është bërë,
22 domethënë, kërkimi që është bërë. Ne po flasim për një
23 material që mund të gjendet në burim të hapur që përkon në
24 veçanti me faqen 3 të shënimeve të hetuesit të Mbrojtjes së z.
25 Thaçi lidhur me z. Desku dhe z. Kastrati. Materiali lidhur me

1 gjëra të cilat janë trajtuar me dëshmitarin dhe për të cilët
2 Mbrojtja ka bërë pyetje.

3 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
5 tjetër?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, a mund të kalojmë në
7 seancë private?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,

14 Dëshmitar.

15 Znj. Alagendra, keni më pyetje?

16 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo.

17 PY. Faleminderit, z. Bashota. Unë nuk kam më pyetje për ju,

18 z. Bashota.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka Prokuroria

20 pyetje plotësuese?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

22 Pyetje vijuese nga z. Halling:

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, lidhur me diçka që i thatë Mbrojtjes së

25 Krasniqit. Përmendët dy druvarët serbë që u zhdukën dhe kjo

1 është pasqyruar në transkriptin provizor dhe ju thatë që:

2 "Nuk e di ku i kanë çuar, po ata thjesht janë ndaluar dhe
3 më pas janë marrë nga ushtarë të UÇK-së."

4 A ju kujtohet kjo?

5 PË. Thashë se në fillim ka pas spekulime se ata janë marrë
6 nga civilë. Dhe nuk di mo, nga, kush i ka marrë dhe nga kanë
7 shku. Ka mundësi që janë marrë edhe nga ushtarët, po nuk e di.

8 PY. Atëherë, me informacionet që keni tani, a mund të thoni
9 ju që këta i ka marrë UÇK-ja? UÇK-ja i morët ushtarët?

10 PË. Tash jam konfuz në bazë të kësaj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mos e keni --
12 thatë ushtarët z. Prokuror.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

14 PY. E bëra gabim pyetjen, po e bëj dhe një herë. Me
15 informacionet që keni tani, a mund të thoni që ushtarët e UÇK-
16 së ishin personat që i morën këta dy druvarë?

17 PË. Jo, nuk mund ta them saktë.

18 PY. Po çfarë keni dashur të thoni atëherë kur i thatë
19 Mbrojtjes së Krasniqit që janë mbajtur të ndaluar dhe i kanë
20 marrë ushtarët e UÇK-së?

21 PË. Unë nuk e di që i thashë "janë mbajtur të ndaluar", por
22 di që e thashë se "ka pas spekulime në atë kohë se i kanë
23 marrë qytetarët, qytetarët". Ma vonë ma s'kam dit. E di që
24 njeri, e kam thon edhe këtu para jush, se njeni prej tyre, më
25 duket ka vdekur dhe tjetri është gjallë.

1 PY. Flasim tani për çështjen e komandantëve të zonave, që e
2 keni diskutuar veçanërisht sot.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Mund t'ju referencën e
4 transkriptit të ditës së sotme. Është faqja 33-34 si shembull.
5 PY. Ju thatë disa gjëra në deklaratën për TPNJ-së lidhur me
6 komandantët e zonës. Dokumenti i parë është P1870.1, faqja 14.
7 Do ua lexoj. Ju keni thënë:

8 "Shtabi i Përgjithshëm organizoi stafin operativ që
9 përbëhej nga komandantët e zonave."

10 Ju është bërë pyetje:

11 "Pra, ka qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm apo në
12 varësi të Shtabit të Përgjithshëm?"

13 Ju keni thënë:

14 "PË. Në varësi të Shtabit të Përgjithshëm.

15 "PY. A ishin të gjithë komandantët e zonave?"

16 Ju jeni përgjigjur:

17 "Po."

18 I qëndroni ende kësaj dëshmie?

19 PË. Po, në bazë të strukturimit, po.

20 PY. Po. Flasim tani për ekzistencën e shtabeve operative.

21 Shtabi operativ kur ka filluar të ekzistojë për herë të parë?

22 PË. Mbas strukturimit të -- shtabi operativ ka fillu edhe në
23 Shtabin Qendror kur ka qenë atëhere, që është qujt. Edhe në
24 Shtabin e Përgjithshëm mbas strukturimit të Ushtrisë
25 Çlirimtare të Kosovës.

1 PY. Jeni në gjendje të na thoni kur ka filluar të ekzistojë
2 për herë të parë shtabi operativ, me përafërsi të paktën?

3 PË. Shtabi operativ në kohën e Shtabit të Përgjithshëm është
4 bo. Kur është themeluar Shtabi i Përgjithshëm. Mbas
5 strukturimit.

6 PY. Ju keni thënë që shtabi operativ ka filluar që në kohën e
7 Shtabit Qendror. Unë tani po përpiqem të kuptoj kur është
8 krijuar për herë të parë shtabi operativ?

9 PË. Diku në vitet '94.

10 PY. Faleminderit. Në një deklaratë tjetër që mban numrin e
11 provës P1970.1, faqja 12, ju është bërë pyetje?

12 "Po kur keni qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe u
13 krijuan shtatë zonat operative, keni qenë ju të përfshirë në
14 emërimin e Shtabit të Përgjithshëm të komandantëve të zonave?"

15 Jeni përgjigjur:

16 "Po, ka qenë drejtoria politike e Shtabit të Përgjithshëm
17 ajo që i mori këto vendime dhe ka qenë vendim kolektiv."

18 Është ende dëshmia juaj kjo?

19 PË. Komandantët e zonave në të gjitha rastet janë zgjedhur
20 nga vetë, nga vetë zona. Shtabi i Përgjithshëm mbas
21 strukturimit veç i ka konfirmuar emrat e tyre si komandant
22 zone.

23 PY. Nëse Shtabi i Përgjithshëm nuk do t'i kishte konfirmuar
24 këto emërimet, çfarë do të kishte ndodhur?

25 PË. Nuk muj me parashiku këto. Me siguri kish ndodh kjo ç'ka

1 ndodhi në shkurt të '99-s, po mendoj me ndryshimin e krejt, e
2 krejt Shtabit të Përgjithshëm. Për arsye se komandantët e
3 zonave do të kishin kërkuar një gjë të tillë për të gjithë
4 anëtar e Shtabit të Përgjithshëm që kanë pas këtë fuqi.

5 PY. Po. Tani dua të shohim çfarë keni thënë për zonat dhe
6 raportimin e tyre. Dhe në këtë rast po bazohem në deklaratën
7 tuaj, është me numër P1870.2, faqja 4. Ju është bërë pyetje.

8 "... si kanë funksionuar ata? I merrnin dot vetë vendimet
9 dhe a i raportonin Shtabit të Përgjithshëm?"

10 Ju jeni përgjigjur:

11 "Kanë raportuar. Kanë raportuar për çdo veprim që ka
12 ndërmarrë në zonën e Dukagjinit dhe këto raportime i kam bërë
13 në mbledhjen e shtabit operativ. Këtu kishte dhe anëtarë të
14 Shtabit të Përgjithshëm dhe ne i merrnim raportet prej tyre."

15 A është kjo e saktë?

16 PË. Po unë -- kur i kanë raportuar Bislim Zyrapit.

17 PY. Gjatë kundërpjetje avokati i z. Thaçi ju pyeti a kishte
18 ndikim të pakontestueshme Adem Demaçi kundrejt komandantëve të
19 zonave. A ju kujtohet kjo pyetje? Ndaj komandantëve.

20 PË. Po.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
22 SPOE00131824 deri në 00131857, faqja SPOE me ET në fund kjo.
23 Edhe faqja SPOE00131856 është faqja që nevojitet, dhe është në
24 listën e materiale të ZPS-së. Faqja e parë në shqip fillon me
25 numrin SPOE00131751.

1 PY. Dëshmitar, ju bënë pyetje për një intervistë të Rexhep
2 Selimit gjatë seancës përgatitore, dhe dua të shohim atë faqen
3 që diskutuam dhe gjatë seancës përgatitore bashkë.

4 Dëshmitar, në këtë intervistë, Rexhep Selimi flet për
5 Adem Demaçin dhe Rambujenë. Dhe i është bërë pyetje.

6 "Si ndodhi shkurorëzimi i UÇK-së me Demaçin në malet e
7 Berishës, apo jo? Delegacioni kthehet nga Rambujeja ditën e
8 enjte, ndërsa Demaçi takohet me Shtabin e Përgjithshëm ditën e
9 shtunë. Si ka rrjedhur ai takim?"

10 Dhe përgjigja nga Rexhep Selimi është kjo:

11 "Demaçi aty e lëshoi mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm.
12 Insistonte që marrëveshja të mos nënshkruhet asesi dhe tentoi
13 ta përdorte ndikimin e vet në komanda të zonave, por nuk iu
14 mor parasysh nga komandat e zonave, kështu që në një farë
15 mënyre vetë heshtja prej tij, prej asaj kohe e deri më tash,
16 tregon një zhgënjim ose dështim të tij. Një heshtje, një
17 moskyçje, një mosangazhim i tij në proces është i
18 pajustificueshëm, dhe sado pak le një zbrazëti në jetën e tij
19 shumë të frytshme si simbol i rezistencës kombëtare."

20 Dëshmitar, a përputhet kjo me atë ç'ka ju kujtohet ju
21 para -- ju kujtohet dhe ju kjo ngjarje?

22 PË. Unë e thashë nuk di nëse jam kon në këtë takim. Por, di
23 që Adem Demaçi përpos këtij rasti te komandantët e zonave ka
24 pas ndikim. Dhe shumë më ka ardh mirë që komandantët e zonave,
25 të paktën, me punën që ka bo Shtabi i Përgjithshëm për me i

1 bind se është e drejtë shkuarja në Rambuje, kanë arritur që
2 komandantëve të zonave me ja u ndryshu mendimin edhe për -- në
3 këtë rast edhe për Adem Demaçin. Por, nuk do të thotë që nëse
4 s'e kanë nguar kësaj radhe Demaçin kanë humb ndikimin apo
5 mbështetjen për ta.

6 PY. Në rregull. Pra, ju po thoni që Shtabi i Përgjithshëm
7 ishte ai që konfirmonte emërimet e komandantëve të zonave dhe
8 më pas u raportonte, dhe komandantët e zonave nuk ndoqën z.
9 Demaçi lidhur me atë ç'ka donte Shtabi i Përgjithshëm për
10 marrëveshjen e Rambujesë. A e përmblodha saktë atë që deshët
11 të thonit ju?

12 PË. Përafërsisht, po. Vetëm thashë se Demaçi, Demaçi në këtë
13 rast nuk ka arritur që t'i bindë komandantët e zonave për këtë
14 çështje të caktuar. Mbas një pune që ka bo Shtabi i
15 Përgjithshëm me komandantët e zonave për t'i bindur se duhet
16 të nënshkruhet marrëveshja e Rambujesë.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Të shohim dokumentin IT-05-87
18 6D00067 dhe faqen 6D00-0785.

19 Të nderuar Gjykatës, dy faqet e këtij e dokumenti janë
20 pranuar si provë P1745, ndërkohë që kjo është një faqe shtesë
21 e të njëjtit varg dokumentesh. Atëherë, mund të shikojmë vetëm
22 versionin në anglisht ndërkohë që versionin në shqip është me
23 shkrim shumë të vogël.

24 PY. Dëshmitar, ju i shpjeguat Mbrojtjes së Thaçit lidhur me
25 Rambujenë dhe thatë që Rambujeja ishte si një lloj grushti. A

1 e thatë këtë gjë në dëshminë tuaj, Dëshmitar.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtojmë. Nuk e tha, nuk e ka
3 thënë dëshmitari që Rambujeja ka qenë grusht.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Do të bëj perifrazim të pyetjes.
5 PY. Ju përshkruat që kur ka ndodhur kjo nuk keni qenë më
6 zëvendëskomandant dhe sa i takon zëvendësimit të Azem Sylës me
7 Sylejman Selimin si komandant i përgjithshëm, ju këtë e lidhët
8 me një grusht. A e kujtoni këtë pjesë të dëshmisë tuaj,
9 Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të shohim dokumentin në faqen 600
12 -- 6D00-078 [Sipas përkthimit]. Atëherë mund të shikojmë cepin
13 në të djathtë të ekranit. Mund të vazhdojmë tek faqja 25.

14 PY. Dëshmitar, këtu kemi një tekst që kemi anglisht, por do
15 t'jua lexoj. Është intervistë e Sylejman Selimit. Sylejman
16 Selimi bën përshkrimin e të njëjtave ngjarje që keni
17 përshkruar dhe ju në dëshminë tuaj. Sylejman Selimi thotë si
18 më poshtë. Fillon tek:

19 "Delegacioni i UÇK-së në Rambuje që u emërua [Sipas
20 përkthimit] menjëherë lidhur me emërimet. Hashim Thaçi, Kadri
21 Veseli dhe deri në një farë mase Jakup Krasniqi më përgëzuan
22 mua. Azemi nuk më tha asgjë. Ne e njihnim Azemin si një person
23 që kishte punuar me logjistikën. Askush nuk e dinte që Azemi
24 kishte qenë gjenerali komandues sepse askush nuk e dinte
25 publikisht këtë gjë. Azemi më përgëzoi mua pasi u kthyem nga

1 Rambujeja. Pasi e kuptova që ai kishte qenë komandanti më
2 përpara, unë dëshiroja që të tërhiqesha, por Azemi vetë më tha
3 që nuk duhej që të tërhiqesha dhe ata e pranuan që ky ishte
4 gabim dhe se nuk ishte zgjidhur ky problem më herët.”

5 Dhe më pas vazhdohet me caktimin mbas kthimit në Rambuje.

6 Domethënë, ju kujtohet juve sa i takon Rambujesë?

7 Domethënë, Sylejman Selimi çfarë pozite ka pasur pas kthimit
8 nga Rambujeja? Çfarë kujtoni lidhur me këtë, Dëshmitar?

9 PË. Ma së pari konstatimi se Azem Syla e ka propozuar
10 Sylejman Selimin për komandant nuk qëndron. Kjo me siguri
11 duhet të jetë ndonjë intervistë e dhënë pas luftës. Nuk e
12 besoj se e ka thënë gjatë luftës. Sylejman Selimin për
13 komandant të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së e kanë
14 propozuar vetë komandantët e zonave. Nuk ka mujt Azem Syla me
15 thonë “Unë jam komandant, po të propozoj ty si komandant”.
16 Faktikisht nuk e ka pritur në fillim mirë revoltën e
17 komandantëve të zonave as Azem Syla, as Jakup Krasniqi, as unë
18 personalisht. Por iu kemi nënshtruar një vullneti për të mos
19 ta çuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në ndonjë kolaps edhe
20 të asaj kohe, për shkak se përballë ne kishim armikun dhe nuk
21 kemi dashur të fusim një konflikt në mesin e ushtarëve të UÇK-
22 së për një ego të disa komandantëve. Thjesht jemi tërëhjekur
23 dhe në atë takim është zgjedhur Sylejman Selimi si komandant.

24 PY. Po këtu Sylejman Selimi nuk thotë që atë e propozoi Azem
25 Syla. Ai thotë që kur e mësoi se Azem Syla ishte komandant, ai

1 donte që të tërhiqej vetë dhe Azem Syla i kishte thënë atij që
2 të mos tërhiqej. A pajtohet kjo me atë çfarë ju kujtohet juve
3 për këtë ngjarje?

4 PË. Këtë nuk e di. Këtë nuk e di, ndoshta. Ndoshta, po këtë
5 nuk e di. Kjo thjesht ka mujt me qenë vetëm lojë fjalësh, për
6 arsye se Azem Syla e ka prit shumë keq këtë reagim të
7 komandantëve të zonave.

8 PY. Por mbështetur në atë çfarë ju po thoni, rezultati i
9 grushtit ishte që Sylejman Selimi më pas u bë komandant i
10 përgjithshëm. A ia thatë këtë gjë Mbrojtjes së Thaçit?

11 PË. Nuk e di, po unë e kam thon këtu publikisht Sylejman
12 Selimi është bo komandant.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, të dyja
14 intervistat që u treguan janë relevante dhe janë me vlerë
15 provuese dhe duhet që të kuptohen në tërësinë e tyre. Sikurse
16 e thashë dhe më përpara, dy faqe të këtyre dokumenteve janë
17 pranuar më herët në prova, kështu që ne parashtrojmë që duhet
18 që të pranohen si prova të gjitha faqet në SPOE00131824 deri
19 në 00131857 në shqip dhe në anglisht. Dhe kjo është në fakt
20 është intervista e Rexhep Selimit, e pjesa tjetër e faqeve IT-
21 05-87 dhe 6D00067, duhet që të plotësohen me faqet që sapo
22 pamë dhe këto faqe do të duhet që t'i shtohen provës
23 ekzistuese P01747 [Sipas përkthimit].

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
25 kundërshtim?

1 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, nuk kundërshtojmë. Por, thjesht
2 duhet të kuptojmë se cilat faqe kërkohet që të shtohen në
3 prova, se dokumenti është i gjatë.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Këtë po themi dhe ne, sepse nuk na
5 shpjegohet i gjithë konteksti në qoftë se do të flasim për të
6 gjithë dëshminë -- për të gjithë deklaratën e dhënë nga
7 Sylejman Selimi, dhe për këtë arsye unë po them që është e
8 rëndësishme që të gjitha faqet, domethënë i gjithë dokumenti
9 që ka të bëjë me të, të përfshihen në prova materiale.
10 Domethënë është një dokument i cili përbëhet nga 37 faqe dhe
11 që përfshin dhe versionin në shqip edhe në versionin në
12 anglisht.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dixon, a u
14 shpjeguat lidhur me pyetjen që kishit?

15 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne nuk mendojmë
16 që është relevant i gjithë dokumenti. Mendojmë që nuk duhet që
17 të pranohet e gjithë intervista. Mendojmë që duhet që të
18 pranohen vetëm ato faqe të cilat lidhen me këtë dëshmitar.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, edhe unë kam
20 të njëjtin kundërshtim. Mendoj që është me vlerë që të
21 pranohen vetëm pjesët të cilat u diskutuan me dëshmitarët,
22 kështu që nuk shikoj ndonjë arsye se pse duhet që të pranohet
23 i gjithë dokumenti.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe përgjigja për këtë pyetje ka
25 të bëjë me mendësinë e grushtit të pretenduar dhe me personin

1 që ka qenë si me thënë koka e këtij grupi, Sylejman Selimi,
2 dhe deklarata e akuzuarit dhe mendojmë që është e rëndësishme
3 që të mund të shikohet i gjithë dokumenti, pra 37 faqe dhe jo
4 vetëm ato pjesë të cilat u diskutuan me dëshmitarin.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Një kapitull prej 30 faqesh dhe jo
6 vetëm ato pesë rreshta të cilat juve ia lexuat dëshmitari. Nuk
7 mendoj që është me vlerë kjo, dhe nuk mendoj që duhet të
8 pranohet i gjithë dokumenti. Lidhur me dokumentin vërejmë
9 gjithashtu që intervista duhet t'i ishte treguar personit që e
10 ka dhënë këtë informacion në qoftë se Prokuroria do kërkonte
11 që këtë dokument ta pranonte -- ta kërkonte për pranim në
12 prova materiale. Nuk duhet ta diskutoni me këtë dëshmitar.

13 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i caktojmë
15 përkohësisht një numër prove materiale të dyja dokumenteve, në
16 mënyrë të tillë që t'i shikojmë dhe ne përpara se të vendosim
17 për pranueshmërinë apo jo të tyre.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
19 për materialin e parë, SPOE00131824 deri në SPOE00131857-ET
20 dhe versioni përkues në shqip do të marrë numrin e provës
21 provizore P1883.

22 Ndërkohë që sa i takon dokumentit të dytë, vërej që kemi
23 një numër prove të pranuar. Nuk e di në qoftë se duhet t'i
24 caktoj një numër tjetër apo jo. E kemi në fakt provën P1745,
25 të cilën e përmendi dhe Prokurori që përmban disa faqe të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuse nga z. Halling

Faqe 152

1 dokumentit. Nuk e di çfarë duhet të bëj. Duhet t'i jap një
2 numër të veçantë prove provizore të gjithë dokumentit, apo
3 thjesht të vendos .1 dhe të caktoj provën e mëparshme.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Caktojini një
5 numër të ri prove provizore.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në këtë rast do i
7 caktoj numrin P1884.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, tema tjetër që dëshiroj të diskutojmë bashkë,
10 ka të bëjë me praninë e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit në
11 Shtabin e Përgjithshëm.

12 Ju përmendët që Hashim Thaçi nuk ka qenë në Shtabin e
13 Përgjithshëm. Këtë e keni thënë në transkript në faqen 23134.
14 Këtë e keni thënë edhe lidhur me Kadri Veselin në të
15 transkriptin në kohë reale në faqen 28 sot.

16 Tani dëshiroj që t'ju lexoj disa dokumente shtesë nga
17 ish-anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm dhe të shohim se çfarë
18 kanë thënë ata lidhur me këtë temë. Atëherë së pari do shohim
19 dëshminë e Jakup Krasniqit përpara TPNJ-së.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal është prova P800,
21 faqja 5026.

22 PY. Jakup Krasniqi thotë si më poshtë, dhe po flet për
23 persona të cilët ai i njeh.

24 "Ju i njihnit Sokol Bashotën dhe Rexhep Selimin, apo jo?

25 "PË. E njihja Sokolin në atë kohë por jo Rexhepin.

1 "PY. Po ju e njihnit edhe Adem Jasharin dhe Sokol

2 Bashotën. Po Hashim Thaçin a e njihnit me emër?

3 "PË. Po.

4 "PY. A e dini në qoftë se ata të tre kanë qenë anëtarë të

5 Shtabit të Përgjithshëm në '97-n? A e keni pas këtë

6 informacion atëherë?

7 "PË. Po."

8 Hashim Thaçi a nuk ka qenë pjesë e Shtabit të

9 Përgjithshëm përpara 1998?

10 PË. Para 1998-s e kemi sqaruar se nuk ka qenë Shtabi i

11 Përgjithshëm, ka Shtabi Qendror edhe Hashim Thaçi nuk ka qenë

12 pjesë e Shtabit Qendror.

13 PY. A mund të na shpjegoni se pse ka thënë Jakup Krasniqi që

14 ai ishte anëtar?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtojmë, sepse kërkon

16 hamendësim.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet

18 kundërshtimi. Mund të vazhdoni, Dëshmitar.

19 DËSHMITARI: Këtë nuk mund ta di çfarë qëllimi ka pas

20 Jakupi kur e ka deklaruar këtë, por tash unë sa di, ai nuk ka

21 qenë anëtar i Shtabit Qendror të UÇK-së.

22 Z. HALLING: [Përkthim]

23 PY. Azem Syla që ju më herët keni thënë që ka qenë autoritet

24 në historikun e UÇK-së, ka thënë se më poshtë sa i takon

25 përbërjes së parë të Shtabit të Përgjithshëm. Kjo thuhet në

1 provën P847 në faqen SITF00243001. Është një pjesë e shkurtër
2 dhe mund t'ja u lexoj. Azem Syla ka thënë:

3 "Personat që kanë vendosur për pavarësinë kanë qenë
4 gjithashtu edhe pjesë e shtabit të parë të përgjithshëm të
5 UÇK-së. Ai shtab përbëhej nga Azem Syla, Sokol Bashota, Kadri
6 Veseli, Xheladin Gashi, Ali Ahmeti, Xhavit Haliti, Hashim
7 Thaçi, Rexhep Selimi, Lahi Brahimaj dhe një koleg tjetër."

8 Dëshmitar, Azem Syla e përmend Hashim Thaçin po ashtu
9 edhe Rexhep Selimin dhe Kadri Veselin si anëtarë të Shtabit të
10 Përgjithshëm për periudhën kohore për të cilën po flasim.

11 Çfarë keni për të thënë lidhur me këtë koment?

12 PË. Edhe unë po thom që me përgjegjësi të plotë, po them që
13 nuk kanë qenë anëtarë të Shtabit Qendror as Hashim Thaçi, as
14 Kadri Veseli, as Rexhep Selimi në atë kohë. Kemi qenë unë,
15 Azem Syla, Nait Hasani, Xheladin Gashi, Xhavit Haliti, s'di a
16 e thashë, edhe Ali Ahmeti.

17 PY. Po Rexhep Selimi është në listën tuaj apo nuk është në
18 listën tuaj?

19 PË. Rexhep Selimi kur ka shku Xheladin Gashi për Shqipëri ka
20 thënë se duhet të pranohet edhe Rexhep Selimi dhe Lahi
21 Brahim, për shkak se u shkapërderdh Shtabi Qendror në atë
22 kohë, si rezultat i burgosjes së Nait Hasanit, i vrasjes së
23 Zahir Pajazitit dhe realisht këta nuk kanë mujt mo me ushtru
24 detyrën për shkak se mesa mbaj mend Rexha ka shku në Drenicë,
25 dhe Hashimi dhe Kadriu nuk kanë qenë në Kosovë. Kështu që

1 s'kanë pas se si me qenë anëtarë të Shtabit Qendror në atë
2 kohë.

3 Përpjeka e parë për me organizu Shtabin e Përgjithshëm
4 është pikërisht në një fshat, në fshatin e bacit Jakup në
5 Negrovç, të Jakup Krasniqit, në Negrovç, si përpjekje. Por
6 edhe ajo realisht nuk ka mujt me u implementu për shkak të
7 rrethanave që i potencoa ma herët.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam
9 përfunduar pjesën e temave që kisha planifikuar për këto
10 pyetje plotësuese dhe po ashtu edhe përfundoi koha.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
12 përfunduar për sot. Do të duhet që të vini nesër në orën 9.30
13 sipas asaj që tha avokati.

14 Faleminderit po ashtu edhe z. Qerkini.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Gjykatës, e the gabim 9.30, apo
16 duhet të vijmë në orën 9.30?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, do
18 fillojmë nesër në 9.00 të mëngjesit, jo në 9.30.

19 DËSHMITARI: Dëshmitar.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di në
22 qoftë se ju ndihmoj apo jo, por edhe në qoftë se e miratoni
23 gjithë materialin që keni kërkuar që të pranohet, nuk na duhet
24 më shumë sesa 20 minuta.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim]

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndërkohë që jeni në këmbë,
2 z. Halling, është një dokument që është prova P268 [Sipas
3 përkthimit]. Ja sa ta kontrolloj. Domethënë, është 269.8.
4 Versioni në anglisht duket sikur nuk ka një fjalë në
5 paragrafin e dytë. Domethënë i mungon një fjalë në paragrafin
6 e dytë. Do ju kërkoja që ta verifikoni. Edhe një herë është
7 prova P269.8.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po, do ta shohim dhe do t'ju
9 kthejmë një përgjigje nesër.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Do bëjmë pushim deri -- e kemi mbyllur deri në orën 9.00
12 nesër.

13 --- Seanca mbyllet në orën 16.33

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25